

Plani Lokal i Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane të Zonës së Plazhit në Komunën Velipojë

SHTATOR, 2011



Përmbajtja

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE	3
SHKURTIMET.....	5
I. HYRJE.....	6
1.1 ÇFARË ËSHTË NJË PLAN LOKAL I MANAXHIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA BASHKIAKE?	6
1.2 NEVOJA PËR HARTIMIN E NJË PLANI LOKAL PËR MBETJET	6
1.3 HARTIMI I PLANIT	7
II. POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR.....	9
2.1 POLITIKA DHE STRATEGJIA KOMBËTARE E MBETJEVE	9
2.2 PRINCIPET E MANAXHIMIT TË MBETJEVE	10
2.3 KUADRI LIGJOR SHQIPTAR.....	12
2.4 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	13
III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME.....	14
3.1 PROFILI I KOMUNËS.....	14
3.2 ASPEKTET INSTITUCIONALE NË MANAXHIMIN E MBETJEVE	18
3.3 ANALIZA E MBETJEVE (PRODHIMI, PËRBËRJA)	24
3.4 SHËRBIMET E MBETJEVE.....	29
3.5 ADMINISTRIMI I MBETJEVE INERTE DHE NDËRTIMORE.....	34
3.6 EKONOMIA DHE FINANCIMI	34
3.7 ANALIZA SWOT E SISTEMIT AKTUAL TË ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE VENDORE	37
IV. PLANIFIKIMI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE.....	41
4.1 VIZIONI	41
4.2 OBJEKTIVAT	41
4.3 OBJEKTI I PLANIT.....	42
4.4 EVIDENTIMI I ALTERNATIVAVE PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE	47
4.4.1 Shërbimet e pastrimit	47
4.4.2 Mbledhja e mbetjeve	49
4.4.3 Depozitimi i mbetjeve	56
4.4.4 Riciklimi dhe kompostimi si alternativa të përshtatshme për minimizimin e mbetjeve.....	58
4.4.5 Administrimi i mbetjeve voluminoze dhe ndërtimore	64
4.4.6 Treguesit e performancës	65
4.5 ANALIZA E SKENARËVE TË ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE	66
4.6 PLANI I INVESTIMEVE.....	69
4.7 KOSTOJA E SKENARËVE	71
V. PERSPEKTIVA FINANCIARE.....	72
5.1 ÇËSHTJA E FINANCIMIT DHE STRATEGJIA E “MBULIMIT TË KOSTOS”	72
VI. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	83
6.1 RREGULLORJA VENDORE	83
6.2 DETYRIMI DHE SANKSIONET	84

6.3	LIÇENCIMI MJEDISOR.....	84
6.4	PJESËMARRJA E SEKTORIT PRIVAT.....	84
6.5	MBËSHËTETJA POLITIKE.....	85
VII.	NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK	85
VIII.	PLAN VEPRIMI	87
IX.	RISHIKIMI I PLANIT	93
9.1.1	<i>Monitorimi</i>	<i>93</i>
ANEKSI I:	LEGJISLACIONI I BE.....	95
ANEKSI II:	ANALIZA E INFRASTRUKTURËS SË NEVOJSHME TË MBETJEVE	96
ANEKSI III:	LLOGARITJA E KOSTOS PËR SHËRBIMET E PASTRIMIT	100

Lista e figurave dhe tabelave

Figura 1	Hapat e hartimit të planit.....	8
Figura 2	Piramida e manaxhimit të mbetjeve.....	11
Figura 3	Harta e pozitës gjeografike të Komunës Velipojë	14
Figura 4	Struktura e Komunës për manaxhimin e mbetjeve	23
Figura 5	Performanca e sasisë së mbetjeve të prodhuara gjatë vitit 2010	25
Figura 6	Ndarja e përgjithshme e mbetjeve në fushatën e parë	26
Figura 7	Ndarja e përgjithshme e mbetjeve në fushatën e dytë	27
Figura 8	Parashikimi i mbetjeve organike për të ardhmen.....	28
Figura 9	Mbledhja e të dhënave në komunën e Velipojës dhe vizitat në terren.....	29
Figura 10	Vizitë në terren në pikat e grumbullimit të mbetjeve në zonën e plazhit	29
Figura 11	Pikat ekzistuese të mbledhjes së mbetjeve në zonën e plazhit të Velipojës.....	30
Figura 12	Pikat e grumbullimit në zonën e plazhit të Velipojës.....	31
Figura 13	Zona me rërë e plazhit të Velipojës	32
Figure 14	Vendndodhja e vend-depozitimit aktual në Komunën e Velipojës	33
Figura 15	Vendi i depozitimit në Velipojë	33
Figura 16	Takime në komunën e Velipojës	37
Figura 17	Zonat dhe peizazhet e mbrojtura në Komunën e Velipojës.....	45
Figura 17	Zonat e administrimit të mbetjeve në plazhin e Velipojës	47
Figura 18	“Skema zakonshme e mbledhjes së mbledhjeve (elementët e ruajtjes në terren)”	53
Figure 19	Koshat e propozuar për bizneset (240 litra)	54
	dhe për familjet (50 litra).....	54
Figura 20	“Skema individuale e mbledhjes së mbetjeve (elementë për mbajtjen në kosha deri në largimin e tyre)”	55
Figura 21	“Modele të ndarjes së mbetjeve në burim”	62
Figura 22	Skemat e kompostimit në shtëpi	64
Figura 23	“Skema e administrimit të mbetjeve – Skenari 1”	67

Figura 24 “Skema e administrimit të mbetjeve – Skenari 2”	68
Figure 25:”Përshkrim i Përgjithshëm i Direktivave të BE për Mbetjet”	95
Tabela 1 Kuadri ligjor shqiptar për mbetjet	12
Tabela 2 Struktura e tokës në Komunën Velipojë	16
Tabela 3 Ndarja e mbetjeve në fushatën e parë.....	26
Tabela 4 Ndarja e mbetjeve në fushatën e dytë.....	26
Tabela 5 Parashikimi i prodhimit të mbetjeve në plazhin e Velipojës.....	28
Tabela 6 Të dhëna për kazanët e mbetjeve (deri në Maj 2011)	30
Tabela 7 Buxheti total vendor në komunën e Velipojës.....	35
Tabela 8 Zërat e buxhetit të pastrimit për zonën e plazhit të Velipojës.....	35
Tabela 9 Vjelja e tarifës së pastrimit dhe të ardhurat vjetore nga mbledhja e saj.....	36
Tabela 10 Tarifat e miratuara të pastrimit për vitin 2011	37
Tabela 11 Analiza SWOT e ofrimit të shërbimit të administrimit të mbetjeve.....	38
Tabela 12 Llojet e zonave urbane	50
Tabela 13 Norma e mbledhjes së mbetjeve	52
Tabela 14 Skema e mbledhjes së mbetjeve.....	53
Tabela 15 Objektivat kombëtarë sipas Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve	58
Tabela 16 “Grupi i propozuar i synuar për të zbatuar skemën pilot të riciklimit”	63
Tabela 17 Program pilot për kompostimin në shtëpi	64
Tabela 18 “Investimet e nevojshme për periudhën 2011-2015”	70
Tabela 19 Kostot vjetore të skenarit për vitin e parë të zbatimit dhe depozitimit në vend-depozitimin e Velipojës.....	71
Tabela 22 Ndarja e kostos mes konsumatorëve në bazë të prodhimit të mbetjeve.....	74
Tabela 23 Ndarja e kostos dhe niveli paraprak për familjet	75
Tabela 24 Ndarja e kostos dhe niveli paraprak për bizneset.....	75
Tabela 25 Analizë e përmbledhur e planifikimit të të ardhurave	78
Tabela 27 Pjesëmarrja e sektorit privat në administrimin e mbetjeve të ngurta.....	85
Tabela 28 Metoda publiciteti.....	86

Shkurtime

AMP	Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve
ARM	Agjensia Rajonale e Mjedisit
BE	Bashkimi European
DEFBKPS	Drejtoria Ekonomike, Financës, Buxhetit, Kontabilitetit, Pagave, Statistikës
DLDP	Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal
DSIPP	Drejtoria e Shërbimeve, Infrastrukturës dhe Pronave Publike
DTT	Drejtoria e Tatim Taksave
DUPBMST	Drejtoria e Urbanistikës, Projektimit, Bujqësisë, Mjedisit dhe Sekretaria Teknike
GKKM	Grupi Kombëtar Këshillues për Mbetjet
GZM	Grupi i Zonave të Mbetjeve
INPAEL	Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor
IM	Inspektoriati Mjedisor
KNMM	Komiteti Ndërmjësor për Mbetjet
KUB	Kanalizimet e Ujrave të Bardha
KUZ	Kanalizimet e Ujrave të Zeza
LD	Plastikë e hollë
MB	Mbetje nga Bizneset
MF	Mbetje nga Familjet
MMPAU	Ministria e Mjedisit dhe Administrimit të Ujrave
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PGM	Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve
PKMM	Plani Kombëtar i Manaxhimit të Mbetjeve
PLMMNU	Plani Lokal i Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane
SKM	Strategjia Kombëtare e Mjedisit
SËOT	Analiza e Avantazheve Dobësive Mundësive dhe Rreziqeve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZAM	Zonat e Administrimit të Mbetjeve

I. HYRJE

1.1 Çfarë është një plan lokal i manaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake?

Plani Lokal i Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikës kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/udhëzues i rëndësishëm për manaxhimin e mbetjeve komunale për Komunën Velipojë.

Kjo plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për manaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PLMMNU është të parashtrojë një përjasje të qartë të politikave të manaxhimit të mbetjeve në nivel lokal, duke harmonizuar interesat e të gjithë aktorëve për një manaxhim të qendrueshëm, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme, duke përfshirë impiantet e përshtatshme për trajtimin final të mbetjeve.

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- ✓ Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- ✓ Opsionet e manaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjesimin) final të mbetjeve;
- ✓ Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e manaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e manaxhimit të mbetjeve;
- ✓ Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- ✓ Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

1.2 Nevoja për hartimin e një plani lokal për mbetjet

1.2.1 Konteksi kombëtar për manaxhimin e mbetjeve

Që prej vitit 1994 grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për manaxhimin e tyre dhe njëkohësisht duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”. Ligji 8652, dt 31.7.2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e qeverive vendore” vendosi që grumbullimi, grososja

dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake urbane të jetë tërësisht një përgjegjësi funksionale dhe organizative e bashkive dhe komunave.

Sistemet kryesore për manaxhimin e mbetjeve kanë konsistuar në grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane në një rrymë të vetme dhe transportimin e tyre drejt vendeve të grumbullimit që janë nën administrimin e vetë njësive lokale.

Në përgjithësi, problematika në sektorin e mbetjeve lidhet ngushtë me mungesën e instrumenteve të duhura për manaxhimin mjedisor të tyre, mungesën e teknologjive dhe investimeve dhe kapacitetet e pamjaftueshme në burimet njerëzore dhe financiare.

Por, në të njëjtën kohë, përpjekjet e deritanishme për të adresuar këtë problematikë kanë qenë të parakorduara, të fragmentizuara dhe jo efikase, çka ka bërë që ndryshimet e pritura lidhur me zhvillimin e këtij sektori të ecin shumë ngadalë dhe të shoqërohen me impakte negative ndaj mjedisit.

1.2.2 Detyrimi dhe mbështetja ligjore për hartimin e planit

Politika kombëtare për manaxhimin e mbetjeve, ku përfshihet edhe detyrimi ligjor (Ligji 9010 dt.13.02.2003, neni 5, pika 2.a; Ligji 8934 dt. 05.09.2002, Neni 66/ç; Udhëzimi Nr.6 dt. 27.11.2007) i detyron autoritetet në nivel qendror, rajonal dhe lokal që të hartojnë planin e manaxhimit të mbetjeve. Si fazë e parë e hartimit të këtyre dokumenteve planifikuese strategjike është parashikuar hartimi i Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve¹ dhe si fazë e dytë hartimi i planeve rajonale dhe lokale. Këto plane duhen shoqëruar me hartimin e udhëzuesve dhe standardeve si dhe me mbështetje teknike për të mundësuar zbatimin efektiv të tyre.

Hartimi i planeve do të jetë një obligim i ardhshëm, që rrjedh nga direktivat e Këshillit të Evropës që Shqipëria duhet të zbatojë si një vend potencial për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Në qershor 2006 është firmosur Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe rrjedhimisht Qeveria Shqiptare ka marrë një seri angazhimesh, që janë përqendruar në arritjen e pranimit në BE.

1.3 Hartimi i planit

Në kuadër të projektit “Koordinimi i NJQV-ve në Rajonin Shkodër-Lezhë për t'u angazhuar në shërbimin e manaxhimit të mbetjeve përmes përvetësimit të eksperiencës të fituar gjatë fazës së parë”, pjesë e Programit të Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (DLDP), Komuna Velipojë me mbështetjen e Intercooperation dhe asistencën teknike të Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, mundësoi hartimin e Planit Lokal të Manaxhimit të Mbetjeve për Zonën e Plazhit në Komunën Velipojë.

1.3.1 Procesi i hartimit dhe konsultimit

Aktorët ishin pjesë e zhvillimit të Planit Lokal të Mbetjeve që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që i përshtaten më shumë interesave të Komunës. Për këtë arsye u themelua grupi i punë me përfaqësues nga zyrtarë të komunës, përfaqësues të vendim marrësve në nivel lokal,

¹ Miratuar: VKM nr.175, dtaë 19.1.2011

përfaqësues të Co-PLAN dhe Intercooperation. Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e komunës, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan dhe u ranë dakort gjatë takimeve të grupit të punës.

Plani i zhvillimit konsistoi në hapat më poshtë:




Figura 1 Hapat e hartimit të planit

Në hapa të ndryshëm të hartimit të planit, grupi i punës organizoi seanca diskutimi dhe konsultimi me përfaqësuesit kryesorë të komunës. Procesi i konsultimit, i cili çoi në punën e ngushtë midis aktorëve, duke rakorduar në ato që i nevojiten komunës dhe të ofrojë një mundësi për komente apo diskutime të ndryshme.

II. POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR

2.1 Politika dhe Strategjia Kombëtare e Mbetjeve

Strategjia Ndërsektorale e Mjedisit (2007) përmban një kapitull për mbetjet ku jepen indikacione lidhur me *Landfill*-et, të cilët konsiderohen si zgjidhja më e pranueshme dhe ekonomike për vendin përse ka të bëjë me depozitimin përfundimtar të mbetjeve në të ardhmen, por pa përjashtuar opsione të tjera si djegia apo trajtimi me përfitim energjie.

Kjo strategji përcaktoi objektivat për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të cilat vazhdojnë të mbeten të pazbatueshme për shkak të mungesës së financimeve dhe kapaciteteve të nevojshme; mungesës së eksperiencës në përdorimin e metodave dhe teknologjive; performancës së dobët në zbatimin e ligjeve; mungesës së bashkëpunimit midis autoriteteve lokale dhe qendrore apo bashkëpunimit me sektorin privat; mungesës së monitorimit dhe regjistrimit të mbetjeve etj.

Së fundmi, janë miratuar një sërë dokumentesh politike dhe strategjike në fushën e mjedisit ku jepen indikacione strategjike për sektorin e menaxhimit të mbetjeve dhe janë në përputhje me parimet e BE-së për menaxhimin e mbetjeve. Në të njëjtën kohë, kanë përfunduar draftet përfundimtare të Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Mbetjeve, të cilat u miratuan në fillim të vitit 2011.

Strategjia kombëtare për mbetjet ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Shqipërisë për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në 2025 duke synuar minimizimin e impaktit të mbetjeve në mjedis në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe përmirësimin e përdorimit eficient të burimeve në Shqipëri. Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë Shqiptare për të transformuar statusin e vendit në lidhje me reduktimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie. Ajo ka vendosur objektiva sfidues dhe realistë njëkohësisht, të cilët synojnë mundësimin e ndryshimit rrënjësor të mënyrës së menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Strategjia kombëtare e mbetjeve paracakton katër shtylla kryesore me qëllim zbatimin e politikës dhe strategjisë së mbetjeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve (PKMM). Këto shtylla politike janë thelbësore dhe shumë të rëndësishme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e të gjithë menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Shtyllat politike janë si në vazhdim:

Planifikimi: Hapi i parë në zbatimin e procesit duhet të jetë zhvillimi i planeve për të çuar përpara axhendën e strategjisë dhe politikës së mbetjeve në lidhje me zbatimin;

Edukimi: Partnerët/ bashkëpunëtorët kryesorë të sistemit duhet të edukohen në mënyrë që të përmbushin potencialin e tyre brenda sistemit dhe të lehtësojnë zbatimin e reformave;

Mbështetja financiare: Burimet njerëzore dhe vetë sistemi duhet të mbështeten financiarisht në mënyrën e duhur;

Kuadri ligjor: Sistemi kërkon një paketë rregulloresh. Për më tepër, për të siguruar hyrjen në Bashkimin Evropian, vendi do të duhet të bëjë përafrimin me legjislacionin përkatës të Komitetit Evropian në fushën e mjedisit në vitet në vijim.

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve përshkruan mekanizmat kyç për investimet në sektorin e mbetjeve dhe ka parashikuar nevojat për financim sipas dy fazave, duke marrë në konsideratë periudhat e para dhe pas pranimit. Në mënyrë që të arrihet përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e mbetjeve, është llogaritur që një kosto investimesh prej 150-200 Milion EURO do të kërkohen në nivel vendi dhe më pas një fond shtesë prej 52 Milion EURO në vit si kosto operacionale.

Në mënyrë që të mirëmanaxhohen mbetjet, vendi është ndarë në nivel strategjik në 12 zona mbetjesh bazuar në kufijtë gjeografikë sipas qarqeve aktuale. Këto njësi janë parë si strukturë bazë por nuk përjashtohet mundësia e bashkimit apo bashkëpunimit midis këtyre zonave për të përfituar nga ekonomia e shkallës. Në vazhdim, çështjet e këtyre zonave të mbetjeve do të manaxhohen nga një strukturë apo grup i zonës së mbetjeve që përbehet nga partnerë mjedisorë rajonal dhe lokalë. Plani Kombëtar i mbetjeve ka përmbledhur dhe sugjeruar disa masa dhe veprime për mirëmanaxhimin e mbetjeve bashkiake dhe jo bashkiake, nga teknologjitë e trajtimit të mbetjeve deri tek minimizimi dhe riciklimi e tyre.

2.2 Principet e manaxhimit të mbetjeve

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

Parimi reduktues: Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore duke minimizuar dhe mënjanuar sa është e mundur gjenerimin e mbetjeve. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbetjeve qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre.

Parimi parandalues: Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbetjet në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbetjet.

Hierarkia e mbetjeve: Hierarkia e mbetjeve përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në manaxhimin e mbetjeve në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në manaxhimin e mbetjeve duke vendosur “parandalimin dhe ripërdorimin” në majë dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.



Figura 2 Piramida e manaxhimit të mbetjeve

Hierarkia e Mbetjeve ka për qëllim të inkurajojë manaxhimin e mbetjeve në mënyrë të tillë që të reduktohen sasitë e materialeve të mbetjeve të prodhuara dhe të përfitohet maksimalisht nga to.

1. **Parandalimi i mbetjeve:** Mënjanimi i mbetjeve të gjeneruara - mbetjet duhet të parandalohen ose minimizohen në burim sa më shumë që të jetë e mundur;
2. **Ripërdorimi:** Përdorimi direkt i produkteve të mbetjeve sipas qëllimit për të cilin janë prodhuar nuk mund të parandalohet prodhimi i tyre, këto materiale mund të ripërdoren.
3. **Riciklimi:** Përdorimi i materialeve të mbetjeve sipas qëllimit për të cilin janë prodhuar pas trajtimit - Materialet e mbetjeve duhen të riciklohen ose riproçesohen në një formë që lejon përdorimin e tyre si një produkt sekondar ose lëndë e parë.
4. **Përfitimi/riçenerimi:** Djegia me përfitim energjie - ku materialet dytësore që nuk mund të ripërdoren apo riciklohen, mund të përpunohen duke përfituar energji nga to
5. **Depozitimi i mbetjeve në landfill:** Vetëm nëse nuk mund të parandalohen, ripërdoren, riciklohen apo përpunohen me përfitim energjie mbetjet mund të depozitohen në një *landfill* mjedisor të kontrolluar.

Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë: Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë: Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që mbetjet të menaxhohen sa më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me mbetjet e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera. Në këtë mënyrë, parimi rekomandon që autoritetet përgjegjëse për mbetjet të sigurojnë infrastrukturën e duhur duke krijuar një rrjet të impianteve të depozitimit bazuar në parimin e afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë si dhe në parimin e hierarkisë së mbetjeve.

Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit: Parimi "Ndotësi paguan" kërkon që prodhuesit e mbetjeve të mbulojnë koston e menaxhimit të mbetjeve që gjenerojnë. Kështu koston mjedisore dhe kostoja e menaxhimit të mbetjeve në të gjitha proceset duhet të reflektohen në çmimin e produktit si dhe në tarifat për ofrimin e shërbimit. Objektivi është ofrimi i një sistemi të drejtë dhe dekurajues për prodhimin pa kriter të mbetjeve.

2.3 Kuadri ligjor shqiptar

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE. Progresi më i madh në fushën e mbetjeve është bërë në fushën e legjislacionit. Gjatë periudhës 2008-2009, legjislacioni Shqiptar për manaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore që reflektojnë direktivat e BE dhe detyrimet nga Konventa e Baselit.

Legjislacioni i plotë Shqiptar në fushën e mbetjeve është dhënë i përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Ligjet kryesore në fushën e mbetjeve	Ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregullore të tjera për manaxhimin e mbetjeve
	Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i amenduar me Ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008 dhe Ligjin nr. 9983, datë 8.9.2008
	Ligji nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për manaxhimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”
	Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme”
	Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbetjeve”
Legjislacioni dytësor në manaxhimin direkt të mbetjeve	Vendimi nr. 803, datë 04.12.2003 “Për aprovimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për riciklim dhe trajtim”
	Vendimi nr. 99, datë 18.02.2005 “Për aprovimin e katalogut Shqiptar për klasifikimin e mbetjeve”
	Rregullore nr. 1, datë 30.3.2007 “Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimet dhe shkatërrimet, nga krijimi, transporti dhe deri tek trajtimi përfundimtar”
	Rregullore nr. 6, datë 30.11.2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”
	Udhëzues nr. 6, datë 27.11.2007 “Për aprovimin e rregullave, përmbatjes dhe afatave për skicimin e planeve për manaxhimin e mbetjeve”
Akte të tjera ligjore që lidhen direkt apo indirekt edhe me manaxhimin e mbetjeve	Ligji nr. 8934, datë 5.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, duke përfshirë amendamentet të bëra në Maj 2008
	Ligji no. 9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet”. Midis çështjesh të tjera, ligji mbulon shërbimet publike dhe manaxhimin e mbetjeve si dhe përfshin ndërtimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve
	Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e autoriteteve lokale”
	Vendimi nr. 103, datë 31.03.2002 “Në lidhje me monitorimin mjedisor në Republikën e Shqipërisë”

Tabela 1 Kuadri ligjor shqiptar për mbetjet

Deri më sot, legjislacioni ekzistues Shqiptar është përafruar vetëm pjesërisht me legjislacionin e BE në sektorin e mbetjeve.

Akoma shumë koncepte kryesore apo procedura mungojnë. Si një rekomandim i përhershëm i raporteve ndërkombëtare, adoptimi i ligjeve dhe rregullave është planifikuar në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Një ligj i ri bazë për menaxhimin e mbetjeve (zëvendëson Ligjin 9010, dt. 13.02.2003 dhe Ligjin 9537, dt. 18.5.2006), në përputhje me direktivën Dir. 2008/98/EC, pritet të miratohet brenda vitit 2010 në kuadër të Programit CARDS 2006 (INPAEL4 project). Ligji i ri do të krijojë mundësinë dhe bazën ligjore për adoptimin e legjislacionit dytësor në përputhje me direktivat e tjera të BE.

2.4 Rolet dhe përgjegjësitë

Politika kombëtare për mbetjet ka përcaktuar me detaje ngritjen dhe miratimin e disa strukturave shtesë për të mundësuar implementimin e plotë të politikës kombëtare të mbetjeve dhe të strategjisë nëpërmjet PKMM dhe të një serie të planeve të “Zonave të Mbetjeve” si dhe planeve lokale. Strukturat e reja të propozuara janë:

- i. Komiteti Ndërministror për Mbetjet (KNMM): Ky komitet është një organ themelor në nivel qendror; ai do të përbëhet nga përfaqësues të qeverisë në nivel zv/ministrash nga secila ministri që lidhet drejtpërsëdrejti me sektorin e mjedisit;
- ii. Grupi Kombëtar Këshillues për Mbetjet (GKKM): do të jetë një entitet politik i përbërë nga përfaqësues në nivel kombëtar dhe rajonal me kompetencë teknike në menaxhimin e mbetjeve. Përfaqësuesit mund të zgjidhen nga sektori publik dhe privat me qëllim këshillimin e ministrave në aspekte të ndryshme të strategjisë së planifikimit të menaxhimit të mbetjeve, politikës dhe investimeve;
- iii. Grupet e Zonave të Mbetjeve (GZM): të përbërë nga përfaqësues në nivelin rajonal dhe lokal që do të sigurojnë zhvillimin e planeve, politikave dhe projekteve në partneritet dhe interes lokal për zbatimin e strategjisë dhe politikës kombëtare të mbetjeve. Ky grupim do të ketë përgjegjësi rajonale për këshillimin e autoriteteve rajonale dhe lokale në çështje të menaxhimit të mbetjeve dhe do të jetë përgjegjës për të siguruar që planet rajonale dhe lokale të ofrojnë qëndrueshmëri dhe të jenë efektive, eficiente dhe të mirëkoordinuara midis tyre dhe në përputhje me politikën kombëtare. Grupi i Zonave të Mbetjeve do të kryesohet nga një përfaqësues i Këshillit të Qarkut dhe mbështetja për sekretarinë, anën administrative dhe aktivitetet e tij për grupin e zonave të mbetjeve do të sigurohet nga Qarku. Anëtarët e Grupit të Zonave të Mbetjeve do të jenë ekspertë rajonalë për menaxhimin e mbetjeve por do të ketë gjithashtu edhe përfaqësues nga sfera të tjera të interesit si autoritetet lokale dhe rajonale, kompanitë e mbetjeve apo industria e riciklimit, ekspertët lokalë të pavarur apo OJQ-të me eksperiencë për çështjet e mbetjeve.

III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

3.1 Profili I Komunës²

3.1.1 Pozita gjeografike e Komunës

Komuna e Velipojës është një njësi administrative e Qarkut Shkodër. Ajo ndodhet në pjesën veri-perëndimore të vendit, 25 km larg qytetit të Shkodrës, me një sipërfaqe prej 72.40 km². Ajo kufizohet me Komunën Dajç (Shkodër) në pjesën veriore, në jug me detin Adriatik, në lindje nga Prefektura Lezhë dhe në perëndim nga lumi Buna, i cili e ndan Komunën nga Republika e Malit të Zi.

Nga pikpamja demografike, Komuna filloi të popullohej masivisht në fund të viteve '60 të shekullit 20. Megjithatë data historike tregojnë që Velipoja ka qënë një vendbanim arkeologjik që në shekullin e 15th. Të dhënat historike si, ekzistenca e mogilave (varreza në formë konike dhe të ndërtuara me gurë) të gjetura në Malin e Luarzit dhe në Majën e Zezë, rrënojat e kishës në breg të lumit Buna dhe gjetje të tjera arkeologjike tregojnë që Velipoja njihet si vendbanim që në shek. XV.




Figura 3 Harta e pozitës gjeografike të Komunës Velipojë

Komuna Velipojë ka nën administrimin e saj 10 fshatra (Pulaj, Velipoje, Reç-Pulaj, Luarzë, Gomsiqe e Re, Baks Rrjoll, Mali Kolaj, Baks i Ri, Reç i Ri, Ças) me një popullsië prej 8270 banorësh. Pozita e favorshme gjeografike, ku lumi bashkohet me detin, laguna dhe rezervati natyror, fushat pjellore, kënetat dhe pyjet, kodrat dhe malet i japin komunës një mundësi të madhe për zhvillimin e turizmit detar, lumor dhe malor, të peshkimit dhe të gjuetisë, dhe për zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore dhe blegtorale.

² Burimi: Plani i Zhvillimit Lokal i Komunës Velipojë

3.1.2 Demografia

Bazuar në të dhënat e Komunës në zonën e plazhit të Velipojës, për vitin 2010, popullsia e përhershme ishte 1350 banorë, dhe gjatë periudhës së verës numri i pushuesve shkonte deri në 70,000. Gjithashtu zyrtarë të Komunës deklarojnë që gjatë 5 viteve të fundit popullsia e përkohshme në zonën e plazhit është rritur me 7%.

3.1.3 Burimet natyrore

Komuna e Velipojës është e pasur në burime natyrore. Një pjesë e tyre përfaqësohen nga zonat vegjetale me shkurre dhe drurë, dunat ranore të zonës bregdetare, kënetat, rezervati natyror. Velipoja është e pasur në rezerva peshku (mundësia e vënies në punë të vaskave të peshkut me sipërfaqe 114 ha); gjithashtu është e pasur me kafshë të egra dhe zogj, ku dallojmë kafshët e mbrojtura si, derri i egër, dhelpra, çakalli, lepuri, rosa, fazani, shpendët emigrator: rosa, pata, shapka, pulbardha dhe çafka, si dhe në bimë medicinale. Nuk ka burime natyrore minerare, por është e pasur me materiale ndërtimi inerte (çakëll dhe gurë).

3.1.4 Rrjeti rrugor dhe i transportit

Rrjeti rrugor në Komunën Velipojë është shumë kompleks, duke patur parasys edhe shtrirjen gjeografike dhe numrin e madh të fshatrave. Skema e rrjetit rrugor është e përbërë nga tre kategori rrugësh: kategoria e parë konsiston në rrugët që lidhin fshatrat me njëri tjetrin; kategoria e dytë rrugë nacionale që kalojnë përgjatë fshatrave, dhe kategoria e tretë përgjatë rrugëve të brëndshme në fshatra. Rrjeti rrugor është pothuajse i amortizuar. Të gjitha rrugët si ato të brëndshme dhe ato rurale janë të paasfaltuara. Nuk ka të dhëna të sakta në lidhje me rrugët e brëndshme në fshatra, por afërsisht llogariten të jenë 47 km. Rrugët rurale të komunës që lidhin rrugën nacionale me fshatrat dhe fshatrat me njëri tjetrin mesatarisht rezultojnë 42 km.

Furnizimi me energji elektrike në Komunë nuk është i rregullt, në sajë të nivelit të ulët të pagesës së faturave të energjisë elektrike, por gjatë sezonit të verës, zona e plazhit ka 24 orë energji elektrike.

Komuna Velipojë ka dy sisteme ujësjellësi. Njëri furnizon fshatin Mali Kolaj dhe tjetri fshatra të tjerë të Komunës. Ka pesë sisteme pompimi, nga të cilët katër janë horizontale dhe një vertikal. Situata e furnizimit me ujë është përmirësuar ndjeshëm, pasi në disa fshatra ka përfunduar faza e dytë e ujësjellësit. Megjithatë vlen të theksohet se sasia e furnizimit dhe cilësia e ujit nuk është në nivelet e dëshiruara kjo dhe për arsyen se rrjeti është shumë i amortizuar.

3.1.5 Sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza (KUZ) dhe të bardha (KUB)

Në Komunën Velipojë nuk ka një rrjet të kanalizimit të ujrave të zeza. Çdo familje e komunës ka të ndërtuar një gropë të veten septike, më përjashtim të familjeve që banojnë në pallate në fshatra dhe në zonën e plazhit. Familjet që jetojnë në apartamente përballen me problemin e shpërthimit të ujrave të

zeza duke shkaktuar përhapjen e sëmundjeve infektuese. Numri i gropave septike është pothuajse i njëjtë me numrin e familjeve.

Sistemi i kanalizimeve të ujrave të bardha në Komunën Velipojë ndahet në sistemin e kanaleve kulluese dhe atë ujitës. Kanalet kulluese ndahen në kanale kryesore, dytësore dhe të treta. Ka dy kanale kryesore kulluese, ku i pari me gjatësi 4,1 km derdhet në hidrovorin e Çasit; dhe i dyti me gjatësi 12,7 km derdhet në hidrovorin e Velipojës (Vilunit). Të dy kanalet mbulojnë 4000 ha tokë. Kanalet kulluese dytësore janë nëntë dhe kanë një gjatësi prej 14,2 km. Të dy kanalet mbulojnë një sipërfaqe prej 4000ha. Ka 9 kanale sekondare shkarkimi me një gjatësi prej 14.2 km, dhe 103 kanale shkarkuese terciare me një gjatësi prej 7 km.

Komuna Velipojë është zonë e mbrojtur me argjinatura me gjatësi 20,89 km (argjinatura e Vilunit 6,09 km; Pentar-Luarzë 6,8 km; Rec-Pulaj 7 km; Ças 1 km).

Sistemi i kanaleve ujitëse është i përbërë nga katër kanale: Kanali 1 Mertenez-Pentar me gjatësi 9.5 km dhe fuqi 1.6 m³/ sek; kanali 2 Ças me gjatësi 2.3 km dhe fuqi 0.3 m³/sek; kanali 3 Mertenze-Pulaj me gjatësi 14.5 km dhe fuqi 2.2 m³/sek; një kanal parbolik me fuqi 0.5 m³/sek. Pas vitit '90 këto kanale dolën jashtë përdorimit.

3.1.6 Aspekti social-ekonomik

Në komunën Velipojë në ndryshim nga komunat e tjera, mbas viteve 90-të ka pasur një lëvizje masive të popullsisë në drejtim të zonave urbane, lëvizje e cila ka ndikuar në uljen e popullsisë të këtyre komunave, në Velipojë një lëvizje e tillë është më e paktë. Ja vlen të përmendim, që megjithë faktit që numri i familjeve është rritur pas vitit 2000, do të vëmë re se në disa fshatra ka një rënie të numrit të familjeve si pasojë e disa arsyeve si: emigrimi jashtë vendit, migrimi në zonat urbane, dhe gjithashtu migrimi në zonat bregdetare. Pavarësisht pozitës gjeografike dhe burimeve natyrore, Komuna Velipojë ka një fuqi punëtore aktive të mjaftueshme për zhvillimin e qendrueshëm ekonomik.

- Bujqësi

Në ndryshim vendodhjes së saj pranë bregut të detit dhe mundësisë për zhvillimin e turizimit, bujqësia, blegtoria janë dy degët kryesore të ekonomisë të zhvilluara në Komunën Velipojë. Duke qënë që është një zonë me fusha pjellore, ka mundësinë që të rrisë të gjitha llojet e kulturave bujqësore si domate, patate, shalqi, rrush etj. Në tabelën më poshtë jepen shifrat në lidhje me strukturën e tokës në Komunë:

Struktura e tokës në Komunën Velipojë					
Toka bujqësore (ha)				Pyje(ha)	Livadhe - kullota (ha)
Fusha-ara (ha)	Pemëtari (ha)	Ullishte(ha)	Vreshtari (ha)		
2700	49	12	94	34	37

Tabela 2 Struktura e tokës në Komunën Velipojë³

³ Burimi: Plani i Zhvillimit Lokal i Komunës Velipojë

Produktiviteti i ulët i kulturave bujqësore, dhe njëkohësisht interesi i ulët për zhvillimin e agrikulturës vjen si pasojë e shumë problemeve në lidhje me ndarjen e tokës, parcelave të vogla toke, kosto e lartë e punimit të tokës, mungesa e një sistemi mekanik për bujqësinë. Mungesa e njohurive në lidhje me kërkesat e tregut për kulturat bujqësore dhe infrastruktura e dobët rrugore. Banorët e këtyre fshatrave janë duke u fokusuar më shumë në ndërtimin e serrave dhe sipërfaqja e tyre arrin në 25,750 m² dhe realizohet me ngrohje diellore.

- Blegtoria

Në ndryshim nga bujqësia, blegtoria, si një degë tjetër kryesore e sektorit ekonomik në Velipojë është më e zhvilluar nga fakti i koston së ulët të shpenzimeve që bëhen në drejtim të saj si dhe të kullotave që ndodhen në komunë. Nga numri i madh i krerëve të bagëtive (lopë, dele), produktet bulmetore, si qumështi, dhe produkte të tjera ushqimore si, mishi dhe vezët janë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë në këto zona. Bazuar në këto burime dhe produktiviteti nga blegtoria, komuna ka nevojën, që të ndërtojë baxho të reja për prodhimin e produkteve të bulmetit, të cilat në të ardhmen do të furnizojnë resortet turistike që po zhvillohen në zonë, sepse situata ekzistuese nuk i përmbush kërkesat e tregut të komunës dhe jashtë saj.

- Turizmi

E ardhmja e zhvillimit të Velipojës, në sajë të pozitës së saj të favorshme gjeografike ku ndërthuren harmonishëm deti, lumi, pyjet, laguna dhe malet, do të jetë turizmi. Plazhi ka një gjatësi 14 km dhe gjërësi rreth 300 m; rëra është e pashfrytëzuar dhe me aftësi shëruese si dhe uji i pastërt. Numri i pushuesve rritet çdo vit, rreth 70,000 pushues në sezon, dhe numri i dhomave të hoteleve shkon deri në 2000 dhoma. Komuna e Velipojës, përveç turizmit detar, ka potenciale për të zhvilluar turizmin malor, dhe gjuetinë e zogjve dhe lepujve.

3.1.7 Gjëndja e përgjithshme mjedisore

Si një nga zonat ruristike të vendit, mjedisi i Komunës është irretuar nga peisazhe natyrore dhe është i brishtë. Plazhi i Velipojës është një nga zonat më të frekuentuara (gjatë viteve të fundit) gjatë periudhës së verës. Në pjesën veriore të plazhit ndodhet grykëderdhja e lumit Buna, duke ofruar një peisazh natyror për turistët, dhe në pjesën jugore të plazhit është laguna e Vilunit. Zona bregdetare e Velipojës njihet si një nga plazhet me rërë kurative, me ujë të pastërt gjatë gjithë vitit në sajë të pozitës gjeografike.

Për më tepër, Qeveria Shqiptare bazuar në legjislacionin ekzistues⁴ dhe në sajë të VKM nr.682, datë 2.11.2005⁵, dhe VKM nr. 683, datë 2.11.2005⁶ për shpalljen si zona të mbrojtura shumë peisazhe

⁴ Nr. 8906, datë 6.6.2002 «Për zonat e mbrojtura»

⁵ “Për shpalljen e lumit Buna dhe peisazheve rreth tij si peisazhe tokësore/ ujore të mbrojtura”

natyrore në Komunën Velipojë, zonën bregdetare dhe zonave përreth saj. Më saktësisht, lumi Buna dhe ligatinat përreth si “Peisazhe ujore/ tokësore të mbrojtura”, ku Ishulli i Franc Jozefit, rezervati natyror i Velipojës, laguna e Vilunit, plazhi Baks-Rrjollit dhe kënetat e Domnit njihen zyrtarisht si zona të mbrojtura dhe parashikohen masa mbrojtëse të ndryshme.

Megjithatë, përveç masave zyrtare të marra deri më sot, ende zona po përballet me probleme mjedisore, të cilat janë përmbledhur më poshtë:

- Manaxhim i keq i zonave të mbrojtura që lidhet me impaktin e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, të cilët karakterizohen kryesisht nga minimizimi i zonave pyjore, dëmtimi i habitateve pyjore në zonat e mbrojtura, minimizimi i numrit të bimëve dhe specieve të kafshëve, intesiteti i lartë i erozionit dhe dëmtimi i vlerave eko-turistike etj.
- Ndotja e mjedisit e shkaktuar nga manaxhimi i papërshtatshëm i mbetjeve (të ngurta dhe të lëngta), kryesisht nga depozitimet ilegale të mbetjeve, mungesa e kontenerëve dhe e teknologjive për trajtimin e mbetjeve.

3.2 Aspektet institucionale në manaxhimin e mbetjeve

3.2.1 Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), Ministria e Punëve Publike, Transportit (MPPT) si dhe Ministria e Shëndetësisë.

Bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi, **MMPAU** është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Mjedor (IM) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM).

Inspektorati Mjedor (në zbatim të Ligjit nr. 8990 dhe Ligjit nr. 8934) është përgjegjës dhe ushtron aktivitetin për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor (ku përfshihen edhe mbetjet) në të gjithë vendin. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore të miratuara dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve (ku përfshihen dhe mbetjet), rregulloret teknike dhe teknologjitë.

Inspektorati Mjedor bashkëpunon me autoritete të tjera në nivel qendror, rajonal dhe lokal (si p.sh. ARM, Inspektorati Sanitar Shtetëror-ISSH, Policia Ndërtimore, Policinë Bashkiake etj.) për përmbushjen e detyrave të këtyre të fundit.

⁶Për shpalljen e kompleksit ligator të Liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna si zona të mbrojtura

Agjensitë Rajonale të Mjedisit (në zbatim të Ligjit nr. 8405 dhe ligjit 9890) janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal dhe, bashkë me Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve (AMP) si njësi qendrore, përbëjnë rrjetin e agjencive mjedisore. Kanë për detyrë të realizojnë zbatimin e ligjeve mjedisore dhe atyre të manaxhimit të mbetjeve në nivel lokal dhe rajonal. Duhet të bashkëpunojnë me autoritetet lokale në zhvillimin e aksioneve, planeve, projekteve apo fushatave të sensibilizimit në nivel lokal.

Kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

MPPTT dhe më konkretisht **Drejtoria e Mbetjeve Urbane** ka për detyrë formulimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, normave dhe standardeve për shërbimet publike në fushën e mbetjeve urbane apo mbetjeve të tjera. MPPTT është autoriteti përgjegjës në nivel kombëtar për planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e investimeve publike në fushën e menaxhimit të mbetjeve, rehabilitimit të fushave të venddepozitimeve, ngritjes së *landfill*-eve etj. Në zbatim të Ligjit Nr. 9010, ajo duhet të përgatisë rregullore, teknika dhe metoda për të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve si ndarja dhe grumbullimi i tyre, transporti dhe riciklimi, trajtimi dhe groposja etj. Gjithashtu, MPPTT është autoriteti kontraktues për koncesionin e aktiviteteve ekonomike nën përgjegjësinë e saj, duke përfshirë fushën e shërbimeve publike ku bën pjesë edhe menaxhimi i mbetjeve.

Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit, në zbatim të Ligjit Nr. 8405, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhje edhe për *landfill*-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me MMPAU dhe në zbatim të ligjit për menaxhimin mjedisor të mbetjeve (Nr. 9010), harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve në nivele të ndryshme të hierarkisë së menaxhimit të tyre dhe gjithashtu harton dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore (miratuar Nr. 6, dt. 30.11.2007);

Inspektorati Sanitar Shtetëror është një autoritet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai bashkëpunon me Inspektoratet Mjedisore dhe, në raste të veçanta, edhe me inspektorate të tjera, sikurse edhe me autoritetet lokale për kryerjen e inspektimeve të aktiviteteve që lidhen me mbetjet. Aktiviteti i inspektoratit mbështetet në ligjin 7904 datë 8.3.1995 dhe ka për detyrë të vendosë gjoha për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo adekuatë dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë. Përgjegjësia e inspektoratit shtrihet edhe në përcaktimin e vendgrumbullimit të mbetjeve.

Spitalet dhe gjithë prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore si dhe për dizenjimin e skemave të menaxhimit të mbetjeve të tyre, në përputhje me Planet Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planet e Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes (në bashkëpunim me MMPAU) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për:

- Mbetjet industriale (neni 13 i Ligjit nr. 9010). Kjo rregullore nuk është hartuar ende.
- Mbetjet minerale (neni 14 i Ligjit nr. 9010). Kjo rregullore nuk është hartuar ende.
- Rehabilitimin e venddepozitimeve në përputhje me specifikat.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (në bashkëpunim me MMPAU) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për mbetjet bujqësore dhe shtazore (neni 16 i Ligjit nr. 9010). Rregullorja nuk është hartuar ende.

Ministria e Financës (në bashkëpunim me MMPAU) është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për paraqitjen e taksave të ndryshme mjedisore (Ligjit nr. 9010). Deri tani është hartuar Ligji nr. 8977, dt. 12.12.2002 “Mbi taksimin në Republikën e Shqipërisë” dhe janë paraqitur dy taksat e para mjedisore (taksa e gjelbër dhe taksa e ambalazhimit mbi pijet).

3.2.2 Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: Bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, ligjin 8094, datë 21.03.1996, dhe në ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003, bashkitë dhe komunat janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Ajo (bashkia, komuna) përcakton:

- i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
- ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për menaxhimin e mbetjeve bashkiake në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;
- iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë menaxhimi për mbetjet mduke zbatuar rregulloret “tip” të miratuara nga MMPAU, MPPTT dhe Ministria e Shëndetësisë;
- iv. Harton planet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
- v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- vi. Mbledh të dhëna dhe mban e regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë dhe komunat kanë si detyrime si më poshtë:

- i. Të kujdeset për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo tyre të braktisura;
- ii. Të zbatojë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
- iii. Të monitorojë dhe inspektojë të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualët lokale;
- iv. Të inspektojë “zotëruesin e mbetjeve” për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
- v. Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e menaxhimit të mbetjeve;
- vi. Të bashkëpunojë me Inspektoratin Mjedisor, ARM si dhe inspektorate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal.
- vii. Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

3.2.3 Struktura e Komunës për mbetjet

Digrama më poshtë ilustron strukturën e komunës në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duke filluar nga përfaqësuesit në nivel Këshilli Komune, Kryetar Komune, dhe drejtuesit e shërbimeve.

Këshilli i Komunës: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave bashkiake për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligjit 9537).

Këshilli i Rregullimit të Territorit në Komunën Velipojë është përgjegjës për përcaktimin e vendit të grumbullimit (me një sipërfaqe të barabartë ose më të vogël se 0.5 ha) për të gjitha llojet e mbetjeve (teknologjike/urbane/inerte) në territorin e juridiksionit të tij (neni 9, 20 dhe 34 i Ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998). Ligji i ri për Planifikimin e Territorit (Nr. 10119, datë 23.4.2009) që hyn në fuqi në Janar 2011 autorizon këshillat e rregullimit lokal për lëshimin e lejeve edhe për impiantet e trajtimit të mbetjeve pavarësisht sipërfaqes së objektit.

Policia e Komunës: ushtron funksionin e saj bazuar në ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997, është përgjegjës për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Sektori i njësisë së përkohshme dhe të përhershme të shërbimeve: Drejtoria e Shërbimeve, Infrastrukturës dhe Pronave Publike është direkt përgjegjëse për të organizuar shërbimet publike, duke përfshirë manaxhimin e mbetjeve. Sektori i shërbimeve është kryesisht përgjegjës për të zhvilluar shërbimin e manaxhimit të mbetjeve në Komunë dhe në zonën e plazhit. Ky sektor është përgjegjës për organizimin ditor të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve, transportit dhe depozitimit final të mbetjeve të zonës së plazhit gjatë periudhës së verës, përgjegjës për marrjen me qera të makinës (me anë të procedurave të tenderit), dhe organizon punëtorët për pastrimin e zonës së plazhit.




Figura 4 Struktura e Komunës për manaxhimin e mbetjeve

3.2.4 Rregullorja lokale për mbetjet

Ligji i instrukton qeveritë lokale të hartojnë dhe miratojnë kuadrin e nevojshëm rregullator lokal. Kuadri lokal përfshin rregulloret e ndryshme që përcaktojnë proceset e manaxhimit të mbetjeve dhe objektin, përshkruajnë indikatorët, specifikojnë kriteret dhe instruktojnë strukturat lokale në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve si dhe në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin. Kuadri rregullator lokal duhet të përfshijë:

- **Rregulloren komunale për menaxhimin e mbetjeve:** Është përgjegjësi e Komunës Velipojë hartimi i kësaj rregulloreje që përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit në fshatra dhe manaxhimit të mbetjeve brenda territorit administrativ të Komunës, të hartojë procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitulli për aplikimin e sanksioneve. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli i Komunës.

Në fakt Komuna përgatit çdo vit një projekt “Për pastrimin e plazhit të Velipojës”. Në këtë dokument komuna përshkruan elemente specifike të plazhit të Velipojës si, zona, distancat, numri i bizneseve, numri i banorëve gjatë sezonit dhe sasia e mbetjeve që gjenerohet. Gjithashtu në dokument përfshihen shpenzimet operative dhe numri i punëtorëve të shpërndarë gjatë muajve kur ofrohet shërbimi. Ky është një dokument që nuk mund të konsiderohet si një rregullore e vërtetë për manaxhimin e mbetjeve në nivel lokal dhe duhet të miratohet nga Këshilli I Komunës.

- **Rregulloren bashkiake për tarifën e mbetjeve:** kjo rregullore ka për qëllim të krijojë një sistem efektiv për mbulimin e kostos së shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Rregullorja e tarifave të mbetjeve përfaqëson një politikë bashkiake afatgjatë për mbulimin e kostos, nivelin e tarifave dhe sistemin e mbledhjes së tyre dhe vendos rregulla specifike për autoritetet lokale si dhe për komunitetin lokal dhe biznesin. Deri më sot Komuna e Velipojës nuk ka hartuar apo miratuar një rregullore komunale për tarifën e mbetjeve.

3.3 Analiza e mbetjeve (prodhimi, përbërja)

Një nga pengesat kryesore për zhvillimin e çdo plani në Shqipëri është mungesa e të dhënave të besueshme statistikore për popullsinë dhe prodhimin e mbetjeve. Me qëllim parashikimin e administrimit të mbetjeve në të ardhmen në Komunën e Velipojës, ne duhet të llogarisim prodhimin aktual të mbetjeve si dhe për të parashikuar zhvillimin për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme për hartimin e këtij plani dhe mundësojnë llogaritjen e situatës aktuale dhe përcaktimin e objektivave si dhe procesin e monitorimit. Në këtë rast ne përdorëm të dhëna nga sondazhi që bëmë në rajonin e Shkodrës dhe në komunat përreth Velipojës për dy sezona (periudha e verës dhe e dimrit).

Prodhimi i mbetjeve në nivel rajonal: Sipas drafteve përfundimtare të Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Mbetjeve, komuna e Velipojës është pjesë e Zonës së Mbetjeve të Shkodrës, në të cilën përfshihen qytetet e Shkodrës, Koplikut, Vau i Dejës, Pukës, Fushë-Arrëzit si dhe të

gjitha komunat e qarkut Shkodër, me një popullsi prej 252,656, që gjeneron një sasi mbetjesh prej afro 50-60 mijë ton në vit.⁷

Prodhimi i mbetjeve në nivel vendor: Të dhënat zyrtare nga Komuna e Velipojës në lidhje me prodhimin e mbetjeve në zonën e plazhit janë ende të debatueshme dhe bazohen vetëm në vlerësime të përgjithshme si numri i banorëve që vizitojnë plazhin gjatë periudhës së verës, kapacitetet e kontenierëve që makineritë teknologjike mbledhin gjatë ditës, sasia e mbetjeve të riciklueshme që hiqen nga zona e plazhit për në vendin e groposjes. Kamionët që transportojnë mbetjet për në vendin e depozitimit nuk peshohen fare dhe nuk është bërë asnjë përpjekje për të numëruar kamionët dhe për të llogaritur vëllimin e mbetjeve në vendin depozitimit. Sipas të dhënave nga komuna, sasia mesatare e mbetjeve të prodhuara ndryshon nga 30-40 ton/ditë. Grafiku i mëposhtëm paraqet një prirje të sasisë së mbetjeve të prodhuara në periudha të ndryshme të vitit sipas ndryshimit të popullsisë në zonën e plazhit të Velipojës:




Figura 5 Performanca e sasisë së mbetjeve të prodhuara gjatë vitit 2010

Në zonën përreth Komunës së Velipojës u zhvilluan dy fushata për ndarjen e mbetjeve: (i) i pari u krye nga Co-PLAN në 8 qytete shqiptare, përfshirë Shkodrën, në kuadrin e projekteve CARDS, INPAEL “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor”, dhe u realizua gjatë periudhës së verës dhe dimrit; (ii) fushata e dytë u realizua në pesë NJQV në rajonin e Shkodrës në kuadrin e projektit “Studimi i Ndarjes së Mbetjeve në 5 NJQV në rajonin e Shkodrës”. Më poshtë jepen rezultatet e dy fushatave.

⁷ Burimi: Komisioni i Komuniteti Evropian, për dhe në emër të Qeverisë shqiptare (2010): Strategjia Kombëtare e Mbetjeve

Ndarja e mbetjeve	Sezoni i verës	Sezoni i dimrit	Përbërja e përgjithshme e mbetjeve
Organike	47.10%	46.60%	46.85%
Letër	13.15%	13.60%	13.38%
Plastikë	13.97%	11.31%	12.64%
Qelq	6.36%	4.45%	5.41%
Metale	1.19%	0.72%	0.95%
Të tjera	18.23%	23.33%	20.78%

Tabela 3 Ndarja e mbetjeve në fushatën e parë




Figura 6 Ndarja e përgjithshme e mbetjeve në fushatën e parë

	Përqindja e rrymave të mbetjeve
Organike	36.19%
Letër	7.62%
Plastikë	14.39%
Qelq	20.02%
Metale	2.23%
Të tjera	19.56%

Tabela 4 Ndarja e mbetjeve në fushatën e dytë




Figura 7 Ndarja e përgjithshme e mbetjeve në fushatën e dytë

Sondazhet u realizuan në tipologji të ndryshme të zonave urbane: rezultatet nga fushata e parë i përkasin qytetit të Shkodrës dhe rezultatet e fushatës së dytë i përkasin komunave rreth Velipojës. Sasia e biodegradueshme (organike dhe letër) është në përqindje më të lartë në zonat urbane, por edhe në zonat rurale kjo përqindje është mjaft e konsiderueshme. Në këtë aspekt, pjesa e djegshme është në një përqindje të konsiderueshme si në zonat rurale ashtu edhe ato urbane duke çuar drejt mundësisë së prezantimit të skemave të plehërimit për administrimin e mbetjeve. Në lidhje me pjesën e riciklueshme, si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale, kjo përfaqëson një përqindje të konsiderueshme, veçanërisht pjesa plastike dhe e qelqtë, ku në zonat rurale kjo përfaqëson një mundësi për të ngritur industrinë e riciklimit në këtë rajon.

Pjesa e mbetur, e konsideruar si të tjerat, në të dy zonat përfaqëson një përqindje të konsiderueshme, pothuajse 21%. Është e rëndësishme të realizohen këto sondazhe për të përcaktuar drejtë përbërjen e mbetjeve dhe përqindjes së tyre, veçanërisht mbetjet e rrezikshme, si mbetjet spitalore apo industriale që hyjnë në rrjedhën e mbetjeve vendore, me qëllim trajtimin e çështjes nga autoritetet, mbetjet inerte e kështu me radhë.

3.3.1 Parashikimi i mbetjeve vendore në të ardhmen

Parashikimi i prodhimit të mbetjeve në të ardhmen lidhet ngushtë me rritjen e numrit të popullsisë në të kaluarën si dhe prirjet për prodhimin e mbetjeve në të kaluarën. Praktikisht, siç u përmend edhe më parë, komuna nuk ka të dhëna të besueshme për prodhimin e mbetjeve për 6 vitet e fundit për shkak të matjes së dobët të mbetjeve të depozituara. Për këtë qëllim, të gjitha të dhënat e marra nga regjistri i sektorit të shërbimit janë përshtatur duke marrë parasysh sasinë e supozuar për vitin 2010 dhe që lidhet me vlerësimin e koeficientit të prodhimit të mbetjeve si dhe prirjen e tij për 6 vitet e fundit. Viti 2010 do të merret edhe si referencë për të parashikuar sasinë dhe karakteristikat e mbetjeve në të ardhmen.

Sasia e mbetjeve në të ardhmen: Në tabelën e mëposhtme jepet parashikimi i prodhimit të mbetjeve në të ardhmen dhe për 5 vitet në vazhdim:

Viti		2011	2012	2013	2014	2015	2016
Totali i mbetjeve të gjeneruara (ton/ vit)		3,365	3,634	3,925	4,239	4,578	4,944
Popullsia + turizëm	ton/ vit	2,384	2,575	2,781	3,003	3,243	3,503
Njësitë tregtare	ton/ vit	981	1059	1144	1236	1335	1441

Tabela 5 Parashikimi i prodhimit të mbetjeve në plazhin e Velipojës

Supozimi i përbërjes së mbetjeve në të ardhmen: Po ashtu, pritet të rritet sasia e letrës, plastikës, dhe jo të degradueshmeve (p.sh., metali dhe qelqi). Në ana tjetër, këto rritje mund të rrisin vlerën kalorifike dhe potencialin riciklues të mbetjeve të prodhuara. Në të njëjtën kohë, sasi të relative të gjetheve, drurit, tokës dhe hirit kanë gjasa të jenë të njëjta dhe më së shumti të rriten në disa raste për shkak të topologjisë së shtëpive dhe ndërtesave private në plazhin e Velipojës. Në grafikun e mëposhtëm jepet prirja e përqindjes së rritjes së mbetjeve organike në 15 vitet në vazhdim:




Figura 8 Parashikimi i mbetjeve organike për të ardhmen

Ndryshimet në përbërjen e mbetjeve dhe karakteristikave të tyre do të ndodhin herët a vonë dhe lidhen me zhvillimin ekonomik si dhe qëndrimin e komunitetit ndaj prodhimit dhe gjenerimit të mbetjeve. Nuk ka metoda të sakta për të parashikuar ndryshimin dhe nuk ka histori për komunën e Velipojës për përbërjen e mbetjeve, ndaj ne do të mbështetemi në atë që kanë përcaktuar Plani Kombëtar i Mbetjeve dhe Strategjia Kombëtare e Mbetjeve për përbërjen e mbetjeve vendore.

3.4 Shërbimet e mbetjeve

Në radhë të parë, është e nevojshme përshkrimi i të gjitha mjediseve të administrimit dhe trajtimit të mbetjeve të përmbledhura në sistemin aktual të manaxhimit të mbetjeve. Kjo mënyrë na mundëson të kemi një pamje të përgjithshme të rrymave të mbetjeve të mbledhura, transportuara dhe trajtuara. Së dyti, ajo përcakton bazën për evidentimin se ku mund të bëhen përmirësime.

Figura 9 Mbledhja e të dhënave në komunën e Velipojës dhe vizitat në terren



Komuna ishte burimi bazë i mbledhjes së të dhënave. Sipas “Strukturës administrative komunale të mbetjeve”, të gjitha shërbimet e mbetjeve administrohen nga Sektori i Shërbimeve Publike në Komunën e Velipojës dhe kryhen në terren si gjithnjë dhe në mënyrë të përkohshme nga Njësia e Shërbimit Komunal.

Administrimi i mbetjeve në komunën e Velipojës përbëhet nga shërbimi i mbledhjes së mbetjeve të pjesës më të madhe të zonës së komunës (pjesa më e madhe e zonës urbane e fshatrave kryesore) dhe

mbledhjen e mbetjeve në zonën e plazhit të Velipojës (gjatë periudhës së verës), shërbimin e pastrimit të zonës së plazhit gjatë verës dhe mirëmbajtjen e pikave hyrëse dhe rrugëve pranë vendeve të depozitimit të komunës.

Figura 10 Vizitë në terren në pikat e grumbullimit të mbetjeve në zonën e plazhit



Përveç të dhënave të mbledhura në zyrat e komunës, u pa e rëndësishme evidentimi në terren i situatës aktuale të pikave të grumbullimit të mbetjeve, kazanët e mbetjeve dhe vendeve të depozitimit. Vizitat në terren kishin si objektive: (i) së pari të kuptohet se si i ka shpërndarë komuna pikat e grumbullimit të mbetjeve në zonën e plazhit, kushtet dhe numri i kazanëve të mbetjeve në një pikë grumbullimit; (ii) së dyti të ketë një pamje të përgjithshme të zonës së plazhit me rrëzë dhe sheshet e rrugët kryesore në qendrën e plazhit; (iii)

dhe së treti, vendndodhja dhe situata aktuale e vendit të depozitimit. Në fund do të ketë një vlerësim të përgjithshëm të sistemit, përfshirë operimin, mjediset, kostot, dhe cilësinë e shërbimeve.

3.4.1 Mbledhja

Gjatë gjithë vitit, shërbimi i mbledhjes së mbetjeve ofrohet në shumicën e fshatrave të komunës, kryesisht përgjatë rrugës kryesore të Komunës. Në pjesën e territorit të plazhit të Velipojës, shërbimi i mbledhjes së mbetjeve ofrohet vetëm gjatë periudhës së verës (maj – shtator).

Transferimi në pikat e grumbullimit (zonë plazhi apo zonë mbetjeshsh): Sistemi aktual funksionon në këtë mënyrë: Banorët, njësitë tregtare dhe institucionet depozitojnë mbetjet e tyre në pikën më të afërt të grumbullimit të mbetjeve. Pikat e grumbullimit të mbetjeve (PGM) janë vende të vogla publike, të caktuara nga komuna, çdo 130-200 m për mbledhjen e mbetjeve, ku gjatë periudhës së verës janë vendosur grupe kazanësh me kapacitet 1.1-1.7m³. Pas sezonit turistik, këto kazanë hiqen dhe nuk ka shërbim të rregullt për mbetjet në zonë.

Kontenierët (metalik/ plastik)	1.1 m ³ - metalik	1.7 m ³ - plastik
Nr. i kontenierëve	110	20
Nr. i kontenierëve të blerë në 2006	20	0
Nr. i kontenierëve të blerë në 2009-2010	40	20
Nr. i kontenierëve të dëmtuar	?	7

Tabela 6 Të dhëna për kazanët e mbetjeve (deri në Maj 2011)



Rrjedhimisht, gjatë vitit disa PGM kthehen në pika ilegale grumbullimi mbetjesh të karakterizuara nga pirqje mbetjesh urbane dhe të ngurta që nuk mblidhen për ditë me radhë. Gjatë sezonit të verës, zona e plazhit të Velipojës shërbehet nga 130 kazanë⁸ me rrota, ku 20 prej tyre kanë një kapacitet prej 1.7 m³ dhe 110 të tjerë kanë një kapacitet prej 1.1 m³. Gjithashtu, në zonë gjenden 70 vende të hapura grumbullimi të ndërtuara me beton, por që janë jashtë përdorimi.

Figura 11 Pikat ekzistuese të mbledhjes së mbetjeve në zonën e plazhit të Velipojës

⁸ Deri në maj 2011

Edhe pse komuna deklaron se ajo mbulon 100% të zonës së mbetjeve me shërbim të rregullt (mbledhja e përditshme e mbetjeve) dhe se ka mbuluar pjesën më të madhe të PGM-ve të zonës urbane, ka ende mangësi me infrastrukturën e mbetjeve. Në zonën e mbetjeve ka numër të pamjaftueshëm të kazanëve dhe pirgjet e mbetjeve dergjen në tokë, kryesisht rreth e rrotull kazanëve apo në pikat e dëmtuara prej betoni. Kjo situatë shkakton një pamje urbane dhe erë të pakëndshme, e cila shoqërohet me kosto të konsiderueshme për mbledhjen e mbetjeve dhe nivel të dobët të shërbimit. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për imazhin e keq që mund të japë, por më së shumti për shkak se puna dhe koha që duhet për mbledhjen e mbetjeve në tokë është shumë më e madhe sesa të mbledhësh mbetjet në kazanë. Në hartën e mëposhtme tregohet shpërndarja e pikave të mbledhjes së mbetjeve në zonën e plazhit të Velipojës.

Arsyet e dëmtimit të kazanëve

- Një nga arsyet që jetëgjatësia e kazanëve metalikë nuk është më e lartë se 2-3 vjet në zonën e plazhit është prania e jodit në ajër;
- Kazanët dëmtohen kur pastruesit gërmojnë për të mbledhur mbetjet e riciklueshme;
- Kazanët dëmtohen kur boshatisen në makinën e mbledhjes së mbetjeve;
- Kazanët dëmtohen nga zjarr-vënia e qëllimshme;
- Kazanët plastikë dëmtohen lehtësisht si nga zjarr-vënia e qëllimshme ashtu edhe nga zjarret aksidentale gjatë sezonit të verës për shkak të djegies së mbetjeve




Figura 12 Pikat e grumbullimit në zonën e plazhit të Velipojës

Sipas burimeve më të fundit të komunës, për periudhën Qershor-Gusht 2011, u vendosën në zonë rreth 200 kontenierë plastikë me kapacitet 1.1m^3 , nga një subjekt i kontraktuar për sezonin e verës. Ky numër i konsiderueshëm kontenierësh solli një përmirësim si të cilësisë së shërbimit ashtu dhe rritje të efektivitetit në grumbullimin e mbetjeve.

Shërbimi i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve konsiston në mbledhjen e përditshme të mbetjeve urbane nga pikat e grumbullimit që ndodhen në zonën e mbetjeve dhe transporti i tyre për në vendin e depozitimit. Gjatë sezonit të verës shërbimi ofrohet çdo ditë për pjesën më të madhe të kazanëve dhe dy herë në ditë veçanërisht në disa PGM, kryesisht në zonën më të dendur urbane të zonës së plazhit. Kazanët me rrota zbrazen mekanikisht gjatë ditës nga dy makina teknologjike, të marrë me qira, me

kapacitet 10 tonësh dhe tjetri, më i vogël, prej 5 ton. Komuna ka edhe një kamion të vogël me kapacitet 1.5 ton, të cilin e operon më së shumti për të mbështetur shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit në zonën bregdetare të Velipojës dhe më pak për mbledhjen e mbetjeve, veçanërisht në rrugët e ngushta ku makinat e tjera nuk veprojnë dot.

Sipas burimeve më të fundit të komunës, për të përballuar ngarkesën gjithnjë në rritje të mbetjeve, rritur frekuencën e zbrazjes si dhe duke marrë për bazë numrin e pamjaftueshëm të kontenierëve, gjatë sezonit të verës (Qershor-Gusht 2011), shërbimi i grumbullimit të mbetjeve u krye nga 3 makina teknologjike (të cilat u vunë në dispozicion vetëm gjatë periudhës së verës nga një kontraktor)

3.4.2 Pastrimi i rrugëve

Komuna e Velipojës ka për detyrë të ofrojë shërbimin e pastrimit të rrugëve në zonën e plazhit të Velipojës. Sektori i shërbimit në komunë është përgjegjës për pastrimin e zonës së plazhit (rërës) dhe shesheve e rrugëve kryesore në qendrën e zonës së plazhit. Komuna organizon një brigadë punëtorësh, të cilët pastrojnë zonën e rërës dhe sheshet e rrugët kryesore pranë qendrës së plazhit gjatë periudhës nga 1 prill deri në 30 shtator. Punëtorët punojnë me kohë të plotë, 6 ditë në javë, me një turn me një normë pastrimi prej 70,000 m² në ditë për pastrimin e zonës së rërës nga barishtet dhe mbetjet e tjera që sjell deti si dhe nga mbetjet e hedhura nga pushuesit si dhe një sipërfaqe prej 465,000 m² në ditë për sheshet dhe rrugët pranë qendrës së plazhit për t'i pastruar nga mbetjet që hidhen nga pushuesit, shitësit ambulantë dhe bizneset e tjera që kryejnë veprimtarinë e tyre në këtë zonë. Ata përdorin më së shumti fshesa dhe qese plastike, aty ku hidhen mbetjet.

Figura 13 Zona me rërë e plazhit të Velipojës



Komuna përgatit çdo ditë një plan pastrimi për zonën e plazhit, ku përshkruan procesin e



pastrimit, numrin e punëtorëve për çdo muaj, koston e shërbimit (kosto operative – pagat dhe sigurimet shoqërore; dhe investimet – shpenzimet për materiale). Numri i punonjësve

përgjegjës për të ofruar shërbimin e pastrimit ndryshon nga 28 vetë gjatë muajit maj në 60 punëtorë gjatë muajve korrik dhe gusht, që është edhe piku i sezonit. Cilësia e shërbimit të pastrimit vlerësohet kryesisht të jetë në kuotat normale, por sezoni i verës është i mbipopulluar dhe numri i punëtorëve gjatë kësaj periudhe është i pamjaftueshëm për të ofruar një shërbim të cilësisë së lartë. Edhe stafi i punëtorëve ka një nevojë absolute për investime në materiale të reja (fshesa të veçanta për zonën e plazhit, rroba pune, doreza, etj.). Në zonën e plazhit të Velipojës nuk ofrohet asnjë shërbim larje rrugësh në çdo kohë të vitit.

3.4.3 Depozitimi

Aktualisht, mbetjet vendore transferohen në vend-depozitimin e komunës që ndodhet 4.4 km nga plazhi i Velipojës. Vendi i depozitimit ndodhet në fshatin Pulaj dhe rreth 800 metra larg rrjedhës së Lumit Buna dhe në të njëjtën kohë nga kufiri kombëtar me Malin e Zi. Vendi i depozitimit me një sipërfaqe prej rreth 0.9 ha, pa standarde sanitare, ndodhet lart në një kodër dhe rreth 3 metra thellë, ku groposen mbetjet pa asnjë trajtim tjetër dhe komuna nuk ofron mbulimin me dhe të vendit të depozitimit.



Vendi i depozitimit ndodhet larg zonës së banimit, por ka ende nevojë për kujdes të veçantë sapo të rrethohet nga territore të ndjeshme dhe ujërat sipërfaqësorë.

Figura 15 Vendi i depozitimit në Velipojë

Çdo fillim sezoni, komuna e Velipojës merr me qira një traktor për të hapur rrugën me qëllim transportin e kamionëve për depozitimin e mbetjeve. Nuk ka sistem të ngritur për kullimin apo mbledhjen e gazit. Veprimet e tanishme dhe ato të kaluara po rezultojnë në degradimin e ujërave sipërfaqësorë dhe tokësorë, ndotjes së ajrit dhe të dy rrjedhave nëntokësore ujore pranë tij. Nuk ka



portë apo roje në vendin e depozitimit.

Autoritetet e komunës deklarojnë se mesatarisht 30-40 ton mbetje (duke përfshirë mbetjet e fshatrave të tjerë të komunës dhe ato që mbledhen nga pastrimi i plazhit të Velipojës, etj.) hidhen çdo ditë aty gjatë sezonit të verës.

Vendi i depozitimit është përdorur për rreth 7 vjet dhe sipas parashikimeve, ai mund të përdoret edhe për 2-3 vjet të tjera (1,200 m³ kapacitet mbetjesh për t'u depozituar), nëse administrohet në mënyrën e duhur. Sot⁹ shpenzohet 142 lek/ton mbetjesh për të ofruar depozitimin e mbetjeve. Vendi i depozitimit ka nevojë të menjëhershme për rehabilitim dhe mbyllje mjedisore me një kosto që ndryshon 50,000-100,000 Euro. Për këtë nevojitet kryerja e një studim të hollësishëm.

3.4.4 Riciklimi

Nuk ekziston asnjë nismë zyrtare për riciklimin apo nuk është prezantuar ndonjë sistem të ndarjes së mbetjeve në komunë deri tani. Ekziston vetëm një veprimtari informale dhe sporadike riciklimi nga romët, të cilët gërmojnë për materiale të ricikluara (kryesisht metale, lëndë plastike dhe plastikë LD) në pikat e grumbullimit (duke gërmuar brenda kazanëve metalikë) ose në zonën e depozitimit. Në kuadër të iniciativave të minimizimit të mbetjeve si një nga alternativat kryesore të piramidës së mbetjeve dhe bazuar edhe në sondazhet e ndarjes së mbetjeve, të përshkuar më sipër, nënvizojmë se zona ka një potencial për riciklim (rreth 14%) që përfaqëson një mundësi të vërtetë për të inkurajuar dhe ngritur industrinë e riciklimit në rajon.

3.5 Administrimi i mbetjeve inerte dhe ndërtimore

Mbetjet nga prishja e ndërtimeve apo të ashtuquajturat mbetje inerte janë mbetje si gurë, dhe, beton, tulla, etj., që mbeten nga veprimtaritë e ndërtimit, rindërtimit, riparimit dhe prishjes së ndërtesave dhe strukturave të tjera.

Aktualisht, komuna organizon herë pas here mbledhjen e mbetjeve të ngurta dhe masive që hidhen në mënyrë jo-formale pranë pikave urbane të grumbullimit të mbetjeve ose në zona të paautorizuara të depozitimit pranë zonës së plazhit. Nuk ka të dhëna zyrtare për sasinë e mbetjeve të ngurta që prodhohen në zonën e plazhit apo në nivel vendor, por thuhet se në nivel kombëtar kjo përbën 15-20% të sasisë së përgjithshme të mbetjeve. Autoritetet pretendojnë se ka një sasi të madhe materialesh të ngurta që prodhohen brenda zonës së plazhit, gjë që shkakton probleme serioze për mjedisin publik dhe një pengesë tjetër financiare për komunën.

3.6 Ekonomia dhe financimi

3.6.1 Buxheti vjetor dhe investimet

Komuna e Velipojës cakton një shumë nga buxheti i saj për pastrimin e bregdetit (plazhit) gjatë verës, për heqjen e mbetjeve urbane siç u përshkrua edhe më sipër. Sipas të dhënave të komunës për vitin 2010 u caktua një shumë prej 8,207,000 lekë nga buxheti total i shpenzimeve, ndërsa për vitin 2011

⁹ Deri në maj 2011

komuna akordoi një fond prej rreth 17,000,000 Lekë për pastrimin e plazhit vetëm për periudhën e verës (Maj-Shtator 2001). Përderisa pastrimi i zonës së plazhit përbën një objektiv për komunën, buxheti vjetor për 5 vitet e fundit është rritur në mënyrë progresive. (Shih tabelën e mëposhtme.)

Viti	Buxheti vjetor i Komunës (000 Lek)	Buxheti vjetor për shërbimin e pastrimit (000 Lek)	Rritja e buxhetit të pastrimit (%)	% e buxhetit të pastrimit / buxhetit total
2008	78,500	5,700		7%
2009	90,000	6,800	16.18%	8%
2010	114,500	8,207	17.14%	7%
2011		16,417	50.01%	

Tabela 7 Buxheti total vendor në komunën e Velipojës

3.6.2 Ndarja e kostove

Çdo vit komuna përgatit një projekt për pastrimin e zonës së plazhit. Ajo planifikon të gjithë bazën materiale të nevojshme sipas treguesve nga viti i kaluar si dhe sipas sugjerimeve dhe propozimeve të reja për përmirësimin e punës mjedisore në plazh. Mundësitë financiare për ndarjen e shumave përkatëse të buxhetit për një performancë të mirë mjedisore të shërbimit që përmirësohet në kohë ka qenë gjithmonë një problem për komunën, sepse burimet financiare të mundshme për t'u investuar në këtë shërbim deri tani nuk kanë përmbushur standardet e kërkuara. Në tabelën e mëposhtme tregohet me më shumë hollësi buxheti i shërbimit të pastrimit të plazhit të Velipojës që është caktuar për vitet 2010 dhe 2011 të ndarë sipas zërave në buxhet.

Zërat e buxhetit të pastrimit	2010	%	Projektuar- 2011	%
Pagat + sigurimet shoqërore (000 lek)	7,200	72%	9,520	81%
Shpenzimet e materialeve (000 lek)	2,800	28%	2,304	19%
Totali (000 lek)	10,000	100%	11,824	100%

Tabela 8 Zërat e buxhetit të pastrimit për zonën e plazhit të Velipojës

Sipas këtij projekti, shuma totale e buxhetit të parashikuar nga komuna për pastrimin e plazhit për vitin 2010 llogaritet të jetë 10,000,000 lekë, ku 72% e buxhetit mbulon pagat dhe sigurimet shoqërore të punëtorëve dhe vetëm 28% e buxhetit shkon për materialet e punës, kamionët, etj. Në vitin 2011, buxheti i planifikuar u rrit me 18% nga një vit më parë, por përsëri përqindja që mbulon shpenzimet për materiale është ende e ulët, madje më e ulët se një vit më parë. Ndërkohë shpenzimet faktike vetëm për sezonin e verës të vitit 2011 tejkaluan me 44% buxhetin e planifikuar në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit, rritjen e frekuencës së pastrimit të rrugëve, përmirësimin të kushteve të fushës së depozitimit të mbetjeve, etj, por pa investime të mirëfillta. Komuna ka nevojë urgjente për investime të rëndësishme në shërbimin e pastrimit.

3.6.3 Tarifa e pastrimit (të mbetjeve)

Realizimi i vjeljes së tarifës: Tarifat e pastrimit caktohen nga komuna dhe miratohen nga këshilli i komunës çdo vit. Tarifa familjare e pastrimit është një shumë e caktuar vjetore për t'u paguar nga familjet pavarësisht madhësisë së tyre. Nuk ka tarifa pastrimi të përkohshme apo tarifë mbetjesh për banorët e përkohshëm që kalojnë pushimet e tyre në plazhin e Velipojës (të cilët kanë një shtëpi të tyre në zonë) apo për pronarët e shtëpive apo dhomave që jepen me qira.

Deri në vitin 2010 tarifa familjare e pastrimit ishte 500 lekë në vit. Sipas të dhënave të mbledhura nga komuna, në tabelën e mëposhtme jepen: kostoja për shërbimin e pastrimit për vitin 2010, tarifa e pastrimit, të ardhurat e planifikuara për 2010 dhe të ardhurat e mbledhura për 2010.

Kosto e shërbimit të pastrimit për 2010 (000 Lek)	Tarifa e pastrimit	Lek/ unit	Të ardhurat e planifikuara (000 Lek)	Të ardhurat e mbledhura (000 lek)
10,000	Familjet	500	500	0
	Bizneset		4,500	4,937

Tabela 9 Vjelja e tarifës së pastrimit dhe të ardhurat vjetore nga mbledhja e saj

Sipas shifrave, komuna mbulon vetëm gjysmën e kostonë së shërbimit (49.4% të kostonë) nga të ardhurat që ajo mbledh vetëm nga bizneset. Edhe pse komuna ka caktuar zyrtarisht një tarifë familjare të pastrimit, ajo nuk ka mundur dot të vjelë të ardhura prej tyre, dhe pjesa tjetër e shumës subvencionohet nga burimet e tjera financiare të komunës. Gjithashtu komuna po përballet me një problem në lidhje me regjistrin e saktë të bizneseve dhe llogaritjet u bënë duke marrë një mesatare. Një ndryshim rrënjësor pati procesi i regjistrimit të bizneseve, hoteleve dhe shtëpive të pushimit gjatë fillimit të sezonit të verës të vitit 2011, e cila ndikoi jo vetëm për rritjen e të ardhurave për këtë vit por që do të shërbejë si një bazë e qëndrueshme për realizimin e të ardhurave në të ardhmen. Kështu, vetëm për periudhën Qershor-Shtator, komuna ka realizuar 7,507 mije lek vetëm nga tarifat e mbetjeve.

Praktikisht, familjarët paguajnë tarifën e pastrimit në zyrat e njësive administrative, ndërsa bizneset dhe institucionet i paguajnë kontributet e tyre direkt në zyrën e taksave dhe tarifave vendore. Gjatë verës komuna hap një zyrë të përkohshme në zonën e plazhit, ku banorët mund të paguajnë të gjitha taksat dhe tarifën, përfshirë edhe tarifën e pastrimit. Nuk ka pasur një procedurë detyrimi për mbledhjen e tarifës së pastrimit për familjet, kurse nga bizneset formale pagesa është e detyrueshme së bashku me tarifën dhe taksat e tjera vendore. Për vitin 2011, komuna i rishikoi, rriti dhe miratoi tarifën e pastrimit të familjeve duke e bërë atë 1,000 lekë.

Tarifa nuk është vendosur sipas parimit 'ndotësi paguan' apo parimit të parandalimit dhe kujdesit, por në llojin e veprimtarisë që kryejë ata: bizneset kanë një nivel tjetër tarife sipas veprimtarisë së tyre. Nuk është bërë asnjë studim i plotë për të analizuar nivelin e tarifave për secilën kategori dhe ky nivel është ende i pamjaftueshëm. Në bazë të të dhënave të komunës, në fillim të vitit 2011, këshilli i komunës miratoi tarifën e reja të pastrimit për kategori të ndryshme si më poshtë:

Tarifat e pastrimit	Lek/ njësi/vit
Tarifa e pastrimit për familjet	1,000
Ambulantët dhe transporti i mallrave	3,000
Produkte bulmeti, mish, peshk, bare, restaurante	15,000
Njësitë tregtare dhe personat juridik	7,000
Njësitë e ndërtimit	60,000

Tabela 10 Tarifat e miratuara të pastrimit për vitin 2011

3.7 Analiza SWOT e sistemit aktual të administrimit të mbetjeve vendore

Figura 16 Takime në komunën e Velipojës



Në takimet e ndryshme të organizuara në komunën



e Velipojës me grupin e punës dhe stafin e projektit u diskutua situata aktuale e shërbimit të administrimit të mbetjeve të ofruar nga komuna. Seminari synonte të përcaktonte potencialet e forta që ka komuna në këtë drejtim, ku çalon sistemi, cilat janë problemet e tij, dhe në fund cilat ishin hapat mundësitë që duhet të përdorë komuna për të përmirësuar shërbimin si dhe evidentimi i rreziqeve të mundshme që mund të hasë jo vetëm në nivel vendor por edhe qendror. Rezultatet e këtyre takimeve janë përmbledhur në analizën SWOT, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 11 Analiza SWOT e ofrimit të shërbimit të administrimit të mbetjeve

AVANTAZHET	DOBËSITË
<p>Çështjet e mbrojtjes së mjedisit dhe administrimit të mbetjeve janë deklaruar si përparësi rajonale dhe veçanërisht vendore, të theksuara dhe përcaktuara qartë në dokumentet e politikës së strategjisë vendore, planin e veprimit, etj. (Plani i Zhvillimit Ekonomik, Plani Vendor i Veprimit Mjedisor).</p> <p>Autoritetet vendore janë të ndërgjegjshme qe përmirësimi i administrimit të mbetjeve apo i pastrimit janë faktorë kyç në zhvillimin e turizmit; (të përcaktuar që në fillim të procesit të zhvillimit të Planit të Administrimit të Mbetjeve të Ngurta).</p> <p>Autoriteti vendor është përpjekur të përmirësojë shërbimin e pastrimit gjatë viteve të fundit, duke përgatitur dhe planifikuar projektet e veta të pastrimit; me anë të kësaj veprimtarie komunale, zyrtarët vendorë ka përfituar një përvojë të mirë praktike në terren.</p> <p>Autoritetet vendore kanë ndjekur një politikë mbështetëse/inkurajuese financiare kundrejt përmirësimit të infrastrukturës vendore të zonës, dhe veçanërisht të shërbimit të pastrimit në zonën e plazhit (duke rritur buxhetin për katër vitet e fundit) apo nisma vendore fiskale e vitit 2011 për rritjen e tarifave të pastrimit për familjet.</p> <p>Ka një rritje të interesit dhe të kërkesës nga bizneset dhe ekonomia vendore për përmirësimin e shërbimit të pastrimit, vullnet për të paguar edhe më shumë si dhe vullnet për të kontribuar në infrastrukturën e mbetjeve për një shërbim më të mirë pastrimi.</p>	<p><u>Ligjore dhe institucionale:</u> Aktualisht, mungojnë instrumentet ligjore vendore (p.sh., rregulloret për administrimin e mbetjeve, rregullat, standardet, detyrimet për ofruesit e shërbimit, qytetarët, bizneset, etj.);</p> <p>Mungesa e procedurave dhe udhëzimeve të qarta dhe të përshtatshme; personel i pamjaftueshëm fizik për organizimin, mbikëqyrjen, etj.</p> <p>Nuk ka procedura, apo ndonjë strukturë komune për monitorimin e nivelit të shërbimit dhe parandalimin e ndotjes urbane nga mbetjet;</p> <p><u>Burimet njerëzore dhe aftësitë teknike të menaxhimit:</u> Ashtu si në shumë autoritete vendore në Shqipëri, ka mangësi teknike dhe administrative në stafin vendor të administrimit të mbetjeve;</p> <p><u>Buxheti i kufizuar dhe mungesë investimesh:</u> Niveli i buxhetit për administrimin e mbetjeve është i ulët (vetëm 7-8% e buxhetit të përgjithshëm vjetor) larg nga përparësitë, objektivat dhe nevojat e komunës;</p> <p>Buxheti i miratuar aktual nuk ofron mundësi për përmirësimin e shërbimit apo për investimet e nevojshme në makineri dhe pajisje apo impiante;</p> <p>Nivelet aktuale të tarifave dhe sistemi i vjeljes së tarifave nuk janë të përshtatshme dhe nuk mjaftojnë për të mbështetur financiarisht ndryshimet e dëshiruara të shërbimit të pastrimit dhe as për të përdorur edhe më mirë burimet financiare të komunës.</p> <p><u>Niveli i shërbimit të pastrimit (efektiviteti dhe efikasiteti):</u> Sistemi i papërshtatshëm i mbledhjes së mbetjeve (përmbysja e kazanëve, ekzistenca e pikave të hapura apo të pastandardizuara të grumbullimit, mbulimi i pamjaftueshëm me shërbim);</p> <p>Ekzistenca e vendeve të paligjshme dhe zonave të ndotura nga mbetjet urbane; kosto e lartë (operative) e mbledhjes së mbetjeve; punë e dobët dhe rendiment i ulët i pajisjeve;</p> <p><u>Infrastrukturë e dobët e administrimit të mbetjeve:</u></p>

	<p>Kazanë të dëmtuar, kapacitet i pamjaftueshëm i kazanëve dhe vendeve të grumbullimit si dhe mungesa e kamionëve (të detyruar për t'u marrë me qira gjatë verës për një kosto të lartë dhe për të ofruar shërbimin për pjesën tjetër të vitit);</p> <p><u>Infrastrukturë e dobët</u> (impianti) dhe administrim i dobët në vendin e depozitimit, hapësirë e kufizuar depozitimi për të ardhmen (jo më shumë se 2 vjet);</p> <p>Kosto të larta dhe në rritje mjedisore për rehabilitimin dhe mbylljen e sigurt të vendit të propozjes; depozitim i pakontrolluar, nuk ka portë, nuk ka siguri;</p> <p>Mungesa e stafit, kushteve, zyrave, kushteve të sigurisë;</p> <p><u>Informacioni</u>: Nuk ka matje të besueshme të prodhimit të mbetjeve; mungesa e të dhënave teknike, statistikore, për konsumatorët (informacion i tipit si demografia, turistët, njësitë tregtare dhe të argëtimit, hotelet, etj.,)</p> <p><u>Ndërgjegjësimi publik</u>: Ndërgjegjësim i dobët i komunitetit (vendas dhe turistëve) për administrimin e mbetjeve dhe çështjeve vendore mjedisore;</p> <p><u>Mungesë e nismave zyrtare për minimizimin e mbetjeve</u></p>
MUNDËSITË	RREZIQET
<p><u>Lidhja e politikës kombëtare</u> për administrimin e mbetjeve (Strategjia Kombëtare e Administrimit të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Administrimit të Mbetjeve) me objektivat kombëtare (të parapëlqyera) të qeverisë shqiptare për përmirësimin e sektorit të turizmit dhe krijimit të mjedisit inkurajues drejt këtij sektori do të pasohet nga mbështetja financiare dhe infrastrukturë për njësitë e qeverisjes vendore në zonat bregdetare.</p> <p>Ka <u>mundësi në rritje për mbështetje financiare</u> nga qeveria qendrore, donatorët, programet e huaja nëse komuna ecën përpara me planifikimin e duhur të administrimit të mbetjeve të ngurta, përcakton dhe vendos veprimet dhe masat, projektet dhe nevojat për infrastrukturën e mbetjeve.</p> <p><u>Zhvillimi rajonal</u>: Aktualisht ka zhvillime rajonale për administrimin e mbetjeve, veçanërisht në infrastrukturën e trajtimit të mbetjeve (landfilli i Bushatit).</p> <p><u>Klima mbështetëse</u>: Ndërtimi aktual i kapaciteteve dhe përpjekjet financiare të mbështetura nga programet e huaja (p.sh., DLDP) në rritjen e kapaciteteve dhe</p>	<p>Vendndodhja aktuale e pikave të depozitimit dhe procedura e administrimit aktual i depozitimit; mungesa e masave të sigurisë dhe të parandalimit përbëjnë një <u>rrezik të mundshëm</u> për burimet natyrore (toka, uji, ajri) dhe për shëndetin e njeriut si dhe pengesë për zhvillimin e turizmit.</p> <p>Kjo do të rrisë koston mjedisore për mbylljen e sigurt të vend-propozjes kur kjo të bëhet e detyruar;</p> <p><u>Kapaciteti i kufizuar i depozitimit</u> dhe deri tani asnjë projekt vendor për vend të ri depozitimi do të sjellin së shpejti një situatë emergjence (nëse komuna nuk ka burime të mjaftueshme financiare për depozitimin përfundimtar në landfillin e Bushatit).</p> <p><u>Depozitimi aktual i paligjshëm apo sistemi i tanishëm i mbledhjes së mbetjeve</u> do të ndikojë dhe ndotë zonën urbane, zonat e pyllëzuara, bregdetin ranor përgjatë zonës së plazhit, do të dëmtojë veprimtaritë e turizmit, do të largojë turistët dhe rrjedhimisht do të pengojë zhvillimin ekonomik të komunës.</p>

njohurive vendore si dhe përmirësimi i infrastrukturës në fushën e administrimit të mbetjeve;

Financimi vendor: Zhvillimi i fortë dhe i qëndrueshëm ekonomik do të rrisë pushtetin e komunës për të rritur buxhetin e administrimit të mbetjeve, do të rrisë të ardhurat vendore nga mbetjet.

Pjesëmarrja e publikut: Ka një interes të shprehur dhe vullnet nga komunitetet vendore (veçanërisht për nismat vullnetare urbane të pastrimit dhe riciklimit).

Një interes të shprehur për organizimin e partneriteteve publik-privat (PPP) edhe nga bizneset, hotelet, etj., për organizimin e duhur të skemave të grumbullimit të mbetjeve (p.sh., ndarjen e kostove të investimeve) me përfitime të dyanshme. Për më tepër, këto skema do të shërbejnë për organizimin e mbledhjes së mbetjeve në burim dhe për veprimtaritë e riciklimit.

IV. PLANIFIKIMI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE

4.1 Vizioni

Vizioni i planit vendor të administrimit të mbetjeve të komunës së Velipojës u hartua si proces i analizimit, diskutimit dhe konsultimeve me palët e interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e planit (grupi i punës nga Co-PLAN, Inter-Cooperation dhe zyrtarë të komunës). Në fund, sipas synimeve për hartimin e administrimit të mbetjeve, vlerave dhe normave qytetare, realiteteve dhe sfidave, dhe dëshirës e bindjes për ndryshim, u ra dakord që vizioni i Komunës së Velipojës për zonën e saj bregdetare është:

“Velipoja, një zonë e pastër dhe destinacion i preferuar i turistëve”!

Qëllimi kryesor:

“Mbajtja e plazhit të Velipojës pastër për të përparuar drejt një zhvillimi të qëndrueshëm të turizmit”

4.2 Objektivat

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Mbetjeve kanë përcaktuar 3 periudha të rëndësishme kohore: faza e parë dhe e dytë (2010-2015 dhe 2015-2020) ku synohet përparimi drejt standardeve të BE dhe faza e tretë (2020-2025) ku synohet arritja e standardeve dhe objektivave të BE. Në këtë kuadër ky plan synon progresin gradualisht drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standarteve kombëtare e ndërkombëtare. Në fazën e parë (para-pranimi), plani do të adresojë nevojat lokale për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Fokusi në këtë fazë do të jetë në marrjen e masave emergjente për të ndryshuar situatën, përmirësimin e performancës vendore për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurt të mbetjeve, pastrimin e qytetit/komunës si dhe rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara. Siç rekomandohet në politikën kombëtare të mbetjeve, deri në 2015, *landfilli* do të jetë metoda kryesore për menaxhimin e mbetjeve urbane. Menaxhimi në nivel lokal do të përfshijë zbatimin e skemave të minimizimit të mbetjeve për të reduktuar në mënyrë progresive mbetjet për grososje. Në të njëjtën kohë do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimin e financave bashkiake për menaxhimin e mbetjeve. Për periudhën afatgjatë (faza e pas pranimi) synimet do të jetë në arritjen e objektivave strategjike kombëtare, në përputhje me standardet e legjislacionit të Komunitetit Evropian dhe principet e mbetjeve, për të minimizuar sasinë e mbetjeve që shkojnë në *landfill*.

Ky plan do të synojë të krijojë bazën për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori në Komunën e Velipojës, ndërsa përmbushja e standarteve të BE është jashtë pritshmërive dhe objektivave të këtij dokumenti.

Me qëllim përmbushjen e vizionit të planit si dhe bazuar në objektivat kombëtarë, u përcaktuan objektivat vendorë për një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, si më poshtë:

1. Përmirësimi i shërbimit të pastrimit në zonën e plazhit;
2. Ofrimi i një sistemi të efektshëm të administrimit të mbetjeve vendore;
3. Forcimi i kuadrit të politikës financiare dhe marrëveshjeve financiare për administrimin e mbetjeve të ngurta urbane;
4. Ofrimi i një baze të përmirësuar financiare të administrimit të mbetjeve të ngurta vendore sipas një sistemi të ri të mbledhjes së tarifave;
5. Përmirësimi i kushteve të vendit të depozitimit drejt mbylljes së tij mjedisore;
6. Minimizimi i mbetjeve dhe depozitimit të mbetjeve urbane;
7. Parandalimi i ndotjes nga prodhimi i mbetjeve të veçanta dhe atyre të rrezikshme;
8. Forcimi i bashkëpunimit ndërqeveritar dhe marrëveshja për monitorimin mjedisor;
9. Rritja e ndërgjegjësimit publik;
10. Nxitja për të shmangur dhe pakësuar (riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve në burim), duke e përfshirë atë në çdo fazë të prodhimit dhe konsumit;
11. Respektimi i objektive kombëtare për minimizimin e mbetjeve në nivel vendor dhe në zonat turistike.

4.3 Objekti i Planit

4.3.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Në bazë të legjislacionit, ky plan fokusohet në rrymën e mbetjeve komunale për të cilën komuna e Velipojës është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse.

Sipas përbërjes dhe mënyrës së manaxhimit të mbetjeve, mbetjet komunale do të klasifikohen në:

- **Mbetje urbane** (ushqim, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj¹⁰), dhe
- **Mbetje të veçanta komunale** (mbetje inerte e ndërtimore, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare brenda kufijve administrativë të qytetit;
- **Mbetje të rrezikshme** që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm të saj.

Në lidhje me burimet e gjenerimit të mbetjeve, mbetjet komunale ndahen në dy rryma mbetjesh, sipas burimit të origjinës: (MF) mbetjet e prodhuara nga familjet; (MB) mbetjet e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane. Ndërkohë, rryma të tjera mbetjes klasifikohen si mbetje voluminoze, mbetje të ngurta (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen ‘mbetje të veçanta’ për të cilat njësia vendore duhet t’i

¹⁰ Siç përshkruhet në “Karakteristikat e Mbetjeve”

ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

4.3.2 Integrimi me aktet nënligjore, studimet dhe dokumentet e tjera strategjike vendore dhe rajonale jo nga mbetjet

Me qëllim efektivitetin dhe integrimi me planet, strategjitë, aktet nënligjore apo studimet e tjera në nivel rajonal dhe vendor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, ky plan vendor për administrimin e mbetjeve duhet të marrë patjetër parasysh dokumentet e mëposhtme ndërkohë që përcakton objektivat apo evidenton dhe vlerëson mundësitë.

Plani Vendor i Veprimit për Mjedisin për Komunën e Velipojës (2006)¹¹: ku merren parasysh përkufizimet e tij, problemet mjedisore të identifikuara, të shkaktuara nga mbetjet apo jo, përparësitë dhe rekomandimet që janë marrë parasysh gjatë hartimit të këtij plani të manaxhimit të mbetjeve. Mes të tjerash, ky dokument përcakton si prioritare përmirësimin e manaxhimit të mbetjeve duke filluar që nga prodhimi i tyre, mbledhja, transporti dhe depozitimi përfundimtar. (drejt alternativës rajonale – landfilli i Bushatit), në respekt të vlerave natyrore, zhvillimit të qëndrueshëm vendor dhe shëndetit publik.

Zonat e mbrojtura: Ky plan i administrimit të mbetjeve ka marrë parasysh zonat e mbrojtura brenda dhe rreth komunës së Velipojës gjatë të gjithë procesit të evidentimit dhe vlerësimit të alternativave të administrimit të mbetjeve dhe skenarëve të mëposhtëm. Duke iu referuar Ligjit Nr. 8906, datë 6.6.2002, ‘Për Zonat e Mbrojtura’, VKM Nr. 682, datë 2.11.2005, ‘Për shpalljen e lumit Buna dhe të territoreve ligatinore përreth tij ‘Peizazh ujqor/tokësor i mbrojtur’’, VKM Nr. 683, datë 2.11.2005 ‘Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Liqenit të Shkodrës dhe zonës së Lumit Buna’ të përmendura edhe në Planin Vendor të Veprimit për Mjedisin, plazhi i Velipojës rrethohet dhe përbëhet nga zona të ndryshme të mbrojtura si më poshtë:


- (i) **Zona qendrore - A.1 (e paraqitur si “1a” në figurën 17 në hartën e zonave të mbrojtura si më poshtë)**, e cila sipas Ligjit Nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, ndryshuar me Ligjin Nr. 9868, datë 4.2.2008, dhe VKM Nr. 682, datë 2.11.2005, klasifikohet si zonë e mbrojtur e shkallës së parë, ku nuk lejohet asnjë lloj ndërhyrjeje në lidhje me infrastrukturën, zhvillimin e teknologjisë dhe veprimtarive të tjera turistike. Territoret që kanë këtë status janë: brigjet e Lumit Buna në pjesën perëndimore të rezervuarit ujor të Velipojës, nga grykëderdhja e lumit deri në anën veriore të Ishullit të Adës dhe 200 m në brendi të pjesës lindore të rezervuarit ujor; Ishulli i Franc Jozefit dhe zona bregdetare e pjesës lindore të grykëderdhjes së lumit, me një gjatësi prej 2 km dhe gjerësi 300 m në det me drejtim jugun; pjesa qendrore dhe veriore e lagunës së Vilunit, gadishullit i plazhit Baks-Rrjollli dhe një gjerësi prej 300 m në jug të vijës bregdetare deri në vendin e njohur si “Rana e Hedhun”.

¹¹ Përgatitur nga Jacobs, Lois Berger S. A. Dhe Qendra Mjedisore Rajonale në Shqipëri (2006)


- (ii) **Zona qendrore -A.2**, (e paraqitur si “1b” në figurën 17), e cila, sipas kuadrit ligjor të përmendur më sipër, klasifikohet si zonë e mbrojtur e shkallës së dytë, ku ndalohen rreptësisht hedhja dhe depozitimi i mbetjeve nga pjesët e tjera jashtë parkut kombëtar. Territoret që kanë këtë status përfshijnë Lumin Buna nga fshati Obot deri në pjesën e kundërt veriore të Ishullit Ada me një gjerësi prej 200 m në drejtim të lindjes, pjesa jugore e lagunës së Vilunit dhe deri në zonën moçalore që rrethon lagunën.
- (iii) **“Zonat e zhvillimit tradicional” dhe “Zonat e tranzicionit “C”**, të cilat sipas kuadrit ligjor kategorizohen si zonat të mbrojtura të shkallës katër, ku lejohet të zhvillohen vetëm veprimtari bujqësore dhe argëtuese që nuk ndikojnë në natyrë dhe biodiversitet, zhvillimin e qëndrueshëm dhe administrimin e burimeve natyrore të zonës.

Territoret që kanë këtë status janë:

- Zona e plazhit të Velipojës, e cila kufizohet me rezervuarin e Velipojës (në pjesën perëndimore), me autostradën (në pjesën veriore) dhe shtrihet në pjesën lindore deri në 500 m para kanalit që lidh me lagunën Viluni (që tregohen në hartë me “C” ose “3”);
- Zona e quajtur fushat e Velipojës (që tregohen në hartë me “2a”)



Harta e zonave të mbrojtura sipas VKM Nr. 682, datë 2.11.2005



Protected areas according to the Law for Protected Areas No. 8906, 2002
 Category
 I - Strict natural reserve/scientific reserve
 II - National Park
 III - Nature's Monument
 IV - Natural Managed Reserve/area of management of habitats and species

Figura 17¹² Zonat dhe peizazhet e mbrojtura në Komunën e Velipojës

¹² Plani Rajonal i Veprimit Mjedisor, Lumi Drin Delta Shkodër – Lezha (2006)

4.3.3 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit

Në funksion të organizimit më të mirë të shërbimeve dhe efijencës së sistemit që do të propozohet, rekomandohet që zona e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrative të qytetit të ndahen në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo është e rëndësishme që sistemet dhe metodat që do të identifikohen dhe analizohen në vijim të këtij plani të përshtaten më mirë me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

- (i) **Nënzona e parë (1)** zona bregdetare (siç tregohet në foto) me një gjatësi prej 3.1 km dhe gjerësi (zona e rërës) prej 150 m (me sipërfaqe prej rreth 465,000 m²); zona e plazhit (rëra kryesisht) mbulohet nga plazhet private (70), të cilët së bashku me pushuesit përfitojnë shërbimin e pastrimit ditor gjatë verës: largimin e mbetjeve dhe mirëmbajtjen dhe pastrimin e rërës nga punëtorët e komunës;
- (ii) **Nënzona e dytë (2)**, zona që vjen pas zonës së rërës, zonë e cila përbëhet nga a) qendra e zonës së plazhit të Velipojës: një zonë e dendur dhe mjaft e urbanizuar ku gjenden kryesisht njësi tregtare dhe argëtimi dhe ndërtesa të përkohshme banimi¹³; b) zona urbane veriore: një zonë më pak e dendur turistike e përbërë nga hotele, vila dhe disa njësi argëtimi, hapësirat e përbashkëta urbane janë të kufizuara dhe rrjeti rrugor është i dëmtuar dhe i pamjaftueshëm; dhe c) pjesa urbane jugore: ku ndodhen kryesisht vila dhe hotele, pak njësi argëtimi dhe disa ndërtesa të përhershme banimi. Edhe këtu rrjeti rrugor është i dëmtuar dhe ka kufizime në transport për disa zona urbane. Pikat e grumbullimit të mbetjeve ndodhen në rrugët kryesore, vetëm aty ku mund të futen makinat e mbetjeve
- (iii) **Nënzona e tretë (3)** ndodhet në pjesën lindore të plazhit të Velipojës (lindje të rrugës së hidroforit) dhe karakterizohet nga një zonë e rrallë urbane me ndërtesa të përhershme banimi dhe pak shtëpi private turizmi. Struktura e saj e urbanizimit mbetet prapa ku shtëpitë private shpërndahen në një zonë të madhe pa infrastrukturën bazë.

Banorët e përhershëm që jetojnë në shtëpi private (**370** familje të përhershme me **1,350** banorë të përhershëm) ndodhen brenda nënzonës 2 dhe nënzonës 3 dhe rreth 70,000 banorë sezonalë zënë kryesisht nënzonën e dytë dhe pak në nënzonën e tretë marrin shërbimin e mbledhjes së mbetjeve. Biznese të ndryshme, përkatësisht **52** biznese të vogla të përhershme, **4** shitës ambulantë të përhershëm dhe **14** biznese të mëdha, **300** biznese të vogla të përkohshme, **20** shitës ambulantë të përkohshëm, **300** hotele të përkohshme dhe **600** biznese të mëdha (shtëpi pushimi).

Sipas informacionit të marrë nga komuna, në këtë zonë ka disa shtëpi pushimi që zihen vetëm gjatë periudhës së verës. Pikat e grumbullimit të mbetjeve (me nga 1 deri në 2 kazanë për pikë) ndodhen në rrugën kryesore dhe rreth 200 m larg njëra tjetrës.

¹³ Hotelet, vilat dhe ndërtesat me apartamente zihen kryesisht në sezonin e verës.




Figura 17 Zonat e administrimit të mbetjeve në plazhin e Velipojës

4.4 Evidentimi i alternativave për administrimin e mbetjeve

Një element thelbësor i planifikimit të administrimit të mbetjeve është “evidentimi dhe shqyrtimi i alternativave”, d.m.th., marrja parasysh e mundësive të ndryshme teknike dhe strategjike për administrimin e mbetjeve sipas kapitujve kryesorë, vlerësimit të avantazheve dhe disavantazheve ekonomike, ligjore dhe teknologjike të këtyre alternativave.

4.4.1 Shërbimet e pastrimit

Synimi i komunës mbështetet në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar si dhe në rritjen e zonës së mbuluar me shërbim, përfshirë të gjithë zonën e plazhit dhe zonën urbane.

a) Pastrimi i plazhit: Komuna do të vazhdojë të ofrojë shërbimin e pastrimit të zonës së plazhit që në fillim të verës deri në fund të sezonit në një zonë prej rreth 465,000 m². Ky pastrim përbëhet nga faza përgatitore e shërbimit të pastrimit (nga prilli deri në fund të majit), e cila konsiston në pastrimin e rërës dhe zonës bregdetare të plazhit nga ndotësit dhe mbetjet e grumbulluara gjatë vitit. Kjo mund të kërkojë edhe përdorimin e mjeteve të mekanizuara për të lehtësuar mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve vëllimore.

Së dyti, komuna organizon pastrimin dhe mirëmbajtjen e përditshme të zonës së rërës (nga vija bregdetare deri në vijën ballore të shtëpive apo ndërtesave të tjera) që nga fillimi i qershorit deri në fund të shtatorit. Ky shërbim është një veprimtari e kushtueshme me punëtorë për të mbajtur plazhin të pastër nga ndotësit dhe kërkon praninë e një numri të madh punëtorësh që punojnë për një periudhë më të gjatë kohe (nga mëngjesi deri në mbrëmje) dhe vendosjen në vijë (paralel me vijën bregdetare) të rreth 80-100 koshave brenda zonës së plazhit me qëllim mbledhjen e mbetjeve të vogla. Norma e punës

për mbajtjen pastër të plazhit (zonës së rërës) ndryshon nga 10,000-16,000 m²/punëtor/ 8 orë, në varësi të frekuentimit dhe dendësisë së pushuesve.

b) Pastrimi i zonës urbane: Me përmirësimin e infrastrukturës urbane në veçanti në pjesën qendrore të zonës së plazhit dhe duke marrë parasysh se këto zona kanë një ndotje të madhe urbane nga mbetjet si rezultat një veprimtarie urbane dhe tregtare, bëhet e nevojshme për të organizuar një shërbim të rregull pastrimi (çdo ditë në zonën qendrore dhe më pak e shpeshtë në zonat e tjera) gjatë sezonit veror (qershor-shtator) për fshirjen e rrugëve dhe mbajtjen pastër të zonës së gjelbër. Edhe këtu, pranë rrugëve dhe zonës së gjelbër kërkohen vendosja e koshave të vegjël rrugorë për të mbledhur çdo ditë mbetjet.

Zona e asfaltuar mund të variojë nga 70,000-100,000 m² dhe norma e fuqisë punëtore varion nga 8,000 m²/punëtor/8 orë për rrugët e asfaltuara në qendër, në 10,000 -12,000 m²/ punëtor/8 orë dhe 16,000 m²/punëtor/8 orë.

c) Pastrimi i zonës së hapur: Edhe pse pjesa më e madhe e zonave publike (rrugët dhe hapësirat e tjera) janë të dëmtuara dhe infrastruktura urbane mbetet prapa, komuna synon të ofrojë një hapësirë të pastër dhe të lirë nga ndotja pa shpenzime të tjera financiare. Kjo do të thotë se komuna nuk duhet të organizojë shërbime të shpeshta pastrimit pasi do të ishte shumë e kushtueshme por do të ndërhyjë aty ku është e nevojshme (p.sh., një herë në muaj apo më pak) dhe do të bashkëpunojë me aktorët urbanë (pronarët e shtëpive dhe bizneseve) për të mbajtur pastër zonat përreth. Numri i rekomanduar i punëtorëve për volum pune për këtë lloj shërbimi pastrimi mund të jetë 16,000 – 20,000 m²/punëtor/ditë;

d) Rekomandime të hollësishme:

(i) **Organizimi i shërbimeve të pastrimit:** ekzistojnë tre mënyra me anë të cilave komuna mund të organizojë këtë lloj pastrimi: (i) duke punësuar një grup pune nga komuna, (ii) duke kontraktuar një operator privat, (iii) duke ia deleguar subjektit privat të përmbushë standardet e pastrimit brenda zonës së marrë me qira nga subjekti. Alternativa e dytë dhe e tretë kërkojnë një sërë rregullash dhe sanksionesh të qarta me qëllim që zyrtarët e komunës të kenë mundësi të vendosin standardet e pastërtisë.

(ii) **Parandalimi i ndotjes:** Cilësia dhe kostot e saj ndërlidhen drejtpërdrejt me nivelin e ndotjes, e cila në vetvete lidhet me ndërgjegjësimin dhe zbatimin e rregullave.

Në këtë aspekt, komuna:

- Do të hartojë masa për parandalimin e ndotjes dhe pastrimi i qytetit do të marrë një rëndësi kryesore në fushatat e ndërgjegjësimit dhe programet e edukimit;
- Realizojë kontrata efektive me qiramarrësit privatë të plazhit, do të qartësojë përgjegjësitë dhe detyrimet;
- Rregullorja vendore për administrimin e mbetjeve do të përcaktojë rregullat dhe ndëshkimet si dhe do të ngrejë një grup pune apo caktojë inspektorët vendorë për mbetjet për të zbatuar këto rregulla.

(iii) **Përmbush nevojat me burime njerëzore dhe infrastrukturë:** Me marrjen e vendimit për pastrimin e zonave me qira të plazhit, komuna duhet të planifikojë të përmbushë nevojat e saj me burime njerëzore dhe fizike.

(iv) **Orare pune të efektshme dhe të përshtatshme:** Për të vepruar sipas nevojave për pastrim dhe me kosto të ulët, komuna duhet të hartojë një program pune që të jetë efektiv dhe i përshtatshëm. Ky program duhet të merrë parasysh ndryshimet që ndodhin çdo ditë, javë, dhe muaj në lidhje me numrin e pushuesve dhe veprimtarive të biznesit.

4.4.2 Mbledhja e mbetjeve

Mbledhja dhe transporti i mbetjeve paraqet një nga proceset më të rëndësishme dhe më të evidentueshme të komunës për administrimin e mbetjeve. Ky proces fillon me marrjen e mbetjeve nga konsumatori, vazhdon me magazinimin në terren apo pranimin e mbetjeve, më pas vazhdon me mbledhjen dhe transportin e mbetjeve si dhe përfundon me depozitimin në destinacionit përfundimtar të depozitimit. Ka alternativa të ndryshme me të cilat mbetjet dërgohen, ruhen dhe mbledhen për lloje të ndryshme të konsumatorëve apo të përshtatshme për tipologjinë urbane. Këto alternativa përcillen për sa i përket mundësive dhe analizohen në lidhje me zbatueshmërinë e tyre në nivel komune apo në zona të veçanta të plazhit në komunën e Velipojës. Sipas legjislacionit aktual dhe tipologjisë së zbatuar më së shumti për mbledhjen e mbetjeve, komuna është përgjegjëse për të mbledhur vetëm “mbetjet urbane”¹⁴ siç u përshkruhet edhe më sipër. Mbetje të tjera që ndryshojnë në përmbajtje (përbërje) nga mbetjet urbane nuk pranohen nga sistemi i komunës për mbledhjen e mbetjeve. Gjithsesi, për disa mbetje të ashtuquajtura të veçanta që prodhohen nga banorët e komunës mund të organizohen metoda për mbledhjen e tyre veçmas nga sistemi i komunës. Ka, po ashtu, edhe kufizime të tjera në lidhje me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Megjithatë, sipas kuadrit aktual ligjor për administrimin e mbetjeve (Neni 12 i Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996), konsumatorët jo-banorë që prodhojnë mbi $\frac{1}{4}$ e sasisë që mund të vendoset në një kazan mbetjesh (zakonisht 1.1 m^3) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të mbledhjes së mbetjeve. Autoritetet vendore apo personat përgjegjës për mbledhjen e mbetjeve duhet të ofrojnë mundësi të tjera për metoda të mbledhjes dhe ruajtjes për të përmbushur kërkesën e konsumatorit dhe duke përdorur një nivel të ndryshëm tarife.

Përmirësimi i shërbimit të mbledhjes së mbetjeve përbën një nga objektivat kryesore të komunës për të rritur dhe përmirësuar administrimin e mbetjeve në Velipojë. Përmirësimi nënkupton rritjen e cilësisë dhe sasisë së sistemit të mbledhjes së mbetjeve, ku mbulimi me shërbim është një nga treguesit më të rëndësishëm të të gjithë performancës së pastrimit. (Shih treguesit e performancës së shërbimit.) Ka edhe tregues të tjerë që përbëjnë efikasitetin e shërbimit për sa i përket uljes së kostove të mbledhjes dhe transportit të mbetjeve, realizimit efektiv të orëve të punës, etj.

Komuna është e angazhuar të përmbushë sa më shpejt të jetë e mundur zgjerimin e shërbimit të standardizuar të mbledhjes së mbetjeve në cilësinë dhe efikasitetin e dëshiruar për të gjithë zonën e plazhit të Velipojës brenda dy viteve nga zbatimi i këtij plani.

¹⁴ Siç përshkruhet në seksionin 4.3.1 “Rryma e mbetjeve, objekti i planit”

Ka dy alternativa të mundshme për mënyrën e organizimit të shërbimit të mbledhjes dhe transportit të mbetjeve. Këto alternativa përmblihen më poshtë në lidhje me organizimin, infrastrukturën e nevojshme, rregullsinë dhe specifikime të tjera. Për secilën alternativë nënvizohen avantazhet dhe disavantazhet në lidhje me zbatueshmërinë, efektivitetin, mjedisin dhe burimet natyrore si dhe pranueshmërinë shoqërore. Ka edhe ndryshime mes dy alternativave për sa i përket përfshirjes së konsumatorit (qëndrimi pasiv apo aktiv). Kostot e këtyre alternativave analizohen më poshtë kur këto përmblihen në skenarë të mundshëm.

a) **“Skema e zakonshme e mbledhjes së mbetjeve”:**

Organizimi dhe elementët e skemës së zakonshme:

Kjo skemë e mbledhjes së mbetjeve është vazhdim i sistemit aktual të mbledhjes së mbetjeve (sistemi i mbledhjes së mbetjeve në anë të rrugës). Përmirësimi ose përparimi kërkohet në lidhje me cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve.

Kjo është metoda më e zakonshme e shërbimit që zbatohet në vend. Kjo metodë konsiston në mbledhjen e mbetjeve nga pikat e grumbullimit të mbetjeve (PGM). Këto PGM vendosen në anë të rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugë të tjera brenda zonave të mbetjeve, jashtë bizneseve dhe shtëpive, ku kamionët kanë akses të mjaftueshëm për të kryer periodikisht itinerarin e mbledhjes së mbetjeve (ec-ndalo-ec dhe nëse nevojitet edhe kthim) për të realizuar pa asnjë pengesë të mundshme në programin e punës së përditshme. Vendosja e PGM-ve do të pasojë planin aktual të PGM-ve që përdorej më parë dhe do të shtojë pika të reja aty ku do të jetë e nevojshme. Meqë dendësia e PGM-ve ndryshon edhe brenda një zonë mbetjesh dhe lidhet me dendësinë urbane të banorëve dhe bizneseve, kushti i infrastrukturës dhe disponueshmërisë së hapësirës, tabela e mëposhtme rekomandon disa standarde të largësisë mesatare mes llojeve të ndryshme të zonave urbane.

Tipet e zonave	Shumë të dendura	Të dendura	Mesatar	Të rralla
Distanca mesatare (m)	50-100	100-150	150-250	250-400

Tabela 12 Llojet e zonave urbane

Skemat plotësuese të mbledhjes:

Përveç skemës ekzistuese që në fakt duket i duhur dhe praktik, komuna duhet të prezantojë skema të tjera për të përballuar prodhimin e madh të mbetjeve në një zonë të caktuar apo me mbledhjen e mbetjeve nga konsumatorët e mëdhenj për të shmangur mbingarkimin e PGM-ve. Komuna duhet të organizojë më shpesh (dy dhe tre herë në ditë aplikuar dendur gjatë sezonit të verës së vitit 2011) mbledhjen e mbetjeve, që në fakt do të rrisë koston e shërbimit.

Ndërkohë, për të përballur mbetjet e tjera jo-urbane të prodhuara nga familjarët, komuna duhet të prezantojë skema të tjera, që mund të përfshijnë skemën “sille vetë”, ku njerëzit detyrohen të sjellin

mbetjet e tyre në vende të caktuara¹⁵ (p.sh., për qëllime riciklimi) dhe skemat “me thirrje/telefon”, ku qytetarët kontaktojnë autoritetet përgjegjëse apo kompanitë kur kanë mbetje, të tilla si psh. ato voluminoze, për ti larguar. Këto skema janë më të parapëlqyera për mbetjet nga kopshtet, mbetjet masive, të ngurta nga prishjet e ndërtimeve dhe duhet të zbatohet për aq sa komuna ka ngritur infrastrukturën e përshtatshme.

Itineraret:

Ky objektivi lidhet ngushtë me përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të operacionit për shkak të itinerarit më të mirë dhe punës së përmirësuar të makinave të mbetjeve. Ulja e kohës së përgjithshme të mbledhjes, më saktë – kohës së ngarkimit, shmangies së rrugëve me gjysmë ngarkesë apo përdorimi i kamionëve të mirë me kapacitet më të mirë ngarkimi do të rrisin efektivitetin dhe efikasitetin e mbledhjes së mbetjeve. Këta elementë janë marrë parasysh për “Analizën e infrastrukturës së mbetjeve.”¹⁶

Itineraret duhet të vendosen në letër kalk duke përdorur parimet/rregullat e mëposhtme:

- Itineraret nuk duhet të copëtohen apo të mbivendosen. Secili itinerar duhet të jetë kompakt, i përbërë nga segmentet e mbledhura në të njëjtën zonë gjeografike;
- Mbledhja totale si dhe koha e ngarkimit duhet të jetë në mënyrë të arsyeshme e njëjtë për secilin itinerar në komunitet;
- Itinerari i mbledhjes duhet të nisë sa më pranë garazhit(apo vendparkimit të kamionit) që të jetë e mundur, duke marrë parasysh rrugët me trafik të madh dhe ato me një kalim;
- Rrugët me trafik të madh nuk duhet të bëhen gjatë orëve të pikut;
- Në rastin e rrugëve me një kalim, është më mirë të fillohet itinerari në fundin e sipërm të rrugës, duke kaluar poshtë saj në kahun e rregullt;
- Shërbimet në rrugët pa krye mund të konsiderohen si shërbime për segmente rruge që mund të ndërpriten, përderisa ato mund të mblidhen vetëm duke kaluar poshtë segmentit të rrugës. Për të mbajtur kthesat djathtas në minimum, (në vendet ku automjetet lëvizin në krahun e majtë), mbledhja e mbetjeve nga rrugët pa krye bëhet kur ato janë në të majtë të kamionit. Këto mbetje duhet të mblidhen duke ecur për poshtë, mbrapsht apo duke bërë një kthesë në formë U;
- Mbetjet në kodra të pjerrëta duhet të mblidhen, aty ku është praktike, në të dy krahët e rrugës kur kamioni po zbret për poshtë. Kjo lehtëson mbledhje të sigurt, të lehtë dhe të shpejtë. Kjo ul edhe amortizimin e automjetit si dhe kursen karburant.
- Vendet e larta duhet të jenë në fillim të itinerarit;
- Për mbledhjen nga të dy krahët e rrugës në të njëjtën kohë, në përgjithësi është më mirë të bëhet itinerari në rrugë të drejtë sipas planit para se të kalohet në itinerarin në krahun e kundërt.
- Për konfigurime në blloqe të caktuara brenda itinerarit, duhet të aplikohen modele të caktuara itineraresh.

¹⁵ Administruar nga komuna ose privatët

¹⁶ Shtojca II i bashkëngjitet planit.

Lloji më i përshtatshëm i kazanëve për këtë alternativë është kazan i metalik i zakonshëm (të fortë dhe lehtësisht të riparueshëm), të lëvizshëm (me rrota) me një kapacitet prej 1.1 m³. Këto lloj kazanësh kanë nevojë për kamion teknologjik, me sistem hidraulik ngarkimi, që përdoret shumë në vendin tonë.

Pikat ekzistuese të mbledhjes së mbetjeve duhet të riorganizohen, madje të shtohen të reja në zonat më të populluara, dhe do të nevojitet të blihen kazanë të rinj me një kapacitet prej 1.1 m³ për të përmbushur nevojat e zonave, veçanërisht gjatë verës, kur zona mbipopullohet nga turistët. Numri i saktë i kazanëve të vegjël dhe i automjeteve si dhe specifikimet e tyre jepen në seksionin e investimeve të skenarëve për administrimin e mbetjeve.

Përmirësimi i punës së mbledhjes dhe transportit mbetet ende një çështje e rëndësishme për t'u arritur. Siç u nënvizua edhe në analizën SWOT, ka disa çështje të evidentuara në sistemin e mbledhjes së mbetjeve që lidhen me mungesën e efikasitetit të sistemit (kosto më të larta për njësi), automjete të amortizuara dhe kazanë të pamjaftueshëm, që kanë nevojë për rregullime dhe investime. Në përputhje me parimet e efektivitetit dhe efikasitetit, duke marrë parasysh mundësitë dhe kufizimet e kësaj skeme mbledhjeje të shqyrtuar më sipër, ky plan rekomandon normën e mëposhtme të shpeshtësisë së mbledhjes së mbetjeve:

Periudha e vitit	Shumë të dendura (gjatë verës)	Të dendura (gjatë verës)	Mesatare	Të rralla
1 Tetor- 30 Maj	-	-	2 herë në javë	2 herë në javë
1 Qershor-15 Korrik dhe 1-30 Shtator	ditore	ditore	ditore	Ditore ose 3 herë / javë
15 Korrik – 30 Gusht/ (ditë jave)	Ditore ose dy herë në ditë	ditore	ditore	Ditore ose tre herë/ javë
15 Korrik – 30 Gusht (fundjavë)	Dy herë në ditë	ditore	ditore	Ditore ose 3 herë/ javë

Tabela 13 Norma e mbledhjes së mbetjeve

Mbulimi me shërbim do të përbëhet nga të gjitha zonat e caktuara të mbetjeve duke ndjekur itineraret e paracaktuara të mbledhjes dhe PGM-të, të cilat tregohen në figurën e mëposhtme:




Figura 18 “Skema zakonshme e mbledhjes së mbledhjeve (elementët e ruajtjes në terren)”

b) **“Skema individual e mbledhjes së mbetjeve”**: Së bashku me skemën e zakonshme të mbledhjes së mbetjeve, komuna mund të provojë skema pilot të mbledhjes individuale të mbetjeve (e ashtuquajtura derë më derë” për konsumatorë të ndryshëm apo zona mbetjesh të ndryshme gjatë sezonit të verës (1 maj – 30 shtator). Synimi i përdorimit të skemës së mbledhjes individuale është si më poshtë: (i) rritja e performancës së shërbimit duke larguar mbetjet nga hapësirat publike, eliminimi i PGM-ve dhe për pasojë shmangia e mbingarkesës së këtyre pikave të grumbullimit; (ii) ofrimi i një shërbimi sa më pranë konsumatorëve duke i bërë ata më të ndërgjegjshëm dhe më aktivë në shërbimet vendore të mbledhjes së mbetjeve; (iii) mundësi për një shërbim më të mirë për zonat e mbetjeve ku nuk ka hapësirë të mjaftueshme për PGM; (iv) ofrimi i një shërbimi të barabartë dhe të drejtë ku konsumatorët (veçanërisht ata të mëdhenj) paguajnë për atë që prodhojnë; (v) ofrimi i një mundësie të mirë për ndarjen e mbetjeve; dhe, (vi) ofrimi i një shërbimi efektiv dhe efikas për zonat e largëta. Praktikisht, zonat e rekomanduara dhe konsumatorët për aplikimin e skemave individuale të mbledhjes së mbetjeve jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 14 Skema e mbledhjes së mbetjeve

Zonat ose nënzonat e mbetjeve	Karakteristikat e nënzonave	Nr. i bizneseve (hotele, restorante, komerciale, etc.)	Nr. i familjeve (duke përfshirë hotelet)
Nënzona 1 (lagjia veriore)	Rrugët e ngushta, zona për qëllime turizmi	-	Rreth 100 vila
Nënzona 2 (Zona e qendrës)	Densitet i lartë i zonave komerciale dhe njësitë argëtuese	70 njësi	Rreth 200 vila
Nënzona 3 (Lagjia jugore)	Zone turistike, i perbere nga vila dhe hotele, mundësi e mire per riciklim	30 njësi	Rreth 200 vila

Organizimi i skemës:

Siç u përmend edhe më parë, ky nuk është sistem i mirëfilltë i mbledhjes individuale të mbetjeve, sepse ka ende PGM dhe sistem të zakonshëm të mbledhjes së mbetjeve për pjesën më të madhe të konsumatorëve. Të dy sistemet mund të organizohen në një skemë të përbashkët ku itineraret ndërthuren në mënyrë të atillë që makina e mbetjeve të pastrojë çdo PGM (çdo ditë) si dhe të pastrojë kazanët individualë (dy apo tre herë në javë) sipas një skeme të paracaktuar. Konsumatorët individualë u kërkohet t'i mbajnë mbetjet e tyre brenda dhe t'i vendosin koshat jashtë (para pronës së tyre) në një orë dhe ditë të caktuar, para se të mbërrijë makina e mbetjeve.



Figure 19 Koshat e propozuar për bizneset (240 litra) dhe për familjet (50 litra)

Detyra e vetme e grupit të mbledhjes së mbetjeve është thjesht të shkarkojë koshat dhe të mos japë asnjë shërbim tjetër. Individëve u kërkohet të kujdesen dhe të pastrojnë koshat e tyre me qëllim sigurimin e higjienës së nevojshme dhe kushteve teknike për shërbimin. Koshat plastikë me rrota konsiderohen si lloji më i përshtatshëm i infrastrukturës së depozitimit të përkohshëm dhe i mbledhjes së mbetjeve për këtë skemë.

Për koshat më të përshtatshëm për mbetjet për zbatimin e skemës individuale rekomandohet të përdoren ato me kapacitet 240 litra për bizneset dhe 50-litërsh për familjet. Gjithsesi, ka disa përjashtime në rastin e konsumatorëve të mëdhenj¹⁷ ku kazanë të mëdhenj (1.1 m³) janë më të nevojshëm se koshat e vegjël. Edhe këtu është përgjegjësi e konsumatorit t'i nxjerrë kazanët në vendin dhe kohën e duhur sipas orarit. Shpeshtësia e rekomanduar e mbledhjes së mbetjeve për njësitë e biznesit është 3 herë në javë, kurse për familjet është 2 herë në javë.

¹⁷ Hotele me më shumë se 6 dhoma apo njësi të mëdha tregtare




Figura 20 “Skema individuale e mbledhjes së mbetjeve (elementë për mbajtjen në kosha deri në largimin e tyre)”

c) **Rekomandime të hollësishme:**

(i) Parandalimi i ndotjes: Cilësia dhe kostot e këtij shërbimi lidhen drejtpërdrejtë me nivelin e hedhjes së mbetjeve nga konsumatorët, që në vetvete lidhet me ndërgjegjësimin dhe zbatimin e rregullave. Në këtë aspekt, komuna duhet të hartojë:

- Një rregulla vendore për administrimin e mbetjeve, të përcaktojë rregullat dhe gjobat për hedhjen e mbetjeve dhe mbledhjen e mbetjeve. Si parakusht, komuna duhet të ngrëjë një grup pune apo ekipin e inspektorëve vendorë për mbetjet për të vënë në zbatim këto rregulla;
- Parandalimin e hedhjes së paligjshme dhe derdhjen e mbetjeve jashtë koshave, gjë që duhet të sjellë në vëmendje rëndësinë kryesore që kanë fushat e ndërgjegjësimin dhe programet e edukimit;
- Marrëveshje të mirë me konsumatorët e mëdhenj, qiramarrësit e plazheve private, etj., për të sqaruar përgjegjësitë dhe detyrimet.

(ii) Orar pune efektive dhe të përshtatshme: Për të operuar sipas nevojave të pastërtisë dhe në mënyrë të efektshme dhe me kosto të ulët, komuna duhet të hartojë një program efektiv dhe të përshtatshëm pune. Ky program duhet të marrë parasysh ndryshimet ditore, javore dhe mujore në lidhje me numrin e pushuesve dhe veprimtarive tregtare.

(iii) Numri i duhur i kazanëve: Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët, komuna duhet të sigurojë numrin e duhur të kazanëve apo koshave dhe rregullsinë e mbledhjes së mbetjeve.

(iv) Itinerar efektiv për mbledhjen e mbetjeve: Përcaktimi i saktë i itinerarit për makinat e mbetjeve do të ulë koston duke pakësuar forcat që shpenzohen për mbledhjen e mbetjeve. Planifikimi i itinerareve duhet të ndjekë parimet që u shtjelluan më sipër.

(v) Rritja e rendimentit në punë: Komuna apo kompania private duhet të gjejë mekanizma për të përmirësuar punën duke rritur rendimentin. Masat që mund të ndërmerren për të rritur moralin përfshijnë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës, pajisja me uniformë, stimujt për punë të mirë, trajnimi dhe forcimi i punës në grup.

(vi) Mirëmbajtja e përshtatshme e kazanëve dhe makinave: Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinave dhe pajisjeve janë çështje të rëndësishme për shërbimin e mbledhjes së mbetjeve. Pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga komuna apo është kontraktuar nga kompani private, komuna duhet të përcaktojë ose parashikojë në kontratë mirëmbajtjen e duhur dhe standardet e riparimit që duhet të vihen në zbatim.

4.4.3 Depozitimi i mbetjeve

Depozitimi përfundimtar i mbetjeve përbën një çështje të rëndësishme që kërkon vëmendje kryesore në këtë plan. Sipas Strategjisë Kombëtare të Administrimit të Mbetjeve dhe kërkesave të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, autoritetet vendore duhet të sigurojnë depozitim të sigurt të mbetjeve urbane. Si më e mira, rekomandohet që autoritetet vendore të mbyllin vend-depozitimet e pakontrolluara dhe të parashikojnë depozitim të mbetjeve në landfillet rajonale të ardhshme. Megjithatë, praktikisht nuk është kaq e lehtë që autoritetet vendore të kenë mundësi financiare për të ndryshuar dhe kaluar nga niveli aktual në një alternativë më të sigurt dhe më sanitare, veçanërisht për shkak të mungesës së fondeve, kapaciteteve, etj. Në këtë kuadër, të dy alternativat e mëposhtme konsiderohen si të vlefshëm dhe të mundshëm në kontekstin vendor.

a) Përdorimi i vend-depozitimeve vendore: Duke marrë parasysh gjendjen aktuale të vendeve të depozitimit dhe veprimtarinë ekzistuese të depozitimit të mbetjeve, siç u përshkrua edhe më sipër, është bërë e nevojshme që komuna të marrë masa/veprime të menjëhershme dhe themelore për të ndryshuar këtë realitet.

Është më mirë të bëhet e qartë se kjo alternativë nuk ofron një zgjidhje afatgjatë për aq kohë sa jetëgjatësia e vendit të depozitimit kufizohet (deri në 3 vjet: hapësira e lirë deri në 1,200 m³). Për më tepër, është e kuptueshme se pavarësisht nëse vend-depozitimi vendor zgjidhet si alternativa e parapëlqyer apo jo, komuna është e detyruar të parashikojë veprime të përshtatshme dhe fonde të mjaftueshme për mbylljen e këtij vend-depozitimi në përputhje me standardet kombëtare.

Së pari, nëse kjo alternativë e përkohshme shihet si më e përshtatshme për tre vitet e ardhshëm, komuna duhet të parashikojë të marra disa masa urgjente duke filluar me pastrimin dhe rehabilitimin e rrugëve për në vendin e depozitimit për të bërë të mundur që kamionët të shkarkojnë drejtpërdrejt në gropë. Si rezultat, masat përgatitore të ndërmarra nga komuna në fillim të sezonit veror nuk janë të mjaftueshme dhe duhet të paktën të ndërhyrjet një herë në muaj për të zbatuar këtë standard.

Së dyti, komuna duhet të ndjekë kërkesën ligjore për “Rehabilitimin e vendeve ekzistuese të depozitimit” (Neni 22 i Ligjit Nr. 9010, datë 13.02.2003, si më poshtë:

- Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, fushat ekzistuese të depozitimit të mbetjeve urbane i nënshtrohen administrimit paraprak në drejtim të:
 - (i) mbulimit me dhe' dhe ngjeshje;
 - (ii) hapjes së kanaleve të veçanta për ujërat e shiut, ujërat sipërfaqësorë dhe për ekstraktet e mbetjeve dhe grumbullimin e tyre në një basen të izoluar;
 - (iii) mbrojtjes nga zjarret;
 - (iv) ndalimit të hyrjes së personave të paautorizuar;
 - (v) mbulimit me dhe e gjelbërimit të pjesës së rrushes, ku nuk depozitohen me mbetje.

Së treti, komuna duhet të parashikojë hartimin e një studimi fizibiliteti për mbylljen mjedisore të vend-depozitimit në përputhje me kërkesat ligjore të përmendura më sipër për të siguruar mbrojtjen mjedisore të zonave të ndjeshme dhe të shëndetit të njeriut.

Pengesa kryesore për të zbatuar këtë alternativë lidhet me financat e pamjaftueshme vendore për të mbështetur investimet e nevojshme për vend-depozitimin për rehabilitimin dhe mbylljen përfundimtare të tij. Në bazë të përvojës së huaj në rajon, llogaritet se investimet për mbylljen mjedisore të vend-depozitimit (të ngjashëm me atë të Velipojës) arrin në 50,000-100,000 euro. Studimi i fizibilitetit duhet të përcaktojë shumën e saktë të investimit.

Një tjetër alternativë është të rehabilitohet vendndodhja aktuale për sa i përket rritjes së jetëgjatësisë, gjë që do të kërkonte investime më të mëdha dhe më pak shanse që të bëhet për sa kohë që politika kombëtare dhe qeveria qendrore nuk mbështesin ndërtimin e vend-depozitimeve të reja në nivel vendor. Megjithatë, faktori më i rëndësishëm kundër kësaj alternative lidhet me vendndodhjen aktuale brenda zonës së mbrojtur (2a), e klasifikuar si zonë e mbrojtur e "shkallës 4" dhe e rrethuar nga zona të ndjeshme të mbrojtura (nën kategoritë 1 dhe 2) dhe gati 800 m larg grykëderdhjes së Lumit Buna. Kjo e ka bërë këtë alternativë depozitimi si të papranueshme.

b) Alternativa rajonale – landfilli i Bushatit: Alternativa tjetër për depozitimin e mbetjeve është landfilli i Bushatit, që është rreth 37 km nga plazhi i Velipojës. Ky landfill u ndërtua sipas kuadrit ligjor shqiptar dhe standardeve teknike për një landfill modern, të parashikuar në direktivat e BE-së (EC 1999/31/EC). Duke ditur faktin se landfilli i Bushatit është projektuar për t'u përdorur për rreth 20 vitet e ardhshme me një kapacitet prej 47,000 ton/vit, kjo alternativë kthehet në një zgjidhje afatgjate. Kjo do të thotë se çfarëdo zgjidhje që të gjendet, depozitimi në landfillin rajonal të Bushatit mbetet zgjidhje e detyrueshme pas 3 vjetësh.

Pengesa kryesore e kësaj alternative është distanca e madhe e transportit (37 km) për në landfill të Bushatit, e cila rrit koston e transportit dhe të mbledhjes së mbetjeve me të paktën 32%. Përveç kësaj, kostoja totale e depozitimit rritet me 6.5 here (nga kostoja aktuale operative prej 142 lek/ton), sepse tarifa për hyrjen në landfillin e Bushatit has arritur nivelin e 7 euro/ton.

4.4.4 Riciklimi dhe kompostimi si alternativa të përshtatshme për minimizimin e mbetjeve

Minimizimi i mbetjeve paraqet një sërë qasjesh, metodash, veprimtarish dhe procesesh që synojnë ulen e vëllimit të mbetjeve për t'u përpunuar përfundimisht. Kuadri aktual ligjor dhe politika kombëtare¹⁸ për administrimin e mbetjeve në Shqipëri kanë rekomanduar që autoritetet vendore të nisin zbatimin e metodave të minimizimit të mbetjeve që nga niveli i prodhimit të mbetjeve deri në procesin e trajtimit përfundimtar të tyre. Qëllimi kryesor i politikës kombëtare është të *“ofrojë një sistem të integruar të menaxhimit të mbetjeve, e cila deri në 2025 do të riciklojë ose dekompozojë më shumë se gjysmën e këtyre mbetjeve, do të depozitojë më pak se 1/3 dhe do të rigjenerojë energji nga mbetjet.”* Për më tepër, kjo politikë përcakton objektiva dhe synime specifike për njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me metodat të caktuara për lloje të caktuara mbetjesh. Tabela e mëposhtme përmbledh këto objektiva të administrimit të mbetjeve siç përcaktohen në PKMM (2011):

Tabela 15 Objektivat kombëtarë sipas Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve

Objektivi	Afatet Kohore			Kerkesat Ligjore ¹⁹	Autoriteti Përgjegjes
	2010-15	2015-20	2020-25		
Pergatitja per ri-perdorim dhe riciklim (sasia ne % e peshes) e letres, plastikes, qelqit, metalit, mbetjeve-bio, vajrave te makinave oils	minimumi 20%	50%		Direktiva 2008/98/EEC mbi mbetjet, artikulli.11.2.a	Cdo Bashki dhe biznes riciklimi
Riciklimi ne permasa te medha te plastikes (jo-paketim)	100%	100%	100%	Direktiva 2008/98/EEC mbi mbetjet, artikulli.11.2.a	Cdo Bashki dhe biznes riciklimi
Pergatitje per ri – perdorim, riciklim, rikuperim perfshire operacionet mbushese ku mbetjet zevendesojne lendet e para (sasia ne % per peshe)	minimumi 30% toke dhe gure qe nuk jane te rrezikshme	70%		Direktiva 2008/98/EEC mbi mbetjet. Artikulli. 11.2.b	Cdo Bashki dhe biznes riciklimi
Reduktimi i sasise se mbetjeve-bio qe kalojne ne landfill (sasia ne % e peshes e sasise se derguar ne 2010)	deri 75%	50%	35%	Direktiva e Landfill 1999/31/EC, artikulli.5.2.a,b,c	Cdo Bashki, administratoret e landfilleve, kompanite private dhe publike te transportit dhe depozitimit te mbetjeve

¹⁸ Strategjia Kombëtare e Administrimit të Mbetjeve (2011), Plani Kombëtar i Administrimit të Mbetjeve (2011)

¹⁹ Derisa kriteret legal europiane priten te behen te detyrueshme pas 2015, qeveria Shqiptare ka percaktuar objektivat vetem pas ketij kufiri.

Perzierja (dhe tretje) e mbetjeve-bio	25%	50%	65%	Direktiva e Landfill 1999/31/EC, artikulli.5.2.a,b,c	Cdo bashki, bizneset e perzierjes, femeret
Perpunimi/djegia e mbetjeve te paketimit me energji te rikuperueshme (sasia ne % sipas sasise)	50%			Direktiva e Paketimit dhe e Paketimit te Mbetjeve 94/62/EC, artikulli.6.1.a; 6.1.c)	Cdo bashki, biznes riciklimi, kompanite private te diegies, kompanite e transportit, stacionet e transportit
Riciklimi i mbetjeve te paketimit (sasia ne % sipas peshes)	25% me nje minimum prej 10% per cdo material paketimi	45% me nje minimum prej 15% per cdo material paketimi	55-80% ne total	Direktiva e Paketimit dhe e Paketimit te Mbetjeve 94/62/EC, artikulli.6.1.a; 6.1.c)	Cdo bashki dhe biznes riciklimi
Riciklimi i qelqit ne mbetje paketimi (sasia ne % sipas peshes)	20%	40%	60%	Direktiva e Paketimit dhe e Paketimit te Mbetjeve 94/62/EC,	Cdo bashki, biznes riciklimi, kompani transporti, kompani eksporti
Riciklimi i letres dhe derrases ne mbetje paketimi (sasia ne % sipas peshes).	20%	40%	60%	Direktiva e Paketimit dhe e Paketimit te Mbetjeve 94/62/EC, artikulli.6.1.e	Cdo bashki, biznes riciklimi, vend transferimi, kompani transporti dhe kompani eksporti.
Riciklimi i metalit ne mbetje paketimi (sasia ne % sipas peshes)	20%	40%	50%	Direktiva e Paketimit dhe e Paketimit te Mbetjeve 94/62/EC, artikulli.6.1.e	Cdo bashki, biznes riciklimi, vend transferimi, kompani transporti dhe kompani eksporti.
Riciklimi i lendeve plastike ne mbetje paketimi (sasia ne % sipas peshes)	20%	40%	22.5%	Direktiva e Paketimit dhe e Paketimit te Mbetjeve 94/62/EC, artikulli.6.1.e	Cdo bashki dhe biznes riciklimi
Riciklimi i lendes drusore ne mbetje ambalazhimi (sasia ne % sipas peshes)	5%	10%	15%	Direktiva e Paketimit dhe e Paketimit te Mbetjeve 94/62/EC, artikulli.6.1.e	Cdo bashki bizneset e riciklimit

Norma minimale e grumbullimit: (a) 25 % deri në 26 Shtator 2012; (b) 45 % deri në 26 Shtator 2016.		2020 25%	2025 45%	(Direktiva 2008/103/EC) Artikulli 10(2)	Bashkite Vendore
Grumbullim i vecuar i MPEE nga banesat private	2015			Direktiva e MPEE 2002/96/EC Artikulli 5(2)	Bashkite Vendore
Shkalla e aritur e mbledhjes se vecuar ne te pakten kater kilogram per person ne vit MPEE nga panesat private.	2015			Direktiva e MPEE 2002/96/EC Artikulli 5(5)	Bashite Vendore

Në fakt, miratimi i objektivave kombëtare në nivel vendor kërkon një diskutim të gjerë duke filluar që nga përzgjedhja e alternativës më të realizueshme, më ekonomike dhe më të pranueshme nga ana sociale që mund të administrojë dhe zbatojë me sukses qeverisja vendore. Përderisa kohëzgjatja e këtij plani është mbi 5 vjet, objektivat e tij vendorë për minimizimin e mbetjeve do të synojë përbushjen e objektivave të vitit 2015 të përcaktuar në PKMM.

Ka shumë argumente që mbështesin apo kundërshtojnë nismat vendore për minimizimin e mbetjeve dhe më konkretisht për riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve. Këto metoda janë analizuar në kontekstin vendor duke filluar që nga vlerësimi i përgjithshëm për zbatimin e tyre në terren. Kërkesa për minimizimin e mbetjeve nuk kufizohet vetëm me përbushjen e objektivave kombëtare por edhe si mënyra e vetme për të zvogëluar barrën financiare të shkaktuar nga rritja e tarifës së depozitimit. Për më tepër, sipas PKMM-së, që nga viti 2015 njësitë e pushtetit vendor nuk do të lejohen të përdorin vend-depozitimet e tyre të pakontrolluara dhe alternativa e së ardhmes do të jetë depozitimi në landfillin rajonal. Këto kufizime për depozitimin përfundimtar do t'i shtynë autoritetet vendore të gjejnë zgjidhje të tjera për të minimizuar barrën e mbetjeve, të tilla si riciklimi dhe kompostimi. Për më tepër, këto alternativa do të marrin mbështetje të madhe nga qeveria qendrore dhe institucionet e huaja (me mbështetje financiare dhe teknologjike). Forcimi i biznesit dhe industrisë së riciklimit në vend dhe në rajonin e Shkodrës do të jetë faktor i rëndësishëm së bashku me aktorët kryesorë për zhvillimin e skemave të riciklimit. Një argument i rëndësishëm në favor të kompostimit është fakti se disa nga banorët e përhershëm që jetojnë në zonat e largëta të komunës përdorin mbetje organike si ushqim kafshësh e qëllime të tjera.

Pengesat kryesore për fillimin e riciklimit dhe kompostimit lidhen me kosto shtesë që komuna duhet të përballojë për të ngritur sistemin e ndarjes së mbetjeve. Ndaj, kostoja e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve do të rritet me 25-30% vetëm nga kalimi në sistemin e thjeshtë të mbledhjes së mbetjeve drejt sistemit me 3 kosha.²⁰

Së dyti, skema aktuale e plazhit të Velipojës është klasik, ku mbetjet mblidhen dhe transportohen të përzier pa ndjekur procesin e ndarjes. Në zonë nuk ka tregje apo aktorë të interesuar për të marrë një

²⁰ Co-Plan. (2010). "Plani Vendor për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta të Qytetit të Fierit, faqe 71

pjesë për riciklim. Praktikisht, si në shumë bashki dhe komuna të tjera në Shqipëri, disa romë që gërmojnë në pikat e grumbullimit të mbetjeve duke mbledhur metale (kanoçe) dhe i transportojnë vetë (me mjetet e tyre) në qytetin e Shkodrës. Komuniteti dhe bizneset nuk janë të informuar dhe ndërgjegjësuar për proceset e ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve, gjë që pengon nismat e ardhshme të riciklimit. Për më tepër, kjo do të kërkojë fonde të tjera për të mbështetur programet dhe nismat ndërgjegjësuese dhe edukative për të rritur cilësinë dhe sasinë e përfshirjes së komunitetit.

Vlerësimi ekonomik i riciklimit të mbetjeve është një detyrë e vështirë, sepse shumë nga ndikimet përfituese mjedisore dhe shoqërore të riciklimit janë afatgjate dhe të paprekshme, ndaj ato janë të vështira për t'u përcaktuar nga ana sasiore. Baraspesha midis përfitimeve (përfshirë përfitimet ekonomike të shitjes së materialeve të ricikluara apo kostot e kursyera të depozitimit) dhe kostos së drejtpërdrejtë për ndarjen dhe transportimin e mbetjeve është një faktor thelbësor në favor apo kundër zhvillimit të këtyre veprimtarive në një shkallë më të gjerë. Po ashtu, kjo lidhet edhe me burimet e disponueshme financiare për të subvencionuar këto veprimtari.

Këto do të kërkojnë interesin dhe përfshirjen e sektorit privat (biznesi i riciklimit) dhe përfshirjen aktive të publikut. Përderisa nuk është një proces i thjeshtë i projektuar për të filluar në një terren të panjohur, kjo na bën të ndërgjegjshëm për të nisur dhe ndërmarrë hapa të kujdesshëm në mënyrë graduale nga skemat pilot drejt atyre të krijimit të plotë të skemave të riciklimit dhe kompostimit në zonën e plazhit.

Riciklimi

Riciklimi është një nga pjesët themelore të administrimit të mbetjeve. Edhe pse vetëm ai nuk mund të zgjidhë problemet vendore të administrimit të mbetjeve të ngurta, ai mund të drejtojë një sasi të konsiderueshme të mbetjeve nga transportimi dhe depozitimi në landfill. Ashtu siç është përcaktuar në seksionin e ndarjes së mbetjeve, rreth 90% e mbetjeve të prodhuara në vit në zonën e plazhit të Velipojës vjen nga turistët dhe bizneset gjë që tregon se ka karakteristika të ngjashme me përbërjen e mbetjeve në qytetet fqinje në rajon (si në Shkodër dhe Lezhë), ku komponenti i riciklueshëm të mbetjeve përbën rreth 43%²¹ të totalit.

Rreth 35% e sasisë së mbetjeve vendore (në zonën e plazhit) ka potencialin për t'u ricikluar, në formën e letrës, kartonit, plastikës, qelqit dhe metaleve me interes të madh nga industria e riciklimit në vend. Këto fakte mbështesin idenë se ka potencial të mirë për riciklim në zonën e plazhit të Velipojës gjatë sezonit të verës. Komuna duhet të punojë për të rritur sipërmarrjen në riciklim dhe për të nxitur nismat publike-private në këtë fushë.

Nxitja e skemave efektive për ndarjen e mbetjeve dhe zbatimin e programeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit dhe bashkëfinancimi mund të realizojë partneritete të suksesshme publike-private. Përfshirja e sektorit privat, me anë të koncesionit apo PPP do të inkurajohet si një mekanizëm për ofrimin e zgjidhjes më të mirë ekonomike që do të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.

Ndarja e mbetjeve

Ndarja e mbetjeve ka qëllime të ndryshme, si ndarja e materialeve të rrezikshme nga mbetjet vendore, deri tek roli thelbësor për të ndarë mbetjet e riciklueshme e duke përfunduar në përmirësimin e

²¹ Duke iu referuar rezultateve të "Sondazhit të Përbërjes së Mbetjeve në Shqipëri"

trajtimit të mbetjeve organike për kompostim. I gjithë sistemi i ndarjes përbëhet nga dy komponentë: sistemi parësor i ndarjes dhe sistemi dytësor i ndarjes.

Sistemi parësor i ndarjes: Njihet gjerësisht se ndarja në burim jep rezultatin më të mirë të ndarjes. Ndarja në burim i referohet ndarjes së materialeve të riciklueshme dhe të ripërdorshme në pikën e prodhimit të tyre.

Në fakt, përdorimi i sistemit të mbledhjes individuale (alternativa e mbledhjes individuale) nga familjet, hotelet dhe bizneset, siç u përshkrua edhe më sipër, përbën bazën për ngritjen e sistemit të ndarjes. Ia vlen të përmendim këtu se sistemi i ndarjes në burim duket më i preferueshëm sesa sistemi i riciklimit për mbetjet e rrugës për shkak të faktit se ai kërkon pjesëmarrjen e përkohshme të banorëve (nga çdo ditë deri në 2 javë). Nga kjo pikëpamje, angazhimi dhe përfshirja e pronarëve apo personave të kontaktit të bizneseve, hoteleve apo shtëpive siguron më shumë efektivitet dhe mundësi financimi sesa sistemi i hapur në të cilin mbështetet skema e mbetjeve të rrugës.

Koshat për ndarjen e mbetjeve në burim mund të vendosen në secilën shtëpi apo njësi biznesi dhe do të ndjekë të njëjtën teknologji si sistemi i mbledhjes individuale. Sistemi duhet të jetë sa më i thjeshtë duke synuar vetëm ato mbetje apo komponentë që mund të riciklohen. Për këtë arsye, sistemi me dy kosha duket më i favorshëm se të tjerët. Kjo nënkupton caktimin e një kodi me ngjyra për alternativën me dy kosha që konsumatorët ta kenë parasysh kur vendosin dhe ndajnë mbetjet në këto kosha.

Ngjyrat duhet të përcaktohen qartësisht që në fillim:

- Një kosh specifik për secilin lloj mbetjeje që do të riciklohet;
- Sistemi me dy kosha: një për materialet e thata të përziera që mund të riciklohen dhe një për materialet për depozitim;
- Koshi blu për materialet e thata të riciklueshme dhe koshi i zi/gri për mbetjeve vendore.



Figura 21 “Modele të ndarjes së mbetjeve në burim”

Në rast të burimeve të pamjaftueshme financiare, komuna mund të zbatojë skema me kosto të ulët, p.sh., duke përdorur vetëm qese plastike në vend të koshave plastikë.

Kjo skemë ka nevojë në radhë të parë të provohet për të matur përshtatshmërinë dhe efektivitetin dhe më pas të zbatohet në një nivel më të lartë.

Grupi i targetuar:	Familje sezonale si dhe bizneset sezonale
Zona Pilot:	Përfshin 150 familje të përkohshme, 100 hotele dhe njësi komerciale dhe argëtimi;
Objektivi per te bere gati per riciklim	43 ton në vit (20% e totalit)
Kosto e perafert	Rritet me 4.5% koston e plotë për manaxhimin e mbetjeve

Tabela 16 “Grupi i propozuar i synuar për të zbatuar skemën pilot të riciklimit”

Sistemi dytësor i ndarjes: Zakonisht stacionet e riciklimit punojnë si plotësues për zgjidhje të tilla dhe shpesh marrin edhe pjesë të tjera të mbetjeve të komunës, të tilla si mbetje masive apo ato të rrezikshme si dhe mbetje të tjera të veçanta. Siç tregon edhe përvoja e mëparshme, sa më i aksesueshëm dhe pranë zonave të banimit aq më shumë ndahen mbetjet duke mundësuar funksionimin e skemës së marrjes në shtëpi dhe skemës me telefonatë dhe në të njëjtën kohë duke inkurajuar komunitetin dhe biznesin t’i sjellin vetë materialet e ricikluara. Gjithsesi, kjo fazë e ndarjes mbetet ende një alternativë e parakohshme për momentin në nivel komune. Nismat private, të komunitetit apo (të romëve) do të nxiten edhe më tej me ngritjen e skemës parësore.

Kompostimi

Kompostimi nuk e zëvendëson impiantin përfundimtar të depozitimit, por ai ul sasinë e mbetjeve që duhet të depozitohen. Kjo metodë është përdorur gjerësisht para viteve '90 në Shqipëri dhe konsiderohet si një metodë premtuese për të shmangur depozitimin në landfill të mbetjeve organike. (Respektimi i kufizimeve të sasisë sipas Direktivës së Landfillit si një kërkesë në të ardhmen për ne si vend kandidat.)

Duke pasur parasysh faktin se veprimtaria e kompostimit synon vetëm banorët e përhershëm të zonës së plazhit të Velipojës, që prodhojnë më pak se 10% të mbetjeve totale vjetore, kompostimi nuk përfaqëson ndonjë alternativë të rëndësishme trajtimi për të shmangur mbetjet nga landfilli, por mund të jetë i rëndësishëm për banorët e përhershëm të zonave rurale dhe e dobishme për komunën që administron një shërbim të kushtueshëm të mbledhjes së mbetjeve. Pjesa organike është 60-70% e sasisë totale të mbetjeve që prodhohen nga familjet në zonat rurale. Inputet mund të jenë mbetje të biodegradueshme të ndara në burim, kështu që nuk përmban qelq, plastik dhe metale, etj.

Kompostimi në shtëpi paraqet një nga metodat më të parapëlqyera të kompostimit që rekomandohet për t’u përdorur në familjet në fshat. Kjo metodë është më pak e kushtueshme dhe më e efektshme sesa transferimi i mbetjeve organike në pikën e mbledhjes dhe më pas të transportohen në landfill përfshirë këtu edhe depozitimin si dhe të gjitha kostot e tjera që shoqërojnë këto procese. Nga pikëpamja mjedisore kjo është e shëndetshme, e thjeshtë dhe mund të bëhet pothuajse në çdo vend dhe i jep mundësi familjeve të pakësojnë sasinë e mbetjeve të tyre në mënyrë të konsiderueshme. Komuna mund të ofrojë shërbimin e

copëtimit (grirjes) për familjet që ndërmarrin një nismë të tillë, duke copëtuar mbetjet drusore, disa herë në vit.




Figura 22 Skemat e kompostimit në shtëpi

Koshat e kompostimit në familje dhe pajisjet në komunitet do të duhet të projektohen në përputhje me standardet për produktet e dekompozuar, që janë në fuqi apo që janë në proces hartimi. Ndërkohë, suksesi dhe efektiviteti i procesit të kompostimit lidhet ngushtë me produktin e dekompozuar që ndikohet drejtpërdrejt nga cilësia e ndarjes dhe nga nevojat e tregut për këtë material. Pritet që produkti përfundimtar i kompostimit do të ketë interes të veçantë edhe më të madh nga bujqit vendas për punët e tyre në bujqësi për t'u përdorur kryesisht si pleh kimik apo për përmirësimin e cilësisë së tokës.

Komuna mund të inkurajojë procesin e kompostimit duke ofruar mbështetje financiare (grante, skema bashkëfinancimi); duke miratuar politika fiskale të favorshme për kompostimin e mbetjeve; duke kategorizuar sistemin aktual të tarifave dhe duke imponuar gjoha të veçanta.

Edhe nëse kompostimi në mjedise shtëpie është më pak i kushtueshëm dhe i thjeshtë si metodë, zhvillimi i kësaj nisme komuniteti duhet të provohet së pari si program pilot dhe më pas të zbatohet më gjerë në nivel më të lartë. Në aspektin e këtij plani, programi pilot propozohet si më poshtë vijon:

Grupi i targetuar:	Familjet e përhershme: 370 familje (1350 banore)
Potenciali total për tu kompostuar	Rreth 98 ton mbetje/ vit
Grupi pilot i propozuar	20 familje për vitin e parë
Kosto e përafërt	40€/ për njësi kompostimi (kazan), ose 800 € në total

Tabela 17 Program pilot për kompostimin në shtëpi

4.4.5 Administrimi i mbetjeve voluminoze dhe ndërtimore

Sipas kuadrit ligjor për administrimin e mbetjeve, është përgjegjësia e prodhuesit (përfshirë këtu ato tregtare dhe familjare) transporti i mbetjeve të tyre inerte dhe voluminoze drejtpërdrejt përmes vendet e caktuara nga pushteti lokal. Legjislacioni aktual (Neni 12 i Ligjit për administrimin e mbetjeve të ngurta dhe

Rregullorja Nr. 1, datë 30.3.2007, “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transporti deri tek eliminimi”) përcaktojnë metodologjinë, rregullat dhe kushtet për mbledhjen, transportin, ruajtjen dhe trajtimin duke synuar ripërdorimin, riciklimin dhe eliminimin e këtyre materialeve.

Detyrimet e autoritetit vendor mbështeten në kontrollin e ndotjes urbane nga këto materiale; të caktojnë vende specifike për depozitimin e tyre jashtë zonave urbane dhe afër kufijve administrativë. Që në fillim, autoritetet vendore duhet të kontrollojnë hedhjen abuzive të këtyre materialeve në hapësirat publike apo pranë pikave urbane të mbledhjes së mbetjeve. Këto mund të arrihen duke përcaktuar rregulla të qarta, gjobat, duke komunikuar me komunitetin, dhe duke ndërmarrë masa efektive të zbatimit (duke ngritur forcën policore apo inspektorët urbanë dhe duke hartuar procedura për vjeljen e gjobave).

Së dyti, komuna duhet të inkurajojë ripërdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve nga sipërmarrjet private. Ka një potencial të lartë për riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve, përderisa disa nga komponentët kanë një vlerë të lartë burimore. Në mënyrë të veçantë, ka një treg ripërdorimi për agregatet që rrjedhin nga mbetjet e ndërtimeve në rrugë, kanalizime dhe projekte të tjera ndërtimi. Por nëse nuk ndahen që në burim apo nuk transportohen veçmas, ato mund të përmbajnë sasi të vogla të mbetjeve të rrezikshme, përzierja e të cilave mund të paraqesë rrezik të veçantë për mjedisin dhe mund të pengojë riciklimin.

Në përputhje me nenin 8 të rregullores, komuna duhet të caktojë një vend për depozitimin përfundimtar të materialeve të mbetjeve ndërtimore, ku zgjidhja e parapëlqyer mund të jetë më pranë vend-depozitimit aktual të komunës apo në një vend-depozitim që nuk do të përdoret më për depozitimin e mbetjeve urbane.

4.4.6 Treguesit e performancës

Cilësia dhe sasia e shërbimeve lidhen me përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe sasisë të tilla si:

- Niveli i standardizimit dhe numri i kazanëve, pikat e grumbullimit dhe pikat e hapura, makinat, etj.;
- Rregullsia e mbledhjes së mbetjeve, numri i kazanëve jo të tejmbushur apo PGM jo të mbingarkuara;
- Pastërtia e pikave të grumbullimit të mbetjeve;
- Pastrimi në km apo sipërfaqe rrugë;
- Rritja në pikat e grumbullimit të mbetjeve;
- Numri i veprimtarive (të reja) të kompostimit familjar;
- Numri i konsumatorëve të rinj që ndajnë mbetjet në burim;
- Sasia e materialit të riciklueshëm të përgatitur për ripërdorim apo riciklim;

Treguesit për efikasitetin e shërbimit:

- Person-orë (apo person-ditë) për mbledhjen e mbetjeve, pastrimin e rrugëve
- Person-ditë për banorë;
- Koha e përdorimit për automjetet

Treguesit për kënaqjen e konsumatorëve:

- Përmbushja e pritshmërive të konsumatorit;

- Pjesëmarrja aktive në nismat vendore për ndërgjegjësimin dhe minimizimin e mbetjeve.

4.5 Analiza e skenarëve të administrimit të mbetjeve

Në seksionin e mëparshëm, u morën në analizë të gjithë opsionet e mundshëm për secilin element të manaxhimit të mbetjeve duke vlerësuar metodologjinë, koston e përafët (nëse është e mundur në këtë fazë), zbatueshmërinë, efikasitetin, cilësinë, qëndrueshmërinë dhe pranueshmërinë shoqërore të këtyre opsioneve dhe shërbimeve. Tani qëllimi është që të gjitha alternativat e vlerësuara të shihen të ndërlidhura dhe në funksion të njëra-tjetrës në sisteme apo në të ashtuquajturat skenarë që japin një pamje të plotë të funksionimit të sistemit. Performanca e pritshme e këtyre skenarëve vlerësohet në funksion të zbatueshmërisë, koston, aspekteve mjedisore dhe social.



Organizimi i shërbimit të mbledhjes së mbetjeve përbën bazën e sistemit dhe përcakton mënyrën në të cilën organizohen elementët vijues të sistemit. Për këtë arsye, u ra dakord që skenarët në lidhje me administrimin e mbetjeve të përqendrohen në mbledhjen e mbetjeve urbane dhe elementët e tjerë si ndarja e mbetjeve, riciklimi, etj., lidhen drejtpërdrejt me metodën e zgjedhur të mbledhjes së mbetjeve. Skenarët e mëposhtëm përshkruhen në lidhje me komponentët e tyre përbërës, mënyrës së ndërveprimit dhe rezultateve përfundimtare. Më pas, këto rezultate krahasohen dhe shoqërohen me rekomandimet përfundimtare.

Skenari 1: Administrimi i zakonshëm i mbetjeve

Siç u përmend edhe më parë, ky skenar bazohet në përjasjen e zakonshme të organizimit të shërbimeve të mbetjeve duke filluar nga pikat e përbashkëta apo publike të mbetjeve mbi të cilat organizohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve dhe sistemi i përbashkët për ndarjen e mbetjeve. Shërbimet e pastrimit dhe alternativat e depozitimit, nismat e riciklimit dhe kompostimit dhe administrimi i mbetjeve ndërtimore janë pjesë e sistemit dhe rrjedhojë e metodës së përzgjedhur për grumbullimin e mbetjeve.




Figura 23 “Skema e administrimit të mbetjeve – Skenari 1”

Përfaqja e realizueshmërisë: Meqenëse kjo skemë është vazhdim i skemës aktuale të mbledhjes së mbetjeve, duket se ajo është më e thjeshtë dhe më praktike për autoritetet vendore, ofruesin e shërbimit dhe komunitetet. Nga ana tjetër, ky skenar gjen zbatim për momentin dhe rezultati mund të jetë mjaft i kënaqshëm në një nivel të caktuar të largimit të mbetjeve nga terreni, por ende për shkak të infrastrukturës së dobët rrugore dhe rrugëve të ngushta, do të jetë e vështirë të shtohen pika të reja të mbledhjes së mbetjeve në këto zona. Problematike duhet se është edhe mbledhja e mbetjeve në zona të dendura në qendrën e plazhit gjatë pikut të sezonit, ku shërbimi kërkohet dy-tre herë në ditë.

Efektiviteti (cilësia): Për sa i përket efektivitetit dhe cilësisë së shërbimit, kjo nuk ofron ndonjë përmirësim të dukshëm për sa kohë që zona do të vazhdojë të mbetet e pambuluar me PGM për shkak të infrastrukturës së papërshtatshme, ndërkohë që PGM-të do të vazhdojnë të mbingarkohen dhe të rrethohen me mbetje nëse qëndrimi i komunitetit ndaj hapësirave publike mbetet kështu siç është (që ka shumë gjasa, sepse pjesa më e madhe e konsumatorëve janë banorë të përkohshëm të zonës së plazhit).

Performanca e minimizimit të mbetjeve: Në lidhje me minimizimin e mbetjeve dhe perspektivës së saj për përmbushjen e objektivave vendorë, ky skenar duket më pak i preferuar dhe më pak efektiv për sa kohë që ai mbështet vetëm sistemin me dy kosha, i cili duket i papërshtatshëm për kushtet vendore të plazhit të Velipojës.

Pranimi shoqëror: Ky sistem kërkon qëndrim pasiv të banorëve dhe bizneseve, ndaj ai nuk inkurajon pjesëmarrjen e tyre dhe as nuk ofron shërbim të barabartë, sepse disa zona mbulohen me shërbim më të shpeshtë (madje edhe dy herë në ditë) me një numër të caktuar PGM, ndërsa të tjerat kanë një rrjet

më të vogël PGM, ku konsumatorët duhet të ecin shumë për të hedhur mbetjet e tyre në pikën më të afërt. Fatkeqësisht, kjo ka nxitur hedhjen e paligjshme si rruga e shkurtër për t'i gjetur vendin mbetjeve. **Si përfundim**, ky skenar përfaqëson një mënyrë praktike dhe me kosto të ulët dhe shoqërisht të pranueshme për përmirësimin e situatës aktuale në ofrimin e një mjedisi urban më të pastër, por nuk ofron kushtet optimale për zhvillimin e skemave efektive të minimizimit të mbetjeve.

Skenari 2: Administrimi i kombinuar i mbetjeve

Në thelb, ky skenar i administrimit të mbetjeve bazohet në sistemin e mbledhjes individuale dhe në burim mbi të cilat janë hartuar skemat e ndarjes dhe mbledhjes së mbetjeve. Pak a shumë kjo përfshin kalimin gradual nga sistemi aktual i mbledhjes drejt atij individual.

Siç u përshkrua edhe më sipër, në fillim ky skenar parashikon të ketë vetëm 100 biznese (hotele) dhe 500 familje që iu shërbehen individualisht, të cilët do të shërbejnë si modele për t'u provuar dhe përmirësuar. Është e rëndësishme të zgjidhen kryesisht ata konsumatorë (familje dhe biznese) që ndodhen në zonë me akses të kufizuar për vendosjen e PGM-ve apo në zonë me dendësi urbane (ku si rezultat do të ketë një koeficient më të lartë të prodhimit të mbetjeve).




Figura 24 “Skema e administrimit të mbetjeve – Skenari 2”

Përfaqja e realizueshmërisë: Në shikimin e parë, nga pikëpamja e realizueshmërisë, zbatimi i sistemit individual duket më pak praktik dhe më shumë i ndërlikuar dhe ka nevojë për një pjesëmarrje aktive të komunitetit. Për sa i përket cilësisë së shërbimeve, nëse banorët dhe bizneset bien dakord të marrin pjesë aktivisht në këtë skemë individuale të mbledhjes së mbetjeve, kjo me siguri do të zgjidhë shumë probleme me situatën aktuale të administrimit të mbetjeve. Për më tepër, kjo do të bënte të mundur heqjen e PGM-ve dhe mbetjeve nga rrugët dhe hapësirat publike dhe do të çonte në përmirësimin e punës së shërbimit.

Performanca e minimizimit të mbetjeve: kjo ofron një perspektivë të mirë për ngritjen e një sistemi të efektshëm dhe cilësor për ndarjen e mbetjeve, gjë që do të çonte në rritjen e riciklimit dhe kompostimit në të ardhmen dhe do të sigurote respektimin e plotë të objektivave kombëtarë dhe vendorë për minimizimin e mbetjeve.

Pranimi shoqëror: pranimi shoqëror është një faktor themelor për punën e sistemi dhe nëse nuk arrihet mund të nxjerr shumë probleme me performancën e shërbimit dhe efektivitetin e tij. Në rast të kundërt, ai ofron një shërbim më pranë konsumatorëve duke i bërë ata të ndërgjegjshëm dhe më aktivë në shërbimet vendore të mbetjeve. Për më tepër, ai ofron një sistem të drejtë dhe të përshtatshëm të administrimit të mbetjeve ku konsumatorët (veçanërisht ata të mëdhenj) paguajnë për atë që prodhojnë dhe që paguajnë më pak nëse përfshihen aktivisht në skemat e minimizimit të mbetjeve.

Si përfundim: Skenari i kombinuar i administrimit të mbetjeve paraqet një sistem të përmirësuar që është i përqendruar në performancën e përgjithshme të shërbimit për sa i përket cilësisë dhe minimizimit të mbetjeve, por duket mjaft i ndjeshëm për përfshirjen e publikut. Ai kërkon aftësi dhe mjeshtri të menaxhimit të mirë nga autoritetet vendore për të vepruar me efektivitet dhe efikasitet për uljen e kostove.

4.6 Plani i investimeve

Investimet e nevojshme për periudhat afatshkurtra dhe afatmesëm marrin parasysh nevojat urgjente për të përmirësuar (rinovuar dhe zgjeruar) infrastrukturën aktuale për shërbimet e pastrimit dhe administrimit të mbetjeve si dhe nevojat për të vënë në zbatim skenarët kryesorë për administrimin e mbetjeve. Më konkretisht, investimet konsistojnë në blerjen e automjeteve teknologjike, të kazanëve dhe koshave të rinj, përfshirë këtu pajisjet dhe mjetet për zbatimin e skemave pilot të minimizimit të mbetjeve. Për të përcaktuar nevojat për makineri dhe kosha u ndërmor një “analizë e hollësishme e infrastrukturës së mbetjeve²²” për secilin skenar.

Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje të planit të investimeve për periudhën 2011-2016.

Viti ose periudha e investimit	Skenari 1		Skenari 2		Burimi i mundshëm i investimit
	Tipi i investimit	Fondi kapital (000 LEK)	Tipi i investimit	Fondi kapital (000 LEK)	
2011- 2014	Rinovimi i 60 konteniereve ekzistues (1.1m3);	500/vit	Rinovimi i 60 konteniereve ekzistues (1.1m3);	500/vit	Burimet e vete komunes ose donacione te huaja
2011-2012	Blerja e 80 koshave te rinj te plazhit (0.24 m3)	560	Blerja e 80 koshave te rinj te plazhit (0.24 m3)	560	Burimet e vete komunes ose donacione te huaja

²² Bashkëngjitur planit

2011- 2012	Blerja e 190 konteniereve te rinj (1.1m3)	5,700	Blerja e 170 konteniereve te rinj (1.1m3) dhe 112 koshave (0.24m3) & 540 kosha (50 litra)	7,794	Burimet e vete komunes ose donacione te huaja
2011- 2012	Blerja e nje makine te re teknologjike (10 ton)	4,000	Blerja e nje makine te re teknologjike (10 ton)	4,000	Burimet e vete komunes ose donacione te huaja
2012	Blera e koshave te kompostimit per zonen pilot	115	Blera e koshave te kompostimit per zonen pilot	115	Burimet e vete komunes ose donacione te huaja
2013-....	Rinovimi I makines teknologjike (ne 10 vjet) dhe konteniereve (ne 5 vjet)	Per tu llog. Ne te ardhmen	Rinovimi I makines teknologjike (ne 10 vjet) dhe konteniereve (ne 5 vjet)	Per tu llog. Ne te ardhmen	Burimet e vete komunes ose donacione te huaja
2012-2013	Rehabilitimi dhe mbyllja e fushes se mbetjeve	Per tu llog. Ne te ardhmen ²³	Rehabilitimi dhe mbyllja e fushes se mbetjeve	Per tu llog. Ne te ardhmen	Qeveria qendrore ose donacione te huaja
2013-2015	Infrastruktura e plote e riciklimit	Per tu llog. Ne te ardhmen	Infrastruktura e plote e riciklimit	Per tu llog. Ne te ardhmen	Iniciativa private ose donacione te huaja
2013-2015	Infrastruktura e plote e kompostimit	Per tu llog. Ne te ardhmen	Infrastruktura e plote e kompostimit	Per tu llog. Ne te ardhmen	Iniciativa private ose donacione te huaja

Tabela 18 "Investimet e nevojshme për periudhën 2011-2015"

Rekomandime për investimet

- **Dilema: t'i blejmë apo t'i marrim me qira makinat e mbetjeve:** Sipas analizës së nevojave për investime, zbatimi i të dy sistemeve të administrimit të mbetjeve (skenarëve) kërkon 2 makina mbetjesh, ku një 10-tonësh planifikohet të përdoret gjatë gjithë vitit dhe një 6-tonësh vetëm për sezonin e verës. Duke e parë nga niveli i përdorimit kamioni i vogël është më mirë të merret me qira përderisa ai do të nevojitet vetëm për një kohë të shkurtër (2 muaj).
- **Strategjia e investimeve:** Në dy vitet e para, komuna duhet të përqendrohet në rinovimin dhe përmbushjen e nevojave bazë me kazanë dhe makinë si dhe të blejë pajisje të tjera për programet pilote të minimizimit të mbetjeve. Më pas, ajo duhet të fokusohet në orientimin drejt ndërtimit të infrastrukturës (p.sh., rehabilitimit të vend-depozitimit) dhe drejt risive; të zgjerojë skemat e minimizimit të mbetjeve ose të ofrojë shërbime për mbetje jo-urbane.

²³ Kosto e perafert rreth 50,000-100,000 EURO

4.7 Kostoja e skenarëve

Në tabelat e mëposhtme jepet një përmbledhje e rezultateve të llogaritjes së kostos në lidhje me secilin skenar të administrimit të mbetjeve përkatësisht për të dy alternativat e depozitimit të mbetjeve: depozitimi në vend-depozitimin e Velipojës dhe në landfillin e Bushatit. Është llogaritur e gjithë kostoja për secilin komponent të administrimit të mbetjeve (mbledhja, pastrimi dhe depozitimi) në lidhje me: (i) kostoja e krahut të punës, (ii) kostoja e materialeve dhe mirëmbajtjes; (iii) kostot për investimet dhe amortizimet; dhe (iv) kostot e tjera (ato administrative). Duhet përmendur këtu se analiza e kostove e paraqitur më poshtë nuk ka përfshirë kostot shtesë për kompostimin dhe riciklimin në nivel pilot.

Tabela 19 Kostot vjetore të skenarit për vitin e parë të zbatimit dhe depozitimit në vend-depozitimin e Velipojës

Komponentet		Kosto operative (LEK)	Kosto Kapitale (LEK)	Kosto indirekte administrative (LEK)	Kosto Totale (LEK)
Skenari 1	Grumbullimi i mbetjeve	2,520,634	5,350,000	549,000	8,419,634
	Depozitimi i mbetjeve	500,000	0	0	500,000
	Pastrimi i plazhit dhe rrugeve	8,351,140	640,000	831,600	9,822,740
	Kosto totale				18,742,374
Skenari 2	Grumbullimi i mbetjeve	3,006,034	6,117,000	549,000	9,672,034
	Depozitimi i mbetjeve	500,000	0	0	500,000
	Pastrimi i plazhit dhe rrugeve	8,351,140	640,000	831,600	9,822,740
	Kosto totale				19,984,774

Tabela 20 Kostot vjetore të skenarit për vitin e parë të zbatimit dhe depozitimit në landfillin e Bushatit

Komponentet		Kosto operative (LEK)	Kosto Kapitale (LEK)	Kosto indirekte administrative (LEK)	Kosto Totale (LEK)
Skenari 1	Grumbullimi i mbetjeve	3,400,000	5,350,000	549,000	9,300,000
	Depozitimi i mbetjeve	3,173,730	0	0	3,175,200
	Pastrimi i plazhit dhe rrugeve	8,351,140	640,000	831,600	9,822,740
	Kosto totale				22,298,000

Skenari 2	Grumbullimi i mbetjeve	4.060,000	6,117,000	549,000	10,726,000
	Depozitimi i mbetjeve	3,173,730	0	0	3,173,730
	Pastrimi i plazhit dhe rrugeve	8,351,140	640,000	831,600	9,822,740
	Kosto totale				23,722,470

V. PERSPEKTIVA FINANCIARE

5.1 Çështja e financimit dhe strategjia e “mbulimit të koston”

5.1.1 Investimet kapitale

Sipas vlerësimit paraprak të paraqitur më sipër, investimet kapitale duhet të rriten vazhdimisht në 5-6 vitet e ardhshme sipas nevojave për të ngritur në një nivel më të lartë sistemin aktual të administrimit të mbetjeve. Investimet do të kërkohen nga burimeve financiare vendore dhe kombëtare, nga donatorët e huaj dhe bankat e zhvillimit, sektori privat apo kombinimi i tyre. Për të nxitur investimet mjedisore, qeveria qendrore duhet të krijojë një Fond Mjedisi për të siguruar financimin fillestar për projektet në investime mjedisore. Në këtë kuadër, komuna duhet të fillojë dhe të inkurajojë rehabilitimin e vend-depozitimit aktual dhe të hartojë disa programe novatore për minimizimin e mbetjeve, që të jenë në një linjë me politikën dhe objektivat kombëtare. Megjithatë, ajo që nevojitet më shumë tani është të hartohen projekte si për shembull “studimi i fizibilitetit për vend-depozitimin vendor” apo programe riciklimi, për të cilat do të marrë financime nga fondet qeveritare.

Investimet e menjëhershme si makinë dhe kazanë, që konsiderohen thelbësore në lidhje me ndryshimin e madh të shërbimit kërkohen të realizohen me burimet e pushtetit vendor të kombinuara me programe e huaja të donatorëve që janë të pranishëm në rajon (p.sh., Programi DLDP).

5.1.2 Strategjia e mbulimit të koston dhe niveli i tarifave

Sipas ligjit, autoritetet vendore kanë përgjegjësinë të kontrollojnë caktimin dhe përshtatjen e tarifave të mbetjeve në përputhje me politikat e tarifave të përcaktuara nga këshilli bashkiak dhe të bazuara në:

- Parimin “kush ndot paguan”
- Rakordimin me buxhetin vjetor
- Zgjedhje të mundshme politike për përcaktimin e përparësive
- Mundësia e pagesës
- Kufizimet ligjore (p.sh., për tarifa për pastrimin e njësive të vogla tregtare)²⁴

²⁴ Ligjit Nr. 10117, datë 23.04.2009 “Për disa ndryshime në ligjin e mëparshëm të Taksave dhe tarifave në nivel vendor”

Shqyrtimi paraprak i strukturës aktuale financiare të sektorit të administrimit të mbetjeve në komunën e Velipojës tregoi se komuna ka burime të kufizuara financiare, sepse niveli aktual i tarifave dhe vjelja e të ardhurave janë të pamjaftueshme për të mbështetur administrimin e duhur të mbetjeve të ngurta. Pika nisëse në caktimin e kostove të administrimit të mbetjeve në të ardhmen duhet të jetë me parimin “ndotësi paguan” apo përgjegjësia e prodhuesit të mbetjeve. Ky është një parakusht për fuqinë dhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit të administrimit të mbetjeve në nivel vendor.

Qëllimi i komunës është të zbatojë sistemin e mbulimit të kostos që lidhet me objektivat e saj. Prandaj, nëse komuna synon të përmbushë objektivin menjëherë, plani rekomandon rritjen e nivelit të tarifave në mënyrë progresive drejt mbulimit të kostos operative, kostos së mirëmbajtjes dhe amortizimit si dhe duke përdorur subvencioneve apo të ardhura të tjera të komunës për të mbështetur kostot administrative. Ngritja e strategjisë për mbulimin e kostos fillon nga llogaritja totale e kostos, ku të gjitha kostot që lidhen me komponentët e sistemit të administrimit të mbetjeve në 5 vitet e ardhshme evidentohen dhe përmbledhen në tabelën e mëposhtme.

Kosto Operative	2011	2012	2013²⁵	2014	2015
Nen-Totali i Mbledhjes se Mbetjeve	2,520,634	2,634,000	3,715,827	3,823,586	3,934,470
Ne-totali i Pastrimit te Rrugeve	8,351,140	9,186,254	10,104,879	11,115,367	12,226,904
Nen-totali i depozitimi i mbetjeve*	500,000	500,000	3,427,628	3,701,839	3,997,986
Kosto Totale (LEK)	11,371,774	12,320,254	17,248,335	18,640,792	20,159,360
Kosto Kapitale	2011	2012	2013	2014	2015
Nen-Totali i Mbledhjes se Mbetjeve	5,350,000	6,375,000	6,400,000	6,585,600	6,776,582
Ne-totali i Pastrimit te Rrugeve	640,000	730,000	803,000	883,300	971,630
Kosto Totale (LEK)	5,990,000	7,105,000	7,203,000	7,468,900	7,748,212
Kosto Indirekte	2011	2012	2013	2014	2015
Nen-Totali i Mbledhjes se Mbetjeve	549,000	549,000	549,000	549,000	549,000
Ne-totali i Pastrimit te Rrugeve	831,600	831,600	831,600	831,600	831,600
Kosto Totale	1,380,600	1,380,600	1,380,600	1,380,600	1,380,600

Tabela 21 “Përmbledhje e evidentimit të kostove, 2011-2015”²⁶

²⁵ Prej 2013, mbetjet do të transferohen në landfillin e Bushatit

²⁶ Skenari 1 për alternativën e depozitimit vendor

Ndarja e kostove sipas normës së prodhimit të mbetjeve: Tarifat e administrimit të mbetjeve për konsumatorët do të caktohen mbi baza të shëndosha financiare. Parimi “ndotësi paguan” nënkupton që prodhuesit e mbetjeve duhet të paguajnë koston e plotë të administrimit të mbetjeve të tyre. Duke marrë parasysh këtë parim, kostoja duhet të ndahet në përputhje me prodhimin e mbetjeve për konsumatorët dhe të mbulohet nga vetë konsumatorët pjesa e gjithsecilit. Në praktikë, konsumatorët pritet të plotësojnë koston e plotë të administrimit të mbetjeve për mbetjet që prodhojnë dhe për shërbimin që përfitojnë, edhe pse tarifat apo detyrimet bazohen në:

- Detyrimin për sasi të mbetjeve të prodhuara;
- Shërbimin e ofruar – në këtë strukturë tarifash, këto të fundit bazohen në nivelin e shërbimit të ofruar për konsumatorin.

Fillimisht, tabela e mëposhtme ilustron mënyrën se si ndahen kostot mes konsumatorëve në bazë të prodhimit të mbetjeve.

Familjet e perhershme (rezidente)	213 ton	7%
Familjet e perkohshme (pushuesit sezonale)	2172 ton	67%
Bizneset e vogla	364 ton	11%
Bizneset e medha	77 ton	2%
Hotelet	414 ton	13%

Tabela 22 Ndarja e kostos mes konsumatorëve në bazë të prodhimit të mbetjeve

Së dyti, sipas përfitimit të shërbimit në kontekstin vendor (p.sh., praktikisht banorët e përhershëm përfitojnë vetëm shërbimin e mbledhjes së mbetjeve, ose turistët përfitojnë të gjitha llojet e shërbimeve) dhe duke marrë parasysh modelet e subvencionimeve për familjet (p.sh., rekomandohet që familjet të paguajnë vetëm kostot operative të shërbimeve) na lejon të llogarisim pjesën e kostos që do të mbulojë çdo konsumator dhe rrjedhimisht nivelin e tarifave paraprahe. Prandaj, kostoja totale për shërbimet e pastrimit dhe mbledhjes së mbetjeve ndahet mes konsumatorëve, si banorët e përhershëm, ata të përkohshëm, bizneset dhe njësitë e plazheve private sipas faktorëve të mësipërm.

Tabela 23 Ndarja e kostos dhe niveli paraprak për familjet

Tarife Familjare - Kosto operative		2011	2012	2013	2014	2015
1	Nr. i familjeve te perhershme dhe projektimi ne te ardhmen	370	396	424	453	485
1.1	Pjesa e Kostove operative -familjet rezidente²⁷ (LEK)	198,554	206,006	469,558	494,666	521,421
1.2	Tarife Vjetore familjeve perhershme (LEK)	537	520	1,108	1,091	1,075
2	Nr. familjeve sezonale mesatare/ dite	9,000	9,630	10,304	11,025	11,797
2.1	Pjesa e Kostove operative +kapitale -familjet sezonale	7,622,359	8,258,114	11,561,345	12,494,692	13,512,569
2.2	Tarife Vjetore (sezonale) (LEK)	847	858	1,122	1,133	1,145
2.3	Tarife ditore sezonale leke/ familje/ dite ose leke/ dhome/ dite)	7Lek	7Lek	9Lek	9Lek	10Lek

Tabela 24 Ndarja e kostos dhe niveli paraprak për bizneset

Tarife per Bizneset - Kosto operative+ kapitale		2011	2012	2013	2014	2015
3	Nr. i bizneseve BV	320	342	366	392	419
3.1	Pjesa e kostove operative +kapitale (BV)	1,952,423	2,184,472	2,749,681	2,936,172	3,138,353
3.2	Tarife vjetore (BV) (LEK)	6,101	6,380	7,505	7,490	7,482
4	Nr. i bizneseve BM	14	15	16	17	18

²⁷ Duke marre ne konsiderate normen e gjenerimit te mbetjeve dhe sherbimet e pastrimit qe i ofrohen

4.1	Pjesa e kostove operative +kapitale (BM)	412,559	461,593	581,025	620,432	663,154
4.2	Tarife vjetore (BM) (LEK)	29,469	30,814	36,249	36,175	36,137
5	Nr. i hoteleve	300	321	343	368	393
5.1	Nr. i dhomave te hoteleve	3,000	3,210	3,435	3,675	3,932
5.2	Pjesa e kostove operative +kapitale (LEK)	2,218,175	2,481,809	3,123,952	3,335,827	3,565,527
5.3	Tarife sezonale per dhome (LEK)	739Lek	773Lek	910Lek	908Lek	907Lek
5.4	Tarife ditore-sezonale per dhome (LEK)	6Lek	6Lek	8Lek	8Lek	8Lek

6	Nr. i plazheve private	70	70	70	60	60
6.1	% e plazhit e dhene me qera	70%	70%	70%	60%	60%
6.2	Totali i shpenzimeve operative dhe kapitale per pastrimin e plazhit	8,991,140	9,916,254	10,907,879	11,998,667	13,198,534
6.3	Pjesa e kostove operative dhe kapitale(LEK)	6,293,798	6,941,378	7,635,516	7,199,200	7,919,120
6.4	Siperfaqe e plazheve private(m2)	325,500	325,500	325,500	279,000	279,000
6.4	Tarife sezonale per m2	24Lek	24Lek	24Lek	24Lek	24Lek
6.5	Tarife ditore-sezonale per m2	0.2148Lek	0.1777Lek	0.195Lek	0.215Lek	0.237Lek

Politika vendore dhe planifikimi i mbetjeve

Një faktor i rëndësishëm që ndikon në tarifat e shërbimit është se shërbimet e administrimit të mbetjeve të ngurta kanë karakteristika të mallrave private dhe publike. Mbledhja e mbetjeve të banorëve është një e mirë publike në kuptimin se është e vështirë të përjashtohet ndonjë nga shërbimi pa shkaktuar probleme të shëndetit publik dhe depozitimit të paligjshëm. Në të njëjtën linjë janë edhe shërbime të mirëfillta publike, si pastrimi i plazhit dhe rrugëve, nga të cilat përfitojnë të gjithë banorët e përkohshëm dhe firmat. Për më tepër, dihet se ka faktorë të tjerë shoqërorë, si pamundësia për të paguar (ekzistenca e familjeve me të ardhura të pakta) apo se disa konsumatorë nuk janë mësuar të paguajnë tarifa pastrimi apo se komuna nuk është në gjendje të mbledhë tarifat e mbetjeve (duke iu referuar historisë së nivelit të vjeljes së tarifave aktuale²⁸) që detyrojnë autoritetet vendore t'i marrin parasysh këto fakte kur planifikojnë të ardhurat vjetore nga tarifa e pastrimit.

Analiza e mëposhtme merr parasysh këta faktorë shoqërorë si dhe të performancës e mëparshme të komunës në vjeljen e tarifave kur parashikohen të ardhurat për vitet e ardhshme.

²⁸ Evidentuar në pjesën “Performanca e vjeljes së tarifave” në këtë plan

Tabela 25 Analizë e përmblendhur e planifikimit të të ardhurave

		2011	2012	2013	2014	2015
1	100% Tarifave te familjeve te perhershme (LEK)	198,554	206,006	469,558	494,666	521,421
1.1	Perqindja e Konsumatoreve qe jane ne gjendje te Paguajne	78%	80%	78%	78%	78%
1.2	Te ardhurat e planifikuara (LEK)	154,872	164,805	366,255	385,839	406,709
1.3	Perqindja e konsumatoreve qe do te paguajne	30%	50%	70%	80%	100%
1.4	Te ardhurat e planifikuara per tu mbledhura (LEK)	46,462	82,402	256,379	308,672	406,709
		2011	2012	2013	2014	2015
2	100% e Tarifave nga familjet dhe pushuesit sezonale (dhomat familjare dhe shtepite private te pushimit)	7,622,359	8,258,114	11,561,345	12,494,692	13,512,569
2.1	Perqindja e konsumatoreve qe jane ne gjendje te paguajne	100%	100%	100%	100%	100%
2.2	Te ardhurat e planifikuara	7,622,359	8,258,114	11,561,345	12,494,692	13,512,569
2.3	Niveli i planifikuar i mbledhjes	60%	70%	70%	80%	90%
2.4	Te ardhurat e planifikuara per tu mbledhur (LEK)	4,573,416	5,780,680	8,092,942	9,995,754	12,161,313
		2011	2012	2013	2014	2015
3	100% Tarifave te Biznesit BM+BV +ambulante	2,364,982	2,646,064	3,330,706	3,556,604	3,801,507
3.1	Perqindja e konsumatoreve qe jane ne gjendje te paguajne.	100%	100%	100%	100%	100%
3.2	Te ardhurat e planifikuara	2,364,982	2,646,064	3,330,706	3,556,604	3,801,507

3.3	Niveli i planifikuar i mbledhjes	85%	90%	100%	100%	100%
3.4	Te ardhurat e planifikuara per tu mbledhur (LEK)	2,010,235	2,381,458	3,330,706	3,556,604	3,801,507
		2011	2012	2013	2014	2015
4	100% Tarifave te hoteleve	2,218,175	2,481,809	3,123,952	3,335,827	3,565,527
4.1	Perqindja e konsumatoreve qe jane ne gjendje te paguajne	100%	100%	100%	100%	100%
4.2	Te ardhurat e planifikuara	2,218,175	2,481,809	3,123,952	3,335,827	3,565,527
4.3	Niveli i planifikuar i mbledhjes	85%	90%	100%	100%	100%
4.4	Te ardhurat e planifikuara per tu mbledhur (LEK)	1,885,449	2,233,628	3,123,952	3,335,827	3,565,527
		2011	2012	2013	2014	2015
5	100% Tarifave te plazheve private	6,293,798	6,941,378	7,635,516	7,199,200	7,919,120
5.1	Perqindja e konsumatoreve qe jane ne gjendje te paguajne	100%	100%	100%	100%	100%
5.2	Te ardhurat e planifikuara	6,293,798	6,941,378	7,635,516	7,199,200	7,919,120
5.3	Niveli i planifikuar i mbledhjes	100%	100%	100%	100%	100%
5.4	Te ardhurat e planifikuara per tu mbledhur (LEK)	6,293,798	6,941,378	7,635,516	7,199,200	7,919,120

Për të përfunduar procesin e planifikimit drejt objektivave të mbulimit të kostos, të ardhurat e planifikuara për secilin konsumator përmbledhen së bashku dhe krahasohen me koston totale operative kapitale. Në rastin tonë, përqindjet e mbulimit të kostos për vitet në vazhdim paraqitet e lartë dhe në progres drejt mbulimit të plotë në vitin 2015, nëse analiza nuk i kthehet rivlerësimit të nivelit të tarifave apo nëse politika vendore nuk subvencionon tarifat.

Tabela 26 Llogaritja e tepricës operative

Llogaritja e Teprices operative	2011		2012		2013		2014		2015	
	Shuma (LEK)	%	Shuma (LEK)	%	Shuma (LEK)	%	Shuma (LEK)	%	Shuma (LEK)	%
Total i tarifave te mbledhura:	15,164,106	100	17,419,546	100	22,439,494	100	24,396,056	100	27,854,176	100
Familjet perhershme	46,462	0.3%	82,402	0.5%	256,379	1%	308,672	1.3%	406,709	1.5%
Familjet sezonale	4,573,416	30%	5,780,680	33%	8,092,942	36%	9,995,754	41%	12,161,313	44%
Bizneset BV+BM	2,364,982	16%	2,381,458	14%	3,330,706	15%	3,556,604	15%	3,801,507	14%
Hotelet	1,885,449	12%	2,233,628	13%	3,123,952	14%	3,335,827	14%	3,565,527	13%
Plazhet private	6,293,798	42%	6,941,378	40%	7,635,516	34%	7,199,200	30%	7,919,120	28%
Kostot operative + kapitale	18,742,374	100%	20,805,854	100%	25,831,935	100%	27,490,292	100%	29,288,173	100%
Mbledhja e Mbetjeve	8,419,634	44.9%	9,558,000	46%	10,664,827	41%	10,958,186	40%	11,260,053	38%
Pastrimi i plazhit dhe rrugeve	9,822,740	52.4%	10,747,854	52%	11,739,479	45%	12,830,267	47%	14,030,134	48%
Depozitimi i mbetjeve (fusha)	500,000	2.7%	500,000	2%	3,427,628	13%	3,701,839	13%	3,997,986L	14%
Teprica ose Deficiti	(3,578,268)	-19%	(3,386,308)	-16%	(3,392,442)	-13%	(3,094,236)	-11.3%	(1,433,997)	-5%

Çdo vit, komuna duhet të shqyrtojë strategjinë e rikuperimit të kostos dhe rritjen e tarifave bazuar në analizën e propozuar dhe duhet të marrë parasysh edhe performancën në vjeljen e tarifave, sondazhin mbi vullnetin për të paguar, kostot dhe synimet, si dhe të propozojë ndryshime në paketën fiskale.

Faturimi dhe vjelja e tarifave

Tarifat do të marrin formën e një detyrimi të drejtpërdrejt që vjen si faturë më vete tek konsumatori ose së bashku me një shërbim tjetër bazë (p.sh., i bashkuar me shërbime të tjera infrastrukturore si uji apo dritat).

Forma e faturimit dhe procedura e vjeljes mund të jenë të ndryshme për çdo lloj konsumatori, si njësi tregtare, hotele, familje të përhershme apo të përkohshme. Meqenëse shumë konsumatorë dhe veprimtari të tyre apo objekte (pika verore, vila, njësi tregtare, hotele, etj.,) frekuentohen përkohësisht (nga pak ditë në pak muaj) gjatë sezonit veror, procedura e faturimit duhet të përshtatet me kujdes për karakteristikat e konsumatorëve për të rritur nivelin e faturimit dhe vjeljen e tarifave. Ndaj faturat ditore janë të përshtatshme për hotelet e vogla (dhomat), shtëpitë me qira, plazhet private, automjetet, etj.; faturat sezonale janë të përshtatshme për pikat turistike, apartamentet sezonale, hotelet e mëdha, shitësit ambulatorë, njësitë tregtare dhe argëtuese, kurse faturat vjetore janë të përshtatshme për konsumatorët e përhershëm, si banorët dhe bizneset vendase.

Komuna mund të vazhdojë të mbledhë tarifa vetë me anë të procedurës normale duke autorizuar inspektorët e komunës të administrojnë dhe detyrojnë pagimin e tarifave për konsumatorët, siç ka bërë deri tani ose t'ia kalojë përgjegjësinë e vjeljes së tarifave një agjenti të jashtëm publik ose privat. Me një rregullim të saktë të bazës ligjore sipas rekomandimeve, autoritetet vendore mund të ushtrojnë më shumë tryzni mbi konsumatorët në rastin e mospagesave.

5.1.3 Treguesit financiarë

Aspektet financiare janë thelbësore për shërbimet dhe për qëndrueshmërinë e tyre. Performancë financiare lidhet me përmbushjen e objektivave për çështje dhe masat financiare me anë të disa treguesve financiarë, të shqyrtuar në pyetjet e mëposhtme:

- Sa mbulon buxheti vjetor shpenzimet dhe nevojat (përkatësisht koston operative, amortizimin, kostot kapitale)?
- Sa ndryshojnë tarifat në krahasim me ato të përcaktuara në këtë plan?
- Sa faturohet dhe sa paguhet?
- Sa është shuma e faturuar dhe të ardhurat e vjela nga çdo banor?
- Sa është përqindja e buxhetit që mbulohet nga pagesat – mbulimi i kostos (nga të ardhurat e tarifave)?
- Sa është niveli i mbulimit të shpenzimeve nga tarifat e mbetjeve dhe të ardhurave specifike të komunës?
- Sa konsumatorë (banorë, biznese, etj.) janë të gatshëm të paguajnë për një shërbim të mirë?

Rekomandime të hollësishme

- Në funksion të këtij plani, analiza e kostos vjetore u mbështet në metodologjinë “FCA”²⁹e, ku shpenzimet kapitale regjistrohen dhe vlerësohen përgjatë jetëgjatësisë së përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve (makinat teknologjike dhe kazanët). Kjo përjasje rekomandohet të përdoret nga komuna kur të vlerësojë buxhetin vjetor për administrimin e mbetjeve.
- Kostot operative, të mirëmbajtjes, amortizimit dhe ato kapitale do të mbulohen nga tarifat e përdoruesit përmes zbatimit të planit brenda një periudhe 5-vjeçare. Kjo do të jetë e nevojshme për të siguruar që cikli i investimeve të vogla dhe shërbimeve të dobëta të administrimit të mbetjeve të mos dalin përsëri në periudhën afatgjate.
- *Të shqyrtohet strategjia e tarifave:* çdo vit, komuna duhet të shqyrtojë strategjinë e mbulimit të kostos dhe të rrisë tarifat sipas analizës së propozuar dhe të marrë parasysh performancën e vjeljes së tarifave, sondazhit të dëshirës për të paguar, kostot dhe objektivat si dhe të propozojë ndryshime në paketën fiskale.
- *Politika e drejtë për vendosjen e tarifave të depozitimit:* nëse komuna vendos të rehabilitojë vend-depozitimin e vet, ajo duhet të vendosë tarifa të diferencuara të depozitimit me qëllim nxitjen apo uljen e llojeve të caktuara të mbetjeve të ngurta. Për shembull, për të pakësuar hedhjen e paligjshme të mbetjeve urbane, ajo mund të lejojë depozitimin pa asnjë tarifë për mbetjet e përziera, por duhet të vendosë tarifë për depozitimin e materialeve të ricikluara apo ato të ndërtimeve, nëse ekzistojnë alternativa për mbetjet e riciklueshme në qytet. Aplikimi i tarifave më të larta për prodhuesit e mbetjeve të rrezikshme që vilen gjatë mbledhjes së mbetjeve apo në pikat e grumbullimit synon të mbulojë kostot e administrimit.
- *Stimuj për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve:* Komuna duhet të aplikojë tarifa më të ulëta apo të ofrojë shërbim pa pagesë për konsumatorët që përfshihen në programet pilot të minimizimit të mbetjeve. Kjo do të ndihmojë në ndryshimin e qëndrimit të konsumatorëve dhe mund të përdoret për të ofruar stimuj që konsumatorët të pakësojnë sasinë e mbetjeve që ata prodhojnë.
- Komuna duhet të kujdeset të llogarisë kapacitetin e vërtetë të konsumatorëve për të paguar tarifën, me qëllim që të subvencionojë skemën e administrimit të mbetjeve për të mbuluar hendekun e të ardhurave nga konsumatorët që nuk kanë mundësi të paguajnë (familjet me asistencë sociale apo me pak të ardhura).
- *Transparenca dhe komunikimi:* Proçesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t’i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira. Informacioni për shërbimin duhet t’i shpjegohet banorëve se sa kushton aktualisht administrimi i mbetjeve të ngurta. Komuna duhet të realizojë një fushatë të fortë ndërgjegjësimi për të gjithë banorët, veçanërisht për banorët duke reklamuar shërbimin e mbledhjes së mbetjeve, rregullave dhe përgjegjësi.
- *Detyrimi për të paguar tarifat:* Komuna duhet të miratojë dhe përdorë të paktën një nga mekanizmat e mëposhtme për të detyruar banorët që nuk paguajnë për shërbimet e ofruara të mbetjeve, të tilla si: (i) sanksione të drejtpërdrejta në rast mospagese apo kamat vonese për pagesat e prapambetura; (ii) lidhjen e pagesës së tarifës së mbetjeve me ndonjë tarifë vendore apo kombëtare të detyrueshme (p.sh., fatura e energjisë elektrike, taksa mbi pronës, etj.); (iii) sanksione me mosdhënien e ndonjë shërbimi bazë vendor (p.sh., uji i pijshëm).

²⁹ Full Cost Account: Llogaritja e Plotë e Kostos

VI. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

6.1 Rregullorja vendore

Në kuadrin e plotësimit të kuadrit ligjor të administrimit të mbetjeve, komuna e Velipojës duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren e vet, ku të përcaktojë rolin e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve për të siguruar administrimin e suksesshëm të mbetjeve brenda territorit të vet administrativ. Kjo rregullore duhet të përcaktojë rregullat për administrimin vendor të mbetjeve dhe pastrimin e komunës në territorin e vet administrative, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe kreun e sanksioneve të detyrueshme. Rregullorja duhet të përfshijë si më poshtë:

a) Standardet vendore të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, procedurat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;

b) Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve

- (i) Të mos dëmtohen koshat, të mos ndryshohet destinacionit i koshave, të mos dëmtohet dhe ndryshohet destinacionit i pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- (ii) Të mos depozitohen mbetjet, të mos digjen mbetjet në kazanë, të mos hidhen mbetjet në rrymat ujore dhe kanalizimet, të mos hidhen mbetjet në territore publike;
- (iii) Të shmanget dhe parandalohet hedhja abuzive e mbetjeve masive dhe atyre të rrezikshme, të mos depozitohen kafshët e ngordhura dhe materialet helmuese;
- (iv) Të shmanget parkimi i automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- (v) Të pastrohet hapësira rreth dyqaneve dhe pikave ambulatorë të shitjes; të mbahet higjienë dhe të dezinfektohen kazanët dhe koshat e mbetjeve;
- (vi) Të paguhet taksat dhe tarifat vendore për mbetjet;
- (vii) Çështje të tjera të shëndetit publik

c) Të drejtat dhe detyrimet e administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve)

- (i) Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar;
- (ii) Procedura administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
- (iii) Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
- (iv) Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
- (v) Përdorim i vendeve të miratuara të depozitimit;
- (vi) Regjistrimi i konsumatorëve të shërbyer;
- (vii) Mbajtja e të dhënave për mbetjet;
- (viii) Parandalimi i problemeve për shëndetin publik;
- (ix) Çështje të tjera të shëndetit publik, të tilla procedurat e shëndetit, sigurisë dhe urgjencës;

6.2 Detyrimi dhe sanksionet

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga këshilli i komunës. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “ndotësi paguan” ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të realizojë një sistem të drejtë dhe të shkurajojë dhe parandalojë ndotësit

Gjobat vendore duhet të vendosen nga inspektorët e komunës që janë nën juridiksionin e komunës. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve vendore (Neni 35, 36 i Ligjit për Depozitimin e Mbetjeve) dhe sipas rregullores së ardhshme të administrimit të mbetjeve dhe listës së gjobave dhe shkeljeve të miratuara nga këshilli i komunës.

6.3 Liçencimi mjedisor

Zbatimi me sukses i kuadrit ligjor vendor do të kërkojë përmirësime në sistemin e licencimit mjedisor, i cili përbën mekanizmin kryesor të kontrollit. Sipas legjislacionit kombëtar:

- (i) Bashkitë duhet të bashkëpunojnë me ARM (Agjencia Rajonale e Mjedisit) kur japim miratime për njerëz që ushtrojnë veprimtari apo projekt për administrimin e mbetjeve (Neni 25 i ligjit për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta)
- (ii) Të japin miratimin për vendet e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme për qëllime të marrjes së lejeve mjedisore (Neni 13 i Ligjit për Mbetjet e Rrezikshme)
- (iii) Të kontrollojnë vazhdimisht përmbushjen e detyrimeve ligjore në veprimtaritë e administrimit të mbetjeve (përfshirë jo vetëm mbetjet urbane por edhe mbetje ndërtimore dhe të tjera jo-urbane). Në këtë aspekt, ajo duhet të marrë herë pas here raporte nga personat e përfshirë në këto veprimtari.

6.4 Pjesëmarrja e sektorit privat

Përfitimet dhe të mirat e efikasitetit nga pjesëmarrja e sektorit privat janë provuar në përgjithësi nga përvoja: (i) sektori privat ka ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh tek kapitalet sesa sektori publik; (ii) administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik; (iii) i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standardeve operative dhe teknike. Prirja për komercializimin e shërbimit të mbledhjes së mbetjeve në shumë qytete dhe komuna mund të kërkojë privatizimin e këtij shërbimi edhe në Velipojë. Megjithatë, nuk është diskutim thelbësor për privatizimin e shërbimit të mbledhjes ose jo aq shpejt sa ndërmarrja publike të ketë një përqsasje biznesi dhe të funksionojë me efektivitet dhe efikasitet.

Privatizimi i shërbimit të mbetjeve dhe infrastrukturës ekzistuese duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime të sektorit privat në infrastrukturën e mbetjeve. Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.

Pjesa më e madhe e veprimtarive të administrimit të mbetjeve urbane mund të privatizohet

Sektori privat mund të marrë pjesë në secilën nga veprimtaritë e administrimit të mbetjeve të ngurta, siç jepet edhe më poshtë:

Ofrimi i kamionëve apo makinerive të rënda – me qira ose marrëveshje qiraje me pronarët e pajisjeve	Fshirja apo pastrimi i rrugëve dhe zonave të hapura – me kontratë shërbimi
Mbledhja e mbetjeve të përgjithshme urbane nga të gjitha lagjet / i gjithë qyteti – me kontratë shërbimi	Riparimi i makinerive të komunës për mbetjet urbane – me kontratë shërbimi sipas nevojave apo me kontratë afatgjatë
Mbledhja e mbetjeve nga ndërtimi apo prishja e ndërtimeve – me abonim privat	Operimi i vend depozitimit – me kontratë shërbimi ose koncesion
Mbledhja e mbetjeve komerciale nga hotelet, zyrat, tregjet apo dyqanet – me abonim privat	Vjelja e tarifave të përdoruesit apo taksave të mbetjeve – me të drejtë ekskluzive për mbledhjen e tarifave me agjentë, si ndërmarrja e ujësjellësit, apo elektriku.

Tabela 27 Pjesëmarrja e sektorit privat në administrimin e mbetjeve të ngurta

6.5 Mbështetja politike

